

**KONTRATA E SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE NË
SHQIPËRI, NË NIVEL EUROPIAN DHE NDËRKOMBËTAR**

Doktoranti

Shkëndi Çili

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
SHKENCA JURIDIKE, me profil **E DREJTËCIVILE** për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Endira Bushati

Numri i fjalëve: 53000

Tiranë, shtator 2017

E Drejta e Autorit

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se ky disertacion është rezultat i një pune tërësisht personale dhe nuk përmban riprodhim të materialeve të autorëve të tjerë, përveç rasteve të cituara në referenca. Gjithashtu theksoj se punimi nuk është prezantuar përpara ndonjë institucioni apo botuar më parë. Në kuadër të mbrojtjes së autorësisë ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdolloj mjeti dhe forme pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

Shkëndi Çili

Firma

ABSTRAKT

Interneti dhe tregtia elektronike, vitet e fundit kanë pësuar një progres shumë të rëndësishëm në jetën tonë të përditshme. Si rezultat i këtyre zhvillimeve teknologjike, lindi nevoja për krijimin dhe përdorimin e kontratës së shitjes në formë elektronike, në funksion të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, për të kryer transaksione të ndryshme elektronike. Kjo metodë relativisht e re shit-blerje ka marrë një zhvillim të shpejtë dhe të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve juridike. Si e tillë, kontrata e shitjes në formë elektronike, ofron avantazhe dhe disa-avantazhe të ndryshme ndaj konsumatorëve lidhur me nënshkrimin e saj nëpërmjet mjeteve elektronike.

Theksojmë se, risitë që paraqet kjo fushe e re kontraktule, shtrojnë nevojën e zbatueshmërisë në kontekstin praktik të elementëve, të zbatimit të kuadrit ligjor për tregtinë elektronike ndaj konsumatorin, si pala kontraktore më e dobët dhe më e rrezikuara në nënshkrimin e kontratës së shitjes në formë elektronike. Garancia për mbrojtjen e konsumatorit në mënyrë ligjore mbetet si një ndër vështirësitë kryesore, kryesisht për konsumatorin shqiptar, e cila përbën domosdoshmëri për ndërtimin dhe krijimin e një marrëdhënie juridike të balancuar midis bizneseve dhe transaksioneve të konsumit përgjatë nënshkrimit të kontratës së shitjes në formë elektronike.

Për këtë fushë në Shqipëri janë miratuar një sërë ligjesh, që përbëjnë kuadrin ligjor për funksionimin e tregtisë elektronike, specifikisht kontratës së shitjes në formë elektronike. Por pavarësisht këtij fakti, konkludojmë se, konsumatori shqiptar vazhdon të jetë ende mosbesues dhe skeptik marrëdhëniet juridike ndërmjet shitësve dhe blerësve në internet. Në kuadër të kësaj fushe, Shqipëria ka aderuar direktivën e Bashkimit Europian lidhur me tregtinë elektronike Direktivën 2000/31/EC mbi Nënshkrimin Elektronik dhe Direktivën 1999/93/EC, për Shtijen në Distançë 997/7/ec), duke bërë të mundur përafrimin e një niveli të lartë të legjislacionit tonë, nën dritën e këtyre direktivave. Ndërsa në nivel ndërkombëtar ekziston ligji model i UNCITRAL 1996, i cili është pak i njohur për legjilacionin tonë

Në këtë kontekst, specifikojmë se, qëllimi i këtij disertacioni është studimi i kontratës së shitjes në formë elektronike në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, duke analizuar parimet e së drejtës kontraktore elektronike të shitjes në kuadër të Direktivave të Bashkimit Europian dhe ligjit model UNCITRAL, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e palëve kontraktuese gjatë nënshkrimit të kontratës së shitjes në formë elektronike, si dhe duke u fokusuar njëkohësisht edhe në praktikën gjyqësore të vëndeve të huaja, në mungesë të rasteve shqiptare.

Fjalë kyçe: kontrata e shitjes elektronike, tregti elektronike, internet, nënshkrim elektronik

ABSTRACT

The Internet and electronic commerce have, in recent years, made a very important progress in our daily lives. As a result of these technological developments, there was a need for the creation and use of a sales contract in electronic form, in function of the national and international market, to carry out various electronic transactions. This relatively new sales-purchase method has taken a rapid and important development in the development of legal relationships. As such, the sales contract in electronic form offers several advantages and advantages to consumers regarding its signature via electronic means.

We point out that the novelty of this new field of contractuality implies the need for implementation in the practical context of the implementation of the legal framework for electronic commerce towards the customer as the weakest and most vulnerable contractor in signing the sales contract in electronic form. The consumer protection guarantee in legal terms remains one of the main difficulties, mainly for the Albanian consumer, which constitutes a necessity for building and establishing a balanced legal relationship between businesses and consumer transactions during the signing of the sales contract in electronic form.

For this area in Albania, a number of laws have been adopted, which constitute the legal framework for the functioning of electronic commerce, specifically the sales contract in electronic form. But in spite of this fact, we conclude that the Albanian consumer continues to be still distrustful and skeptical of legal relations between vendors and online buyers. Within this area, Albania has adhered to the European Union Directive on electronic commerce Directive 2000/31 / EC on Electronic Signature and Directive 1999/93 / EC on Distance Laying 997/7 / EC), enabling the approximation of a high level of our legislation, in the light of these directives. While on the international level there is the UNCITRAL 1996 model law, which is little known for our legislation.

In this context, we specify that the purpose of this dissertation is to study the sales contract electronically at international and national level, analyzing the principles of contractual electronic sales law within the European Union Directives and the UNCITRAL model law, which aim at protecting the contracting parties during the signing of the sales contract in electronic form, and focusing on the judicial practices of foreign countries in the absence of Albanian cases.

Keywords: electronic sales contracts, electronic commerce, internet, electronic signature

DEDIKIMI

FAMILJES SIME

Dy Prindërve më të mrekullueshëm dhe të shtrenjtë,

Shabanit dhe Verës,

Dhe tre motrava më të mrekullueshme dhe të veçanta,

Fluturës, Blerinës, dhe Klodjanës.

FALENDERIME

Të mendosh dhe të punosh intensivisht brenda një kohe të caktuar, janë dy koncepte të vështira për tu realizuar..

“Vetëm nëpërmjet mirënjohjes, jeta bëhet më e pasur”

Mirënjohje dhe falenderime shumë të vecanta, të përzemërta shkojnë për Henri Çili, që mbështeti studimet e mia për vite më radhë duke më motivuar, suportuar në çdo moment të me energjinë e tij pozitive të pashtershme. Shpresoj që sloganin e UET-it, "E bën dot", ta kemi realizuar me sukses! Krenari dhe shumë mirënjohje për ty Henri!

Një falenderim i veçantë shkon, për udhëheqësen time Shkencore prof. Dr. Endira Bushati, për mbështjen profesionale dhe akademike në përgatitjen dhe përfundimin e këtij disertacioni.

Falenderoj të gjithë stafin akademik të Universitetit Europian të cilët kanë qenë suport i vecantë, prej të cilëve kam marrë dije dhe njohuri. Do të vecoja në me këtë rast në mënyrë të nderuar prof. Dr. Ksenofon Krisafi, prof. Dr. Ferit Duka., prof. Besnik Maho., prof. Romeo Gurakuqi., prof. Dr. Erjona Canaj, prof. Dr. Hemion Braho., prof. Dr. Juelda Lamce., prof. Migena Leskoviku të cilët kanë dhënë një kontribut të vecantë në formimin tim akademik, duke përforcuar tek unë dijen, përgjegjësinë dhe mbi të gjitha drejtësinë, si një ndër vlerat më të rëndësishme njerëzore.

“Më mirë një mik sesa një cilig”..Miq të janë gjithmonë aty kur ti ke nevojë...në këtë rast gjej momentin të falenderoj pafund... Përzemërsisht faleminderit, Jonida B., Vera P., Anila M., Blerina T., Klea K., Eugena A., Andja L., Iris M. Iris B., Tereza K., , për të gjithë kohën e pakushtëzuar, besimin, dashurinë dhe dëshirën për të më dëgjuar dhe për të më ofruar këshillat më të vyera që më keni dhënë dhe vazhdoni të me jepni..njekohësisht duke ju kërkuar ndjesë për ditët që nuk kam mundur të jem e pranishme me ju.

Falenderoj Z. Dritan Monka, Drejtor i Përgjithshëm i Sherbimeve Postare, për gatishmërinë për të ofruar ndihmën e nevojshme në lidhje me statistikat e shërbimeve postare dhe për intervistën e dhënë enkas në funksion të këtij puimi. (për intervistën e realizuar në kuadër të këtij studimi dhe për statistikat në lidhje me blerjet online).

Më së shumti do të doja të falënderoja familjen time mahnitëse për dashurinë, mbështetjen, qëndrueshmërinë, inkurajimin që kam marrë gjatë gjithë këtyre viteve, deri në pafundësi! Babain tim e falenderoj sepse ka pasur përherë durimin dhe qetësinë që të jetë shoku im më i mirë, duke më dhuruar shumë dashuri, këshilla dhe përkushtim deri në sakrifica shumë të mëdha. E dua pafund! Nënë time, e falenderoj sepse ka qenë përherë krah meje, duke më shtyrë që në moshë të vogël duke më motivuar gjithmonë drejt dijes, e cila është adhuruese e fortë e shkollës. Ajo gjithmonë ka gjetur kohën dhe dëshirën për të më treguar se “çdo sfidë kalohet duke e sfiduar”.

Falenderoj, motrën time të madhe Fluturën, e cila gjithmonë ka qenë dhe është simbol i mirësisë, forcës, energjisë, suportit sëbashku me bashkëshortin e saj, Arbenin, të cilin e

falenderoj, pasi zë një vend të rëndësishëm në familjen tonë prej shumë vitesh, duke na suportuar dhe motivuar gjithmonë drejt një të ardhmje më të mirë. Mbesën e mëncur Bernicen dhe nipin diplomatik Jason, i falenderoj për dashurinë e pafundme, buzëqeshjen që më kanë dhuruar gjatë këtyre viteve. Për të katërt ju..dhe pse keni qenë larg nesh fizikisht gjithmonë keni qenë mbështetja jonë më e madhe.

Falenderoj Blerinën, motra e cila është simbol energjisë pozitive, ndër vite është dashur të më durojë më shumë se askush, gjatë gjithë viteve akademike, duke qenë gjithmonë e gatshme, për të më ndihmuar, këshilluar, qetësuar. Është shoqja ime më e ngushtë, kolege, mike, është gjithcka për mua!

Falenderoj Klodjanën, motra e cila është simbol i qetësisë, durimit, pozitivitetit, bashkëpunimit..e falenderoj gjithmonë sepse më ka dhënë kurajo duke më mbështetur në cdo moment gjatë gjithë këtyre viteve akademike.

Mirënjohje dhe falenderime të përzemërta për bashkëshortin dhe familjane bashkëshortore, të cilët në mënyrë të vazhdueshme më kanë mbështetur, inkurajuar, besuar dhe motivuar për përfundimin me sukses të këtij disertacioni akademik disa vjecar. Si dhe dua të falenderoj ato që mund ti quaj prindër të dytë Vlash Vlasi dhe Liza Vlasi, të cilët më kanë dhuruar shumë dashuri që nga dita e parë që i kam takuar dhe çdo ditë dhe që janë gjithmonë të gatshëm për të më suportuar në çdo aspekt. Falenderoj Julin dhe Inën, të cilët gjithmonë më kanë qëndruar pranë duke më ofruar përkujdesje, mbështetje morale dhe shumë dashuri! Falenderoj në mënyrë të veçantë dashurinë e jetës, Gertin i cili në cdo kohë më ka qëndruar pranë përgjatë gjithë këtij udhëtimi të gjatë dhe të bukur njëkohësisht. E falenderoj sepse për mua ai ka qenë burim frymëzimi, dashurie, përkudësje, suport,

Falenderimi më i madh shkon Dashuri pa fund, mirënjohje dhe falenderime të përzemërta për familjen time dhe të cilët në mënyrë të vazhdueshme më kanë mbështetur, inkurajuar, besuar dhe motivuar për përfundimin me sukses të këtij disertacioni akademik disa vjecar.

Nisur nga ky pohim dua të them se, gjithmonë kisha menduar se përfundimi i këtij punimi kërkimor – shkencor do të bëhej i mundur brenda një afati të shkurtër kohor..por në të vërtetë, më rezultoi i kundërta.

Gjithashtu, mirënjohje dhe falenderime për të gjithë miqtë dhe kolegët që më mbështetën me këshillat e tyre për gjatë gjithë këtij procesi doktorat dhe stafin e UET të cilët më gatisëmërinë dhe profesionalizmin e tyre kontribuan në zhvillimin e suksesshëm të këtij punimi.

Mbi gjithcka, falenderoj Zotin që më dhuroi jetë, shëndet, dëshirë dhe vullnet për përgatitjen dhe finalizimin me sukse të këtij punimi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I

1.1 Hyrje dhe bazimi teorik.....	1
1.2 Shtrimi i problemit.....	6
1.3 Objektivat e studimit.....	7
1.4 Qëllimi i studimit.....	8
1.5 Rishikimi i literaturës.....	10
1.6 Hipoteza e punimit.....	14
1.7 Pyetjet kërkimore të punimit.....	15
1.8 Metodatat dhe metodologjia e kërkimit.....	17
1.9 Kufizimet e studimit.....	19
1.10 Rëndësia e studimit.....	20
1.11 Përmbledhja dhe strukturimi i punimit.....	21

KAPITULLI II: ZANAFILLA E LINDJES DHE EVOLUIMIT TË KONTRATËS SË SHITJES NË FORMË ELEKTRONIK

2.1 Aspekte teknologjike për lidhjen e kontratës së shitjes në formë elektronike.....	23
2.2 Impakti i rëndësishëm i internetit në zhvillimin e kontratës së shitjes “ <i>offline</i> ” deri në versionin e saj në formë elektronike, “ <i>online</i> ”	24
2.3 Tregtia elektronike si katalizator për zhvillimin e kontratës së shitjes në mënyrë elektronike.....	31
2.4 Zanafilla e kontratës së shitjes në formë elektronike.....	35
2.5 Përkufizimi i kontratës së shitjes në formë elektronike sipas ligjit për tregtinë elektronike.....	36
2.6 Nevoja për përdorimin e kontratës së shitjes në formë elektronike.....	36

KAPITULLI III: RREGULLIMI LIGJOR DHE PRAKTIKA GJYQËSORE E KONTRATËS SË SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

3.1. Ligjet Model UNCITRAL-it në rrjedhën kronologjike.....	38
3.1.2 Ligji Model UNCITRAL “Për Tregtinë Elektronike”, i vitit 1996.....	39
3.2 Llojet e Tregtisë Elektronike.....	42
i. B2B (biznes- biznes).....	42
ii. B2C (biznes- konsumator).....	43
iii. C2C (konsumator- konsumator).....	44
iv. B2G (biznes- qeveri).....	44
vi. C2B (konsumator- biznes).....	44
3.1.3 Ligji Model i UNCITRAL “Për Nënshkrimin Elektronik”, 2001.....	45
3.3 Konventa mbi Përdorimin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare (KKEKN), UNCITRAL 2006.....	51
3.4 Konventa Mbi Përdorimin e Pomunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare (KKEKN), UNCITRAL 2006, në vështrim krahasues me Konventën e Shitjes Ndërkombëtare të Mallrave (CISG)	55
3.5 Llojet e kontratave elektronike në nivel ndërkombëtar ilustruar nëpërmjet praktikës gjyqësore.....	61
3.5.1 Shrink-Wrap.....	61
i. ProCD, Inc. kundër Zeidenberg, 1996.....	61
ii. Mortenson Company, Inc. kundër Timberline Software Corporation, 2000.....	62
iii. Edmond kundër Gateway, 2000,.....	62
3.5.2 Click-Wrap.....	63
i. Treiber & Straub, Inc. kundër UPS, 2007.....	63
ii. Costar Realty Info., Inc kundër Field, 2009.....	64
iii. Segal kundër Amazon.com, 2011.....	64
3.5.3 Browse-Wrap.....	65
i. Specht kundër Netscape Commc'ns Corp, 2002.....	65
ii. Southwest Airlines kundër Boardfirst, 2007.....	66

<i>iii. Cvent, Inc. kundër Eventbrite, 2010</i>	67
3.6 Kushtet elektronike të ICC, 2004,	70
3.7 Udhëzimi i ICC për kontraktimin elektronik, 2004.....	71
3.8 Plan- veprimi global i ICC për biznesin elektronik, 2002.....	72
3.9 Udhëzimet e OECD- së për mbrojtjen e konsumatorëve në kontekstin e tregtisë elektronike.....	72

KAPITULLI IV: LEGJISLACIONI I BE-SË DHE PRAKTIKA GJYQËSORE PËR KONTRATËN E SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE

4.1 Direktivat e Bashkimit Europian.....	82
4.1.1 Direktiva 95/ 46- KE- për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.....	83
i. <i>C-362/14, Schrems kundër Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave, 2015</i>	81
4.1.2 Direktiva Europiane, 20 Maj 1997 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve”.....	90
4.1.3 Direktiva 97/7/CEE “Për kontratat në largësi”, datë 20/05/1997.....	92
4.1.4 Direktiva Europiane 8 qershor 2000, “Mbi Tregtinë Elektronike”.....	94
4.1.5 Direktiva 2002/ 58- KE- për “e- Privatësinë”.....	95
4.1.6 Direktiva 2006/ 24- KE- “Mbi Ruajtjen e të Dhënave”.....	96
i. <i>C-11445/ 2001, datë 6 shtator 2001</i>	98

KAPITULLI V: KONTRATA E SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE SIPAS LEGJILSACIONIT SHQIPTAR.

5.1 Kuadri ligjor vendas në lidhje me kontratën e shitjes në formë elektronike.....	101
5.1.1 Cilat janë kushtet e përgjithshme që duhet të përmbushë kontrata e shitjes në formë elektronike sipas Kodit Civil Shqiptar?.....	105
5.1.2 Kontrata e shitjes në formë elektronike sipas ligjit “Për tregtinë elektronike”.....	106
5.1.3 Subjektet e kontratës së shitjes në formë elektronike.....	110
5.1.4 Objekti i kontratës së shitjes në formë elektronike.....	111
5.1.5 Informacioni që duhet ofruar.....	118
5.1.6 Lidhja e kontratës së shitjes në formë elektronike.....	121

5.1.7 Kontratat që nuk mund të lidhen në formë elektronike.....	125
5.1.8 Rëndësia dhe përgjegjësia e ndërmjetësit.....	127
5.1.9 Paguesa dhe mënyrat e pagesës.....	129
5.2.1 Rëndësia e parasë elektronike.....	132
5.2.2 Forma e ligjore që kërkohet për nënshkrimin e kontratës elektronike.....	133
5.2.3 Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktore.....	136
5.2.4 Ligji i zbatueshëm dhe juridiksionet kompetente.....	139
5.2 Autoritete mbikqyrëse.....	149
<i>i. Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve.....</i>	<i>149</i>
<i>ii. Autoriteti Kombëtar për Çertifikimit Elektronik.....</i>	<i>152</i>
<i>iii. AKEP/Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....</i>	<i>152</i>
5.3 Të dhëna statistikore sipas Shërbimit Postar në Shqipëri.....	153
5.4 TVSH-ja dhe taksa doganore për blerjet online.....	155
5.5 MBROJTJA E KONSUMATORIT, SI GARANCI PËR ZHVILLIMIN E	
KONTRATËS SË SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE.....	
5.5.1 Evoluimi ligjor i konceptit të konsumatorit pas viteve '90 deri në ditët e sotme në Shqipëri.....	158
5.5.2 Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.....	158
5.5.3 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.....	160
5.5.4 Ligji nr. 8192, datë 06.02.1997 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.....	161
5.5.5 Ligji nr. 9135, datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve.”.....	162
5.5.6 Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve.”.....	164
5.5.7 Neni 3 I ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”,.....	165
 KAPITULLI VI	
KONLUZIONE.....	167
REKOMANDIME.....	173
BIBLIOGRAFIA.....	175
SHTOJCA.....	188

LISTA E SHKURTIMEVE

AKCE	Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKTI	Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
ALCIRT	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike
BE	Bashkimi European
BSH	Banka e Shqipërisë
E-commerce	Tregtia Elektronike
e-Services	Shërbime elektronike
EUROSTAT	Zyra e Statistikave e Komunitetit Evropian
ENISA	Agjencia e Bashkimit European për Sigurinë e Rrjeteve të Informacionit
INSTAT	Instituti i Statistikës
ISP	Internet Service provider (Ofruesi i shërbimit Internet)
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KE	Komisioneri European
KKEKN	Konventa mbi Përdorimin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare
SNAD	Strategjia Ndërsektorale e Axhendës Dixhitale
UETA	Uniform Electronic Transactions Act
CISG	Shitja Ndërkombëtare e Mallrave
OECD	Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

B2B	Biznes- Biznes
B2C	Biznes- Konsumator
C2C	Konsumator- Konsumator
C2B	Konsumator- Biznes
UNICTRAL	Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Tregtare
EJC	European Court of Justice (Gjykata Europiane e Drejtësisë)
ECD	Direktiva e Tregtisë Elektronike (Electronic Commerce Directive)
ONMK	Organizata Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Konsumatorit

FJALOR LIGJOR I TERMAVE

Konsumator - është çdo person, i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit.

Tregtar- është çdo person fizik ose juridik, i cili vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike, tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin, si dhe cilido, që vepron në emër ose në interes të tregtarit.

Garanci kontraktuale- është çdo marrje përsipër, pa pagesë shtesë, e detyrimeve nga shitësi apo prodhuesi ndaj konsumatorit, për rimbursimin e çmimit të paguar ose për zëvendësimin apo për riparimin e mallit, për ta sjellë në përputhje me kushtet e vëna në deklaratën e garancisë ose në publicitetin përkatës.

Shërbimet e shoqërisë së informacionit- janë shërbimet, që ofrohen përkundrejt pagesës, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit

Në distancë- nënkuptohet se shërbimi ofrohet pa qenë e nevojshme që të dyja palët të jenë të pranishme në të njëjtën kohë.

Nëpërmjet mjeteve elektronike- nënkuptohet se shërbimi dërgohet nga pika e origjinës dhe merret në destinacionin përfundimtar, me anë të pajisjeve elektronike, për përpunimin (përfshirë edhe kompresimin numerik) dhe ruajtjen e të dhënave.

Dërgimi, transmetimi dhe marrja e plotë bëhen nëpërmjet kablllove, radiovalëve, mjeteve optike dhe mjeteve të tjera elektromagnetike.

Me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit- nënkuptohet se shërbimet ofrohen nëpërmjet transmetimit të të dhënave, me kërkesë individuale të marrësit. Shërbimet e shoqërisë së informacionit përfshijnë, në veçanti, shitjen e mallrave e të shërbimeve, shërbimet e aksesit të informacionit apo të reklamave në internet e të aksesit në shërbimet e rrjeteve publike të komunikimit, transmetimin e të dhënave ose ruajtjen e të dhënave të marrësit në rrjetin publik të komunikimeve.

Ofruesi i shërbimit- është çdo person fizik ose juridik, që ofron një shërbim të shoqërisë së informacionit.

Konsumator- është çdo person fizik, i cili blen ose përdor mallra a shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime, të cilat nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin ose ushtrimin e profesionit.

Tregti elektronike- është kryerja nga subjektet e këtij ligji të një veprimtarie, nëpërmjet shkëmbimit të dokumenteve elektronike, për tregtimin e mallrave dhe/ose të shërbimeve.

Të dhëna personale- është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Dokument elektronik- është çdo informacion i krijuar me “cilësi dokumentare”, i dërguar, i marrë ose i ruajtur në formë elektronike nga një sistem kompjuterik apo nga një mekanizëm i ngjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshmërinë, në përputhje me nenet 5 deri në 9 të këtij ligji. Përmbajtja e dokumentit elektronik përfshin të gjitha format e të dhënave, pasqyruar me shkronja, numra, simbole, zë dhe imazh.

Sistem i informacionit- është rrjeti i komunikimit të informacionit, që përfshin një bashkësi programesh, mjetesash të komunikimit elektronik dhe informacionit, metodat dhe procedurat e zbatueshme për përgatitjen, dërgimin, marrjen, kontrollin dhe sigurinë e dokumentit elektronik.

Nënshkrim elektronik- janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar.

Certifikatat e kualifikuara- janë certifikatat e lëshuara nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit, në përputhje me këtë ligj, që përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Certifikatat- janë vërtetime elektronike, të cilat lidhin kodet kontrolluese të nënshkrimeve me një person dhe konfirmojnë identitetin e tij.

Cenim i të dhënave personale- është çdo cenim i sigurisë që çon në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin oseshpërndarjen e paautorizuar, aksidentale apo të paligjshme ose aksesit në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara, në lidhje me ofrimin e një shërbimi të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun.

Ofruesi i shërbimit- është çdo person fizik ose juridik, që ofron një shërbim të shoqërisë së informacionit.

Marrësi i shërbimit- çdo person fizik ose juridik, i cili, për qëllime profesionale a të ndryshme, në mënyrë të veçantë, për qëllime të kërkimit të informacionit dhe bërjen e tij të aksesueshëm, përdor një shërbim të shoqërisë së informacionit.

Të dhëna personale- është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Të dhëna sensitive- është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Sistem kompjuterik- konsiderohet një sistem i ndërlidhur kompjuterësh që ndajnë një sistem ruajtje qendror dhe pajisje të ndryshme periferike.

Harmonizim i legjislacionit- nënkupton përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis*–comunitaries nëpërmjet gjetjes së një metodike të përbashkët duke respektuar veçoritë legjislative kombëtare.

Të dhëna kompjuterike- konsiderohet çdo informacion i procesuar dhe/ ose ruatjur në një kompjuter.

KAPITULLI I

1.1 HYRJE DHE BAZIMI TEORIK



Douglas Engelbart, shpikësi i miut të kompjuterit thoshte se:

“Revolucioni dixhital është shumë më i rëndësishëm se shpikja e të shkruarit...”

Kjo shprehje që në fillimet e saj dukej si një ekzagjerim i këndshëm, ndërsa është sot një realitet evident në çdo fushë të jetës. Në të vërtetë revolucioni dixhital, është zhvilluar me një ritëm që nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër dhe ky zhvillim ka pasur një ndikim vendimtar në shoqërinë njerëzore dhe në jetët tona.¹

Teknologjitë dixhitale janë duke transformuar shoqërinë dhe ekonominë në të gjithë globin. Duke lidhur njerëzit, vende dhe gjithnjë e më shumë gjëra me një shpejtësi të

¹ Roli dhe Zhvillimi I E- Gov në Shqipëri, pjesa e I. Departamenti i Administratës Publike, Korrik 2010, faqe 11.

paimagjinueshme, interneti po krijon një sistem nervor të ri global që është në thelbin e të gjitha shkëmbimeve ndërkombëtare.²

Vitet e fundit është bërë një progres i ndjeshëm, në drejtim të qeverisjes elektronike; lehtësimit të biznesit përmes kryerjes së shërbimeve on-line; reformave të ndërmarra në kuadër të përmirësimit të regjimit rregullator ligjor. Po kështu është rritur edhe ndërgjegjësimi për përfitimet nga teknologjia e informacionit dhe shkalla e përdorimit të internetit nga bizneset dhe qytetarët sidomos për brezin e ri.³Zhvillimet teknologjike dhe ardhja e internetit kanë çuar në paradigmat e reja,aktivitetin tregtar ndërkombëtar si dhe atë lokal.⁴

Interneti dhe përdorimi i tij në ditët e sotme, është bërë i domosdoshëm. Ky fakt, ndikon në shoqërinë njerëzore jo vetëm në jetën e përditshme të tyre, por edhe në komunikimin kulturor, social dhe ekonomik, si dhe konkretisht në fushën e marrëdhënieve midis shitësve dhe blerësve.Në këtë pikpamje, themi se, shkurtimi i distancave midis palëve të cilët bëhen pjesë e një marrëdhënie kontraktuale të caktuar, e cila realizohet ndërmjet subjekteve të ndryshëm që operojnë në vende të ndryshme, për realizimin e shkëmbimeve dhe transaksioneve tregtare në internet në mënyrë direkte dhe indirekte,sollën nevojën e përdorimit të kontratave të ndryshme elektronike.

² Translactic Digital Economy and Data Protection: State of Play and Future Implications for the EU's External Policies, 2016, faqe 7.

³ Roli dhe Zhvillimi I E- Gov në Shqipëri, pjesa e I. Departamenti i Administratës Publike, Korrik 2010, faqe 12.

⁴<https://www.sans.org/reading-room/whitepapers/legal/electronic-contracting-insecure-%C3%ABorld-2088>, Rasch, 2006

Shitja është kontrata më e rëndësishme mes kontratave të tjera, me anë të të cilave realizohet qarkullimi i pasurisë në kuptimin më të gjerë të kësaj shprehje.⁵ Në Kodin Civil, kontrata e shitjes rregullohet në Titullin II, në Kreun I dhe koncretisht në nenin 705, në të cilin përcaktohet se: *“kontrata e shitjes ka për subjekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një cmimi”*.⁶

Në vijimësi themi, se ndryshe nga dikur, në ditët e sotme, në epokën elektronike, i gjithë transaksioni elektronik mund të përfundojë në sekonda, pra palët kontraktuese nëshkruajnë elektronikishtkontratën e shitjes në formë elektronike nga vende të ndryshme, pra pa qenë e nevojshme prezenca e tyre fizike. Tani shumë vende kanë miratuar ligje për të njohur kontratën e shitjes në formë elektronike. Si rezultat i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, vëndi ynë miratuar legjislacion mbi tregtinë elektronike në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian.

Sipas nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: *“kontrata, është një veprim juridik me anë të të cilit palët krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*. Kjo dispozitë ligjore vlen edhe për përkufizimin e kontratave elektronike, por dallimi konsiston nëmënyrën sesi kontratat elektronike krijohen, ndryshohen dhe shuhen në formë elektronike. Në këtë pikpamje, rezulton se, kontrata elektronike është një marrëveshje juridikee cila realizohet dhe nënshkruhet në formë elektronike. Ligji për Tregtinë Elektronike i përkufizon kontratat elektronike si: *“Kontrata e lidhura përmes mjeteve të lidhura në mënyrë elektronike, quhen kontrata elektronike”*. Ajo quhet e lidhur kur ofruesi merr një mesazh elektronik i cili përmban deklarimin e marrjes së konfirmimit

⁵ F. Galgano, E drejta Private, Tiranë 1999, faqe 519.

⁶ I. Mustafaj, Detyrimet dhe Kontratat, Tiranë 2016, faqe 191.

dhe pranimin e ofertës. Si e tillë, propozimi dhe pranimi i ofertës mund të bëhen nëpërmjet mjeteve elektronike, që është forma elektronike e tyre.

“Në çdo rast, që kontrata elektronike të jetë e vlefshme, duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara nga Kodi Civil, për pjesën e përgjithshme të kontratave, kërkesat e parashikuara për formën konkrete të kontratës, të parashikuar nga Kodi Civil dhe kërkesat e veçanta⁷, të parashikuara në ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore argumentojmë se, është pikërisht mënyra e lidhjes së kontratës ajo që bën dallimin e kontratës në formëelektronike nga ajo tradicionale.Kontrata elektronike është dokument elektronik, i cili duhet që të përmbushë kriteret e vlefshmërisë ligjore sipas nenit 5 të ligjit për Dokumentin Elektronik. Për të shmangur sa më shumë problemet në lidhje me provueshmërinë dhe me vërtetësinë e kontratës, është bërë mundur nënshkrimi elektronik, i cili parashikohet në Direktivën e Parlamentit Europian e datës 13 dhjetor 1999, në kuadrin e komunitetit për nënshkrimin elektronik. Nga pikpamja juridike e kësaj direktive behet e mundur njohja e nënshkrimit elektronik.⁸

Konludojmë se, dokumenti elektronik, duhet të përmbajë edhe nënshkrimin elektronik në mënyrë që të bëhet i mundur identiteti i nënshkruesit dhe vërtetësia e dokumentit elektronik. Në mënyrë që të adresohen rreziqet që lidhen me tregtinë elektronike, mund të aplikohen instrumente të ndryshme mbrojtëse të konsumatorit. Në fushën e së drejtës së kontratës, këto kryesisht përfshijnë detyrat informative dhe të drejtën e tërheqjes.⁹ E drejta e tërheqjes zakonisht ka për qëllim të mbrojë një palë që, në një farë mënyre konteksti ose

⁷Ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve

⁸ LOOS/HELBERGER/GUIBAULT/MAK, p. 738.

⁹ BINDING/PURNHAGEN, p. 187, No. 4f.

një lloj i caktuar i kontratës, konsiderohet të ketë nevojë për mbrojtje.¹⁰ Zakonisht përdoret në kontratat e konsumatorëve për të mbrojtur konsumatorin nga marrja e vendimeve të acaruar, duke i dhënë asaj mundësinë gjatë një periudhe relativisht të shkurtër "të ftohjes", për t'u kthyer në vendimin e saj për të lidhur një kontratë.¹¹

¹⁰ LOOS/HELBERGER/GUIBAULT/MAK, p. 738.

¹¹ LOOS (2009), p. 239.

1.2 SHTRIMI I PROBLEMIT

Në kuadër të globalizimit, interneti dhe tregtia elektronike, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbarë botën për shkak të ndryshimit të madh që kanë krijuar në mjedisin e biznesit. Sot, ndodhemi nëkushtet kur produktet dhe shërbimetë ndryshme mund të blihen në internet nëpërmjet kontratës së shitjes në mënyrë elektronike. Kjo formë re e tregtisë elektronike, ka ndikuar në mënyrë revolucionare përsa i përket të bërit biznes, duke sjellë avantazhe dhe disavantazhe, nga njëra anë për konsumatorët dhe nga ana tjetër për bizneset. Konsumatorët mund të porosisin artikujt në internet duke nënshkruar kontratën e shitjes në mënyrë elektronike duke kryer pagesën në mënyra të ndryshme, përmes transaksioneve elektronike bankare.

Parë në këtë këndvështrim, themi se, edhe në vendin tonë gjatë viteve të fundit, vërehet dukshëm zhvillimi i internetit. Gjithashtu nënshkrimi Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, ka rritur ndjeshëm përdorimin e kontratës së shitjes në mënyrë elektronike. Problemi i privatësisë dhe i sigurisë në internet zë një interes të madh ligjor dhe shqetësim për shumë njerëz, duke shkaktuar në këtë mënyrë një lloj mosbesimi në marrëdhëniet që krijohen në fushën e tregtisë elektronike, dhe në veçanti në raportin e marrëdhënieve kontraktore të shitjes në mënyrë elektronike.

Në këtë këndvështrim, theksojmë se, problemi kryesor i këtij studimi qëndron tek *dëshmia e marrëveshjes kontraktore*, e cila do të jetë veçse një dokument i kompjuterizuar, duke krijuar rrezik për palët kontraktore, përsa i përket ndryshimit të dhënave nga një palë e tretë anonime, të cilat administrohen në kompjuter.

1.3 OBJEKTIVAT STUDIMIT

Studimi është strukturuar nën dritën e fushës kontraktuale, konkretisht, në kontratën e shitjes në formë elektronike, duke u bazuar në disa objektiva:

Së pari: Studimi fokusohet në zanafillën e lindjes dhe evoluimit të kontratës së shitjes në formë elektronike, si dhe faktorët që ndihmuan në zhvillimin e saj. Nga njëra anë roli i internetit si zhvillim teknologjik nga kontrata e shitjes “offline” në versionin e saj “online”, si domosdoshmëri dhe nga ana tjetër funksionimi i tregtisë elektronike si katalizator për transaksionet në rrugë elektronike.

Së dyti: Studimi fokusohet në rregullimet ligjore të kontratës së shitjes në formë elektronike në nivel ndërkombëtar (referuar ligjit model UNICTRAL, Konventës KKEN dhe Konventës CISG) dhe europian (referuar direktivave të Bashkimit European), duke e ilustruar me raste konkrete nga praktika gjyqësore e huaj.

Së treti: studimi fokusohet në elementët e kontratës së shitjes në formë elektronike, momenti i lidhjes, formën ligjore të saj si disa prej karakteristikave specifike të saj, sipas legjislacionit shqiptar, bazuar mbi Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe mbi Ligjin për Tregtinë Elektronike.

Së fundmi, objektiv i rëndësishëm është gjithashtu dhe fakti që ky studim, të shërbejë si bazë e rëndësishme për nisjen e studimeve të reja në këtë fushë kontraktuale elektronike, të nxisë kritikën si dhe të përdorën të gjitha përfundimet e kësaj teme diplome dhe gjetjet kërkimore si bazë e shëndoshë për studime të tjera, duke garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e këtyre gjetjeve.

1.4 QËLLIMI I STUDIMIT

Nëpërmjet studimit dhe punimit të kësaj tematike e cila është një temë shumë aktuale dhe e ndërlikuar me një sërë elementësh studimorë e cila përbën risi për vendin tonë Shqipërinë, dhe njëkohësisht merr rëndësi për të qenë një një çështje moderne globale për shkak të natyrës dinamike që ka si kontratë, kemi si qëllim që të japim kontributin tonë në lidhje me zhvillimet dhe hulumtimet si dhe evidentimin e problematikave përkatëse të kësaj fushe kontraktuale me natyrë specifike për sa i përket mënyrës së lidhjes së saj nëpërmjet nëshkrimit elektronik.

Ky punim doktoral, ka si qëllim të studiojë në mënyrë të detajuar kontratën e shitjes në mënyrë elektronike si institut i së drejtës në nivel evropian dhe ndërkombëtar, duke përshkruar krijimin e saj në aspektin historik dhe juridik si dhe duke analizuar parimet bazë për realizimin e kësaj kontrate dhe çdo dispozitë ligjore për mbrojtjen dhe garantimin e kësaj të drejte.

Gjithashtu ky studim ka si qëllim që të bëjë një trajtim/ analizë mbi rregullimet ligjore ndërkombëtare mbi ligjin model UNCITRAL., KKEKN, Rekomandimet e OECD-së për mbrojtjen e konsumatorëve..etj., si dhe direktivat e Bashkimit Evropian, në funksion të kontratës së shitjes elektronike, duke e ilustruar me raste specifike nga praktika gjyqësore e huaj, në mungesë të praktikës gjyqësore shqiptare.

Një tjetër qëllim i studimit është edhe analiza ligjore mbi kontratën e shitjes në formë elektronike sipas legjislacionit shqiptar, i cili studiohet në përputhje me harmonizimin e legjislacionit evropian. Një ndër qëllimet kryesore të këtij disertacioni, është edhe analiza

lidhur me pozitën juridike të konsumatorit si pala më e rrezikuar në marrëdhënien kontraktore të shitjes elektronike.

1.5 RISHIKIMI I LITERATURËS

Në rishikimin e literaturës së një punimi të caktuar kërkimor- shkencor, synimi është që të njohim mbi dijet ekzistuese, mbi punën dhe përpjekjet që kanë bërë të tjerët, punë e cila është botuar si literaturë shkencore, konkretisht referuar temës së studimit, mbi fushën e së drejtës kontraktuale të shitjes në formë elektronike. Në këtë pikpamje, theksojmë se, qëllimi kryesor i rishikimit të literaturës është, ti japi kërkuesit, lexuesit dhe studjuesit një kuptim të pasur mbi dijen dhe kërkimin e propozuar. Duke shqyrtuar literaturë të ndryshme për këtë temë disertacioni doktorale, përta i përket legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar si dhe vendimit të gjykatave të huaja, është vërejtur se:

Ndërsa praktika e lidhjes së kontratave rritet dhe zhvillohet në mënyrë elektronike, një çështje tjetër interesante që gjykatat mund të hasin në një pikë në të ardhmen është ajo se, a mund të lidhet një kontratë midis dy kompjuterëve që veprojnë në kohën e shkëmbimit pa kontributin e njeriut? Me fjalë të tjera, a mund të bëjë një kompjuter një kontratë me një kompjuter tjetër dhe ta bëjë atë kontratë të detyrueshme për pronarët e kompjuterëve, domethënë, kompjuterat që shihen si agjentë elektronikë të pronarëve. Një kontratë sigurisht konsiderohet se kërkon një mbledhje të mendjeve (koncensus ad idem) të palëve të interesuara edhe pse sigurisht që ligji e ka njohur gjatë aftësinë për të hyrë në kontrata përmes agjentëve (qui facit per alium facit per se), por që njohja tradicionalisht u kufizuanë kapacitetin e agjencisë nga qeniet njerëzore ose nga persona juridikë të njohur si kompanitë dhe kështu me radhë.¹²

¹² (The United Kingdom Journal) Information Communications Technology and E-Commerce: Challenges and Opportunities for the Nigerian Legal System and Judiciary, (THE IMPACT OF ICT IN CONTRACT FORMATION AND E-COMMERCE DEVELOPMENT IN TANZANIA).

Gjithashtu, teknologjia e komunikimit të informacionit, paraqet disa sfida për gjykatat në aspektin e përdorimit të dokumenteve elektronike si dëshmi. Në rrethana të zakonshme, domethënë, pa përdorimin e certifikimit, për shembull, dokumentet elektronike kanë një cenueshmëri të veçantë në atë që ndryshimet e qëllimshme ose të pavlefshme mund të jenë të vështira për t'u zbuluar nëse jo krejtësisht të padeklarueshme. Përveç kësaj, shumica e dokumenteve elektronike të tenderuara ka të ngjarë të jenë kopje të përmbajtjes origjinale të të dhënave të dokumentit në aspektin e mënyrës së funksionimit të sistemeve të informacionit, veçanërisht sistemeve të rrjetit. Këta faktorë paraqesin sfida për gjykatat në kuptimin e disa koncepteve kryesore që bazohen në pranueshmërinë e provave të tilla si besueshmëria, rregulli më i mirë i provave, rregulli mbi thashethemet dhe në përgjithësi në lidhje me origjinalitetin dhe integritetin e dokumentit. Edhe nëse një dokument elektronik i plotëson testet që mund të përcaktohen për pranueshmërinë e tij, ekziston pyetja e mëtejshme se çfarë peshë duhet t'i bashkëngjitet këtyre provave...?¹³

Shfrytëzimi në rritje i transaksioneve tregtare ndërkombëtare dhe përdorimi i internetit është një tjetër shqetësim. Në të kaluarën, transaksionet ndërkombëtare tregtare në përgjithësi ishin të kufizuara në negociata didis subjekteve tregtare. Interneti ka rritur hapësirën e biznesit në marrëdhëniet e konsumatorëve, dhe madje edhe të konsumatorit për transaksionet e konsumatorit në të gjithë kufijtë e juridiksionit.¹⁴ Për këtë arsye, formimi i kontratës duke përdorur internetin, krijon segregacion në dy kategori fillestare. Këto

¹³(The United Kingdom Journal) Information Communications Technology and E-Commerce: Challenges and Opportunities for the Nigerian Legal System and Judiciary,(THE IMPACT OF ICT IN CONTRACT FORMATION AND E-COMMERCE DEVELOPMENT IN TANZANIA).

¹⁴Departamenti i Komunikimet, Republika e Afrikës së Jugut, 1999

kategori përfshijnë të dyja këto negociatat që ndodhin në mënyrë rigoroze brenda një juridiksioni të vetëm, dhe tjetra, ato negociata që përfshijnë shumë juridiksioneve ligjore.¹⁵

Një kontratë elektronike ka një strukturë të dyfishtë. Duke menduar në mënyrë elektronike, rezulton se, kontrata është një sekuençë e numrave dhe kodit të ruajtur në disa media elektronike ose magnetike.¹⁶

"Dokumentet elektronike," shkroi James Martin, "nuk duhet të jetë imitimi i dokumenteve letrë."¹⁷ Kontratat në formë elektronike mund të dallohen nga kontratat e letrave në mënyra të ndryshme, siç do të përshkruhet. Këto dallime, në një nivel, thjesht u ofrojnë palëve një sërë mjetesh të reja dhe më të fuqishme sesa kishin qenë në dispozicion me median më tradicionale. Shikuar në këtë mënyrë, kontratat elektronike do të sigurojnë një mekanizëm të ri për të formuar një marrëdhënie dhe për të garantuar disa veprime të ardhshme - në thelb të bëjë të njëjtën gjë si kontratat e letrës, vetëm në një mënyrë më të shpejtë. Megjithatë, efekti i përgjithshëm i këtyre dallimeve individuale na shtyn në drejtime të reja duke na shkaktuar që të mendojmë ndryshe për informacionin dhe njerëzit me të cilët ndërveprojmë. Kontrata elektronike nuk ekziston në hapësirë ashtu siç bën kontrata e letrës dhe nuk mund të përqendrojë vëmendjen tonë në të njëjtën mënyrë si kontrata e letrës. Kur marrëveshja elektronike i bashkon palët, shqetësimi i saj është më pak një dokument që ekziston në hapësirë sesa një burim informacioni që ekziston në hapësirë. Kjo ndryshon

¹⁵ A paper accepted on 14th Jan 2008, from SANS Institute Reading Room site, SANS Legal Issues in Information Technology and Information Security, LEG-523.

¹⁶ Bainbridge, 2000; Reed, 2004; Brownsword, 2000.

¹⁷ Vannevar Bush, "As We May Think", Atlantic Monthly 176, July, faqe 101-108.

mënyrën në të cilën mendojmë për të tashmen dhe të ardhmen dhe për mënyrën se si duhet të trajtohen mosmarrëveshjet dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin.¹⁸

Kontratat e letrës lidhin palët në një akt. Kontrata elektronike lidh palët në një proces. Për disa, ky ndryshim në fokus mund të duket revolucionar. Megjithatë, duket se duket se është shumë më pak revolucionar ndaj atyre aktiviteteve aktuale të biznesit të të cilëve përfshijnë negocimin dhe kryerjen e kontratave. Mund të befasojë shumë që të mësojnë se shumica e studimeve të përdorimit të kontratave në botën e biznesit kanë gjetur se shumica e shkeljeve të kontratave që duket se janë të detyrueshme nuk janë çështje gjyqësore. Steëart Macaulay, për shembull, gjeti se "menaxherët dhe tregtarët industrialë rrallë luftojnë për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me kontratat, duke preferuar përdorimin e teknikave të tjera të shmangies dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve".¹⁹

¹⁸M. Ethan Katsh, *Law in Digital World* (Oxford University Press: New York, 1995), fq

¹⁹ Stewart Macaulay, "Elegant Models", *Empirical Pictures and the Complexities of Contract*, 11 *Law and Society Review* 507 (1977).

1.6 HIPOTEZA DHE PYETJET KËRKIMORE TË PUNIMIT

Për realizimin e këtij studimi kam ngritur një hipotezë qendrore dhe tre nën-hipoteza.

Hipoteza Qendrore

Për kontratën e shitjes në formë elektronike, nga njëra anëjanë miratuar një sërë rregullash, ligjesh dhe direktivash por nga ana tjetër konsumatori shqiptar gjendet i pasigurtë nga pikpamja ligjore gjatë nënshkrimit të kësaj kontrate specifike, si rezultat i elementit të privatësisë dhe sigurisë, juridiksionit, cilësisë së produktit dhe mënyrës së pagesës.

1. Legjislacioni shqiptar është i plotë në përputhje me standartet europiane dhe ndërkombëtare.
2. Në jurisprudencën shqiptare nuk ka rast të iniciuar nga konsumatori shqiptar për shkelje të kontratës së shitjes elektronike.
3. Zhvillimi i internetit dhe komunikimet elektronike në Shqipëri kanë sjellë ndikim pozitiv përse i përket evoluimit të kontratës së shitjes në mënyrë elektronike.

1.7 PYETJET KËRKIMORE

Ky disertacion shoqërohet nga një sërë pyetjesh kërkimore, mbi të cilat bazohet ky studim.

- a. Si dhe ku lindi kontrata e shitjes në formë elektronike?
- b. Pse duhet ta përdorim kontratën e shitjes në formë elektronike?
- c. Cilët janë elementët e kontratës së shitjes në formë elektronike?
- d. Cilët janë elementët që ndihmojnë në zhvillimin e saj?
- e. Si e rregullon ligji material dhe procedural kontratën e shitjes në formë elektronike në Shqipëri?
- f. A gëzojnë të njëjtin status ligjor kontratat “online” në raport me ato “offline”?
- g. A është legjislacioni shqiptar në harmoni me standartet europiane dhe me ato ndërkombëtare?
- h. A i karespektuar Shqipëria kriteret legjislativ dhe procedural të përcaktuar nga Bashkimi Europian?
- i. A çënohet parimi i sigurisë juridike të kontratës së shitjes në formë elektronike në raport me mbrojtjen dhe pozicionin e konsumatorit?
- j. A shërben si një provë e një procesi të rregullt ligjor kontrata e shitjes në formë elektronike?
- k. Çfarë sanksionesh ligjore parashikohen nga legjislacioni shqiptar në rastet kur nuk respektohen kushtet dhe kriteret e kontratës së shitjes në formë elektronike?
- l. Si garantohet siguria juridike e konsumatorit në kontratën e shitjes elektronike?
- m. A ka nevojë nevojë për reforma legjislative mbi kontratën e elektronike të shitjes në

Shqipëri?

n. Cilat janë pasojat e mungesës së praktikës gjyqësore gjyqësore shqiptare?

1.8 METODOLOGJIA E KËRKIMIT DHE METODAT

Metodologjia ka si qëllim që të pasqyrojë mënyrën sesi në kemi arritur në përvetësimin e literaturës që kemi përdorur për të prodhuar dhe realizuar këtë studim kërkimor - shkencor. Realizimi i këtij disertacioni është mbështetur mbi vetëm në *metodën cilësore*, duke bërë të mundur analizimin e çështjeve të caktuara teorike dhe praktike. Ky punim synon t'ju japë përgjigje disa pyetjeve: Si? Pse? Në çfarë mënyre?

Si rezultat i mungesës së praktikës gjyqësore në Shqipëri në lidhje me fushën kontraktuale, konkretisht referuar kontratës së shitjes në formë elektronike, konkludojmë pamundësinë për të përdorur metodën tjetër shkencore, konkretisht *metodën sasiore*. Kjo metodë bazohet mbi të dhëna të sakta të shprehura numerikisht, të cilat i mungojnë realizimit të këtij disertacioni.

Duke u fokusuar tek metoda cilësore e këtij studimi, theksojmë se, ajo përmban brenda saj, metodën historike, hulumtuese, analitike, përshkruese, interpretuese dhe krahasimore.

1. Metoda Historike. Qëllimi i kësaj metode është, pasqyrimi i evoluimit të kontratës së shitjes në formë elektronike si dhe elementët teknologjik që ndikojnë në zhvillimin e saj.

2. Metoda Hulumtuese. Kjo metodë është një proces i rëndësishëm që më ka shoqëruar në funksion të hartimit dhe të shkrimit të këtij punimi, përse i përket mbledhjes së materialeve si në format të shkruar dhe elektronik ashtu edhe mbledhjes së praktikës gjyqësore në nivel ndërkombëtar. Një ndër vështirësitë që kam hasur gjatë kësaj faze hulumtuese ka qenë mungesa e praktikës gjyqësore dhe doktrinës juridike Shqiptare.

3. Metoda Analitike. Kjo metodë bazohet në analizën e dispozitave të caktuara ligjore duke iu referuar legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar, në lidhje me kontratën e shitjes në formë elektronike, duke bërë të mundur evidentimin e problematikave ligjore.

3. Metoda Përshkruese. Kjo metodë është përdorur në këtë punim me qëllim identifikimin e zhvillimit të kontratës së shitjes në formë elektronike dhe harmonizimit që ka bërë vendi ynë në kuadër të tregtisë elektronike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke bërë një trajtim të përshkruar me hollësi dhe njëkohësisht gjithpërfshirës të kuadrit ligjor vëndas, europian dhe ndërkombëtar, në lidhje me evidentimin e problematikave që hasim në këtë fushë të re kontraktuale elektronike.

4. Metoda Interpretuese, konsiston në interpretimin e legjislacioneve vëndase dhe ndërvëndase si dhe të jurisprudencës së gjykatave të ndryshme ndërkombëtare. Qëllimi i kësaj metode konsiston në mëyrën sesi normat juridike të analizuara nga pikpamja teorike të gjejnë zbatim në rastet praktike.

4. Metoda krahasuese, ka si qëllim krahasimin e dy konventave në nivel ndërkombëtar të cilat paraqesin një rëndësi të vëçantë për realizimin e këtij punimi, dhe për funksionimin e kontratës së shitjes në formë elektronike, konkretisht: Konventa Mbi Përdorimin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare (KKEKN), UNCITRAL 2006, në vështrim krahasues me Konventën e Shitjes Ndërkombëtare të Mallrave (CISG).

1.9 KUFIZIMET E STUDIMIT

Vlen të theksojmë se, të gjitha studimet shkencore, kanë kufizimet e tyre të studimit me të cilat ndeshet në mënyrë direkte studiuesi i saj.

Parë në këtë këndvështrim, themi se, gjatë hartimit dhe përpilimit të strukturës së kësaj teme, konkretisht gjatë fazës së mbledhjes së literaturës përkatëse të nevojshme dhe gjatë fazës së përgatitjes përfundimtare të tij, u përballëm me dinamika të ndryshme kufizimesh, ndër të cilat disa prej tyre të cilat jemi përballur më shpesh janë si më poshtë:

Së pari, konstatojmë se ndodhemi në kushtet kur kemi të bëjmë me një tematikë të re në fushën akademike në Shqipëri dhe në fushën e të drejtës kontraktuale e cila përbën risi për aktualitetin e vëndit tonë, nëpërmjet së cilës hasëm vështirësi në gjetjen e literaturës akademike, analizave teorike të së drejtës mbi këtë fushë specifike studimi.

Së dyti, një element shumë i rëndësishëm i cili do të bënte të mundur pasurimin e këtij studimi, është edhe mungesa e rasteve të praktikës gjyqësore në lidhje me praktikën gjyqësore shqiptare.

1.10 RËNDËSIA E STUDIMIT

Rëndësia e studimit doktoral erdhi si rezultat i evolucionit të teknologjisë në mjetet e komunikimit dhe informacionit në fushën e tregtisë elektronike, për disa arsye, si më poshtë:

Së pari, ky studim është një përpjekje për të dhënë një kontribut të rëndësishëm dhe njëkohësisht duke stimuluar debate konstruktive akademike në lidhje me rëndësinë, pozitën dhe mbrojtjen juridike të kontratës së shitjes në mënyrë elektronike.

Së dyti, ky studim është i rëndësishëm pasi, në të trajtohet një temë aktuale dhe specifike, e cila përbën risi për aktualitetin shqiptar si dhe nxit kuriozitet dhe debat bashkëkohor në tërësi, veçanërisht në fushën akademike dhe në atë jo më pak të rëndësishme në fushën e jurisprudencës.

Së treti, nëpërmjet këtij studimi, synohet të jepet një kontribut i rëndësishëm në literaturën juridike mbi kontratën e shitjes në formë elektronike në Shqipëri dhe në nivel ndërkombëtar. Ndonëse në nivel evropian dhe ndërkombëtar ekziston një literaturë e gjerë referuar kontratës së shitjes elektronike, funksionit dhe zhvillimit të saj, theksojmë se në vëndin tonë, kjo tematikë studimi mbetet e re dhe përbën një risi për vëndin tonë.

Së katërti, ky punim është i rëndësishëm pasi analizon kuadrin ligjor dhe raste të praktikës gjyqësore të huaj në lidhje me kontratën e shitjes elektronike, në nivel ndërkombëtar, evropian. Përsa i përket legjislacionit shqiptar, vlen të theksojmë se shteti Shqiptar ka implementuar direktivat e BE-se në kuadër të mirë funksionimit të tregtisë elektronike, por nga ana tjetër nuk kemi ende një asnjë vendim gjyqësor ndaj konsumatorit për shkelje të elementëve të kontratës së shitjes në mënyrë elektronike.

Së fundmi. Përfundimi me sukses i këtij punimi është përballur me vështirësi të fushës juridike kontraktuale elektronike përsa i përket mungesës së literaturës në gjuhën shqipe dhe mungesës së praktikës gjyqësore.

1.11 PËRMBLEDHJA DHE STRUKTURIMI I PUNIMIT

Disertacioni është konceptuar i ndarë në 6 (gjashtë) kapituj.

KAPITULLI I. Ky kapitull pasqyron në mënyrë të qartë pjesën hyrëse të studimit, evidentimin e problematikës, përcaktimin e objektivave, qëllimit dhe pasqyrimin e hipotezës qëndore së bashku me tre nënhipotezat përkatëse të cilat shoqërohen me një sërë pyetjesh kërkimore të punimit. Gjithashtu në këtë kapitull trajtohet në mënyrë të përmbledhur rishikimi i literaturës mbi fushën e tregtisë elektronike, specifikisht në lidhje me kontratën e shitjes në formë elektronike; metododat dhe metodologji e kërkimit; mundësitë dhe kufizimet dhe rëndësinë e studimit.

KAPITULLI II. Rëndësia e këtij kapitulli konsiston në analizën e lindjes dhe të zhvillimit të kontratës së shitjes në formë elektronike si dhe në përshkrimin të faktorëve teknologjikë që kanë ndikuar në evoluimin e saj deri në ditët e sotme, si: aspekte të ndryshme teknologjike, interneti, tregtia elektronike. Në vijimësi, ky kapitull përshkruan nevojën për përdorimin për kontratën e shitjes në formë elektronike.

KAPITULLI III. Ky kapitull trajton rregullimin ligjor dhe praktikën gjyqësore të kontratës së shitjes në formë elektronike në nivel ndërkombëtar. Në pjesën e parë të kapitullit trajtohen ligjet Model UNCITRAL-it në rrjedhën kronologjike, llojet e tregtisë elektronike, dhe llojet e kontratave elektronike në nivel ndërkombëtar, të cilat këto të fundit janë të ilustruara me praktikë gjyqësore të huaj. Gjithashtu në këtë kapitull kemi trajtuar Konventën Mbi Përdorimin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare (KKEKN) në vështrim krahasues Konventën e Shitjes Ndërkombëtare të Mallrave

(CISG).Një moment me rëndësi trajtimin e këtij kapitulli zënë edhe Udhëzimet e OECD- së për mbrojtjen e konsumatorëve në kontekstin e tregtisë elektronike.

KAPITULLI IV. Në këtë kapitull trajtohet legjislacioni i BE-së dhe praktika gjyqësore në lidhje me kontratën e shitjes në formë elektronike, duke u bazuar mbi direktivat e Bashkimit European, ndër të cilat përmendim: Direktivën mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve; Mbi Tregtinë Elektronike; etj.

KAPITULLI V. Ky kapitull analizon kontratën e shitjes në formë elektronike sipas legjislacionit shqiptar, duke trajtuar elementët specifik të saj, objektin, subjektet, të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktore, momentin e lidhjes së kontraktës, pagesën elektronike dhe mënyrat e saj, juridiksionet kompetente dhe autoritetet mbikqyrëse. Gjithashtu një rëndësi tjetër i kushtohet të dhënave statistikore dhe taksimit në lidhje më blerjet online. Theksojmë se, në pjesën e fundit të kapitullit trajtojmë pozitën juridike të konsumatorit sipas legjislacionit shqiptar në rend kronologjik, duke analizuar mbrojtjen e konsumatorit si garanci për zhvillimin e kontratës së shitjes në formë elektronike.

KAPITULLI VI. Ky kapitull pasqyron konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse në lidhje me zhvillimet dhe evidentimin e problematikave të kontratës së shitjes në formë elektronike.

KAPITULLI II: ZANAFILLA E LINDJES DHE EVOLUIMIT TË KONTRATËS SË SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE

2.1 Aspekte teknologjike për lidhjen e kontratës së shitjes në formë elektronike

"Në fillim, kompjuteri ishte kaq i kushtueshëm saqë duhej të mbahej i pushtuar për çdo sekond. Njerëzit ishin pothuajse skllëvër për ta ushqyer atë".²⁰ -

Brian Shackel (1997)

Në ditët e sotme, teknologjia e informacionit ka evoluar me një shpejtësi shumë të madhe çdo ditë dhe më shumë. Si rezultat i përdorimit të kompjuterit për shit-blerje të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme në mënyrë masive nga konsumatorët/ tregtarët në nivel global, vlen të theksojmë se kompjuteri mund të cilësohet si një ndër shpikjet më të rëndësishme për njerëzimin.

Në këtë prizëm, theksojmë se kompjuteri është bërë partneri dhe bashkëpunëtori më i rëndësishëm për secilin prej nesh, pasi nëpërmjet tij, nënshkruhen kontrata të shijtes në mënyrë elektronike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Pozita e veçantë që zë kompjuteri sëbashku me zhvillimet e mëdha teknologjike kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të kenë ndikim të jashtëzakonshëm pozitiv dhe veçanërisht në zhvillimin e kontratës së shitjes në mënyrë elektronike.

²⁰<https://www.microsoft.com/en-us/research/wp-content/uploads/2017/01/HCIhandbook3rd.pdf>

Varësisht nga kategoria e produktit, roli i blerjeve elektronike ndryshon. Pothuajse të gjitha hulumtimet mbi përdorimin e internetit tregojnë se produktet kompjuterike, librat, revistat, muzika dhe, në një masë në rritje, shërbimet si udhëtimi janë ndër artikujt më të njohura që do të blihen në Web. Interesi për sende ushqimore, elektronikë, mobilje, fotografi dhe objekte të tjera të artit është shumë më e vogël. Këto gjetje identifikojnë në mënyrë implicite ato kategori produktesh në të cilat kërcënimi ndaj shitësve konvencional është relativisht i lartë (ish) dhe ato ku sfida është e kufizuar (e fundit).²¹

2.2 Impakti i rëndësishëm i internetit në zhvillimin e kontratës së shitjes “offline” deri në versionin e saj në formë elektronike, “online”.

Interneti ka ndryshuar mënyrën se si njerëzit blejnë, shesin, punësohendhe organizojnë aktivitetet e biznesit në më shumë mënyra dhe me më shumë shpejtësi, se sa çdo teknologji tjetër në historinë e biznesit.²² Evolucionin e internetit në vitet e fundit ka ndryshuar përgjithmonë mënyrën se si bota bën biznes.²³ Ky zhvillim u mundësua nga rritja e përdorimit të kompjuterëve personalë në punë dhe në shtëpi dhe nga përfshirja e biznesit në internet, si një mënyrë për të arritur partnerët tregtarë dhe konsumatorët.²⁴

Nga vetë natyra e dizajnit të saj, interneti na ka dhënë një mënyrë të re revolucionare për mbledhjen, organizimin dhe komunikimin e informacionit me shpejtësinë e dritës. Origjina

²¹ Nikhilesh Dholakia; Wolfgang Fritz Ruby Roy Dholakia and Rober Mundorf, *Global E-Commerce and Online Marketing: Watching the Evolution*. (Qourum Books, Wetsport, United States ose America 2002), faqe 76.

²² Schneider, G. P. 2011 – *ELECTRONIC COMMERCE* Ninth Edition, faqe 8

²³ Kosick, R. The Internet in Latin America: NeW Opportunities, Developments, & Challenges, *American University International Law Review* 16, no. 5 (2001).

²⁴ Curtis, G. dhe Cobham, D. (2005). *Business information system: Analysis, design and practice*, 5th edition, faqet 174-209

e internetit daton në fund të viteve 1960, si një përpjekje e financuar nga qeveria që lidhte kompjuterat në agjencitë qeveritare, departamentet universitare dhe laboratorët hulumtues së bashku, ishte ajo e një rrjeti të vogël për qarkullimin e të dhënave dhe llojeve të tjera të informacionit brenda komunitetit shkencor.²⁵ Shpërthimi i vërtetë i internetit në rang global është rrjedhojë e implementimit të projektit World Wide Web në maj të vitit 1991.²⁶

Para se të shqyrtojmë realitetin ligjor dhe tregtar të tregtisë elektronike, së pari është e nevojshme të merret në konsideratë natyra e internetit.²⁷ Nëse do të bëjmë një përkufizim internetit, duhet të nënvizojmë, së pari, se ai është një strukturë virtuale që nuk ka një personalitet të vetin juridik, si dhe nuk organizohet sipas ndonjë skemë strukturore administrative që do të mund të përfaqësonte përkundrejt përdoruesve.²⁸

Fillimisht u krijua se interneti ishte një botë virtuale ku mbretëronte njëfarë lirie, ku zonat që qëndronin jashtë zbatimit të ligjit ishin të mëdha. Megjithatë, reagimet ligjore kryesisht nëpërmjet vendimeve gjyqësore nuk vonuan, këto vendime treguan se interneti nuk është një hapsirë boshe për rregullimin e së cilës kërkohet nxjerrja e rregullave krejt të reja juridike, porse e drejta ekzistuese është e vlefshme dhe e zbatueshme automatikisht edhe në këtë fushë.²⁹ Në fakt interneti është një infrastrukturë komunikimi, asgjë më shumë.³⁰

Në këtë kontekst të ri, del në pah domosdoshmëria e njohjes së zbatimit të parimeve juridike në internet. Sic e theksuam edhe më lart, interneti tashmë është pushtuar nga ethet e

²⁵ Robert Guttman, *Cybercash: The Coming Era of Electronic Money*. (Palgrave Macmillan, New York, 2002), faqe 58.

²⁶ Instituti Shqiptar i Medias, Zhvillimi

i Internetit dhe i Mediave Sociale në Shqipëri, faqe 5.

²⁷ Peter Carey, *The Internet and E-Commerce: A Hawksmere Report*, (Hawksmere, London, 2001), fq. 4

²⁸ Andre Bertrand, *Le droit d'auteur et les droits voisins*, Dalloz, 2eme edition, 1999.

²⁹ E drejta e internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 17, Tiranë 2013.

³⁰ Peter Carey, *The Internet and E-Commerce: A Hawksmere Report*, (Hawksmere, London, 2001), faqe 4.

tregtisë së lirë dhe të gjithanshme: çdo lloj transaksioni që njeriu mund të bëjë realisht në jetë, tashmë i bën edhe virtualisht duke rritur në mënyrë të vullshme shkëmbimet. Shprehja “blije në internet” ose “e gjen në internet shumë kollaj”, tashmë kanë hyrë në zhargonin tonë të përditshëm. Nuk e dimë nëse do të bënim dot pa internetin, por ne jemi mësuar tashmë me të. Zhvillimi i shkëmbimeve sjell në mënyrë të pashmangshme diskutime në lidhje me pasojat juridike të përdorimit të internetit ndaj njerëzve (e drejta e konsumatorëve dhe të dhënat personale, fshehtësia e korrespondencës), për respektimin e të drejtave të krijuesve, si dhe në fushën e marrëdhënieve ndërmjet bizneseve. E drejta e internetit lidhet në radhë të parë dhe pazgjidhshmërisht me të drejtën e telekomunikacioneve ose, më saktë, duke përdorur terminologjinë tonë ligjore, atë të komunikimeve elektronike.³¹

Interneti si medium shpërmdahet nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik, të cilat, sipas përkufizimit që i jep ligji për komunikimet elektronike³² është, sistemi i transmetimit, i komutimit ose rrugëzimit dhe burimeve të tjera që lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (interneti), rrjetet e lëvizshme tokësore..”

E drejta e internetit gjen, si pasojë një burim kryesor në të drejtën e komunikimeve elektronike përse u përket parashikimeve juridike që rregullojnë mjetet teknike të përhapjes së informacionit dixhital. Në këtë aspekt e drejta e internetit gjen zbatim të gjerë në rregullat e parashikuara për komunikimet elektronike dhe në tregtinë elektronike. Është i njohur fakti se të dyja këto të drejta të ndërlidhura me njëra- tjetrën janë të reja dhe analiza e së

³¹ E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe23- 24, Tiranë 2013.

³² Ligji nr. 9918, datë 19 maj 2008, “Për komunikimet elektronike”, Fletore Zyrtare nr. 84, 2008.

drejtës së internetit si dhe ajo e së drejtës së komunikimeve elektronike, nuk i shpëton një vërtejje mjaft të dukshme: të dyja ushqehen gjerësisht nga të drejta ekzistuese, si përshembull e drejta e kontratave, e drejta e konkurrencës, e drejta e autorit, e drejta ndërkombëtare private.

Interneti është një medium që lidhpërdorues në skaje të ndryshme të globit dhe në këtë mënyrë, ai ndihmon jo vetëm për përhapjen e informacionit, por edhe për zhvillimin e marrëdhënieve juridike ekzistuese në përmasa më të gjëra. Parë në këtë këndshvështrim mund të themi se burimi i parë i së drejtës së internetit janë të drejtat e mëparshme, ekzistuese, të cilat përbëjnë dhe thelbin e kësaj të drejte. Për të evituar boshllëkun juridik në lëmin e internetit, gjykata kanë qenë të parat që kanë shprehur idenë se interneti nuk mund të qëndrojë jashtë zbatimit të ligjit.³³ Ky evolucion ka ndodhur në vitet 1990, ku spikatin dy vendime gjyqësore, një i gjykatës së Parisit i vitit 1996 dhe vendimi i famshëm i Napster i Gjykatës së Distriktit të Kalifornisë i viti 1999.³⁴

Shkëmbimet tregtare në internet kanë njohur një zhvillim që ka prekur edhe praktikat tregtare tradicionale.³⁵ Shkëmbimet në internet kanë sjellë si pasojë rikonfigurim të tregtisë, mishëruar në rregullat e tregtisë elektronike, të cilat kërkojnë një adaptim të përhershëm me nevojat dhe shërbimet e reja që ofrohen. Nga pikpamja statistikore, shitjet në internet kanë pësuar rritje të madhe. Kështu, nëse në vitin 1997 vetëm 0.5 % e shitjeve në vendet e zhvilluara janë kryer në internet, në vitin 2002 ato kanë qenë 5 % dhe në vitin

³³E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe25- 27, Tiranë 2013.

³⁴Analiza e detajuar e këtyre vendimeve gjendet ne E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike.

Oltion Spiro, në Kapitullin III, E drejta e autorit në Internet, faqe 151

³⁵ E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 31, Tiranë 2013

2005 rreth 15 %.³⁶ Vetëm në Francë, për vitin 2011 mendohet se blerjet në internet kanë kapur shifrën prej 37.8 miliardë eurosh.³⁷

Interneti dhe dixhitalizimi i çdo gjëje po vë në lëvizje një transformim dixhitale, nëse jo revolucioni, ekonomia evropiane dhe në të vërtetë globale dhe shoqëria. Mbi 80% e të gjithë evropianëve kanë gjerë-band qasje dhe 90% e bizneseve evropiane janë në internet, nga 20% në të dy rastet pak më shumë se pesë vjet më parë. Kjo rritje eksponenciale është reflektuar edhe në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera, me disa 4 miliard njerëz pritet të jetë në internet nga 2020. Teknologjitë e reja të komunikimit, të lirë por sensorë të sakta dhe aftësitë të mëdha kompjuterike janë tashmë me shpejtësi duke sjellë gjëra si njerëzit on-line, me disa 26 miliardë lekë gjëra - duke filluar nga rrobat 'zgjuar' për pajisjet mjekësore për minierat e madhe automjete - pritet të kontribuojnë në një shpërthim të trafikut të internetit gjatë pesë viteve të ardhshme. Ky dixhitalizim ofron mundësi për qasje radikale të reja të shëndetësisë, transportit, bujqësisë, energjisë dhe sektorë të tjerë, e cila shpjegon se pse kaq shumë firma të reja janë "të lindur globale."³⁸

Natyrisht që një zhvillim i vrullshëm nuk mund të ndodhë në mënyrë afatgjatë dhe të qëndrueshme nëse nuk respektohen disa rregulla. Interneti nuk mund të jetë një Far- Ëest ku fiton gjithmonë më i forti, në këtë rast tregtari që posedon mjetet e nevojshme për të reklamuar dhe shitur produktin e tij. Në këtë konteskt, është e rëndësishme të hidhet një vështrim mbi mjetet ligjore tashmë ekzistuese, duke u fokusuar në rastin e Shqipërisë, që

³⁶ Joelle Farchy, "Internet et le Droit d'auteur", CNRS Communications.

³⁷ <http://www.journaldunet.com/ebusiness/commerce/resultats-e-comerce-2010/chifre-d-affaires-e-commerce-2010.shtml>

³⁸ Translatic Digital and Economy and Data Protection: State of Play and Future Implications for the EU-s External Policies

[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU\(2016\)535006_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU(2016)535006_EN.pdf), parë për herë të fundit më 15 nëntor 2016.

garantojnë një tregti të lirë, pa arbitraritet dhe një mundësi zgjedhje për konsumatorët, pa pasur frikën e abuzimit. Megjithatë, ai tashmë është kthyer në një motor të jetës sociale e të shqiptarëve si një mjet i pazëvendëueshmëm për suksesin e një sipërmarrje. Nëse shohim të dhënat për depërtimin e internetit në Shqipëri, do të shikojmë se lidhjet individuale dhe profesionale me internetit, ndonëse janë ende nën mesataren europiane, kanë njohur një rritje mjaft të shpejtë.³⁹

Duke pasur parasysh koston e ulët të krijimit të faqeve të reja të internetit, shumë firma së shpejti e kuptuan se interneti do t'u lejonte atyre të lidheshin me një shumë më shumë konsumatorë anembanë globit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Së shpejti çdo firmë e madhe e shitjes me pakicë dhe të konsumit me njohjen e markës duhej të kishte një faqe interneti për t'i dhënë klientëve potencial një burim të përshtatshëm për informacione dhe komunikim të përmirësuar të produktit. U krijuan kompani të reja, të krijuara posaçërisht për t'i shërbyer përdoruesve të internetit (*si Yahoo*) ose për të bërë biznes në internet (*p.sh. Amazon.com*). Kështu, interneti u zhvillua në një mjet tregtimi pas vitit 1996. Perspektivat e fitimeve të shpejta nëpërmjet kësaj zgjerimi të ulët të tregtisë nxitën një bum që siguroi fonde të mjaftueshme për një zgjerim jashtëzakonisht të shpejtë të vendeve të tregtisë elektronike, një bum që u derdh në telekom dhe firmat kompjuterike që përgatiten për një zgjerim të madh të kapaciteteve të internetit.⁴⁰

Në vitin 1972, lindi përdorimi i e-mailit, fillimisht nga Ray Tomlinson, i cili shkroi një program që mund të merrte dhe dërgonte mesazhe, në lidhje me rrjetin.

³⁹ E drejta e internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 14, 32, Tiranë 2013.

⁴⁰ Robert Guttmann, Cybercash: The Coming Era of Electronic Money. (Palgrave Macmillan, New York, 2002), faq 58.

Interneti bën të mundur krahasimin e çmimeve me një grup më të madh alternativash të tregut sesa ajo që është e mundshme në botën fizike. Në internet, konsumatorët perceptojnë çështje rreth parave dhe çmimeve ndryshe sesa në tregun fizik: "Kur jeni jashtë në internet, mund të krahasoni çmimet në të gjithë botën, në çdo rast në Evropë, sepse nuk ka zakone. Pastaj ju mendoni se tregu është zgjeruar, që do të thotë se ju e dini se ju mund të gjeni çmimin më të mirë në dispozicion "⁴¹

2.3 Tregtia elektronike si katalizator për transaksionet në rrugë elektronike

Tregtia elektronike i referohet një game të gjerë aktiviteteve të biznesit online për produktet dhe shërbimet. Ajo gjithashtu ka të bëjë me format e ndryshme të transaksionit në të cilin palët bashkëveprojnë në mënyrë elektronike në vend të shkëmbimit fizik.⁴²

⁴¹Nikhilesh Dholakia; Wolfgang Fritz Ruby Roy Dholakia and Rober Mundorf, Global E-Commerce and Online Marketing: Watching the Evolution. (Qorum Books, Wetsport, United States ose America 2002), faqe 147

⁴² USAID from the American People. Drejt Tregtisë Elektronike. Zbatimi i Tregtisë Elektronike si një Mundësi Inovative Online për Biznesin tuaj., faqe 7. Dhjetor 2013.



Figura I. Procesi i tregtisë elektronike dhe elementë kryesorë që marrin pjesë ⁴³

Duke pasur parasysh natyrën dinamike të tregtisë elektronike theksojmë se, autorë të ndryshëm kanë dhënë përcaktime të ndryshme rreth përdorimit dhe funksionimit të saj në treg. Tregtia elektronike mund të përkufizohet si tregtia që realizohet në një mjedis të ndryshëm nga tregjet fizike (reale), por në një hapësirë të re sic është hapësira virtuale në internet. Tregtia elektronike i përket atyre formave të transaksioneve tregtare në të cilat

⁴³ USAID, Drejt Tregtisë Elektronike, Zhvillimi i Tregtisë Elektronike si një mundësi inovative online për rritjen e biznesit tuaj,

palët ndërveprojnë në mënyrë elektronike dhe jo me shkëmbimin fizik ose kontakt direkt fizik.⁴⁴

Një tjetër përkufizim specifikon se, tregtia elektronike është përdorimi i komunikimit elektronik dhe teknologjisë së informacionit të dixhital në transaksionet e biznesit për të krijuar, transformuar dhe riformatuar marrëdhëniet për krijimin e vlerës ndërmjet/ose midis organizatave dhe ndërmjet organizatave dhe biznesit.⁴⁵

Ndërsa *OECD* e përkufizon tregtinë elektronike si: “Të gjitha format e veprimeve tregtare që përfshijnë organizmat dhe individët, të cilët bazohen në përpunimin elektronik dhe transmetimin e të dhënave, duke përfshirë tekstin, zërin dhe imazhet virtuale. Ajo i referohet gjithashtu, efekteve që shkëmbimi elektronik i informacionit tregtar mund të ketë mbi institucionet dhe proceset që mbështesin dhe rregullojnë aktivitetin tregtar”.⁴⁶

Në Bashkimin Europian “*Iniciativa Europiane për Tregtinë Elektronike*”, e përkufizon tregtinë elektronike si: çdo formë e transaksioneve të bizneseve në të cilat, palët ndërveprojnë në mënyrë elektronike dhe jo nëpërmjet shkëmbimeve fizike. Ajo përfshin dy lloje aktivitete: një nga këto është porosia elektronike e mallrave, të cilat dërgohen në destinacion fizikisht, duke përdorur mënyrat tradicionale, si shërbimi postar ose korrierët tregtarë; dhe tjetri është tregtia e drejtëpërdrejtë elektronike e cila përfshin porositë online,

⁴⁴Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 479, Tiranë 2013

⁴⁵Përkufizimi i dhënë nga Emmanuel Lallana, Rudy Quimbo, Zorayda Ruth Andam, ePrimer: An Introduction to eCommerce (Philippines:DAI-ANGILE,2000)2.

⁴⁶ Law of Electronic Commercial Transaction; Contemporary issues in EU, US and Chine, Faye Fangfei Wang, Routledge 2010, faqe 4.

pagesat dhe dërgimin e mallrave jo të trupëzuar dhe shërbimeve si programe kompjuterësh, materiale argëtuese ose shërbime informimi në një shkallë globale”.⁴⁷

Tregtia elektronike i referohet një game të gjerë aktivitetesh të biznesit online për produktet dhe shërbimet. Ajo ka të bëjë me format e ndryshme të transaksionit në të cilën palët bashkëveprojnë në mënyrë elektronike në vend të shkëmbimit fizik. Tregtia elektronike është përdorimi i komunikimeve elektronike dhe teknologjisë së përpunimit të informacionit në transaksionet e biznesit për të krijuar, transformuar, dhe ridefinuar marrëdhëniet për krijimin e vlerës me dhe ndërmjet organizatave. Ajo është e lidhur me blerjen dhe shitjen nëpërmjet internetit, kryerjen e transaksioneve që përfshijnë transferimin e pronësisë ose të të drejtave për të përdorur mallrat ose shërbimet nëpërmjet një rrjeti kompjuterik ndërmjetësues.⁴⁸

Një tjetër përkufizim mbi tregtinë elektronike, përcakton se, ⁴⁹ tregtia elektronike mund të përkuzohet si një proces elektronik i blerjes dhe i shtijes, blerjes dhe shitjes së produktit, shërbimeve dhe informacionit nëpërmjet internetit por tregtia nuk është vetëm blerje dhe shitje por edhe komunikim elektronik, bashkëpunim dhe komunikim informacioni.

Ndërsa sipas përkuzimit të ligjit tonë “Për tregtinë Elektronike”, përkufizohet si tregti elektronike: *“kryerja nga subjektet e këtij të një veprimtarie, nëpërmjet shkëmbimit të*

⁴⁷ Law of Electronic Commercial Transaction; Contemporary issues in EU, US and China, Faye Fangfei Wang, Routledge 2010, faqe 4.

⁴⁸ United States Agency for International Development (USAID). Dhjetor 2013

⁴⁹ <http://trove.nla.gov.au/work/31602118?selectedversion=NBD42545880> Turban, E.King D., McKay., J. Marshall. Lee. J., @ Viehland, D. Electronic Commerce: A Managerial Perspective. Upper Saddle River, NJ. Pearson Prentice Hall.

*dokumenteve elektronike, për tregtimin e mallrave dhe /ose të shërbimeve”.*⁵⁰ Pra koncepti i tregtisë elektronike i referohet konkretisht transaksioneve të ndryshme në rrugë elektronike, si shit-blerjeve të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme nëpërmjet internetit pa qenë e nevojshme prania fizike e palëve kontraktuese. Në vijimësi të tregtisë elektronike, është e rëndësishme të themi se, që të funksionojë tregtia elektronike duhet domosdoshmërisht të plotësojë disa elementë specifikë.

Konkretisht, theksojmë se, një aktivitet tradicional tregtie konsiston në katër elementë kryesorë:⁵¹

1. *Oferta*
2. *Porosia*
3. *Pagesa*
4. *Shërndarja*

Pra, parë në këtë kënvëndshtrim, duhet domosdoshmërit që të plotësohen të katër elementët e sipër përmendur për të pasur tregti elektronike. Psh. Nëse blejmë, një produkt në faqen e internetit eBay.com ose Amazon.com (dy “familjet më të mëdha të SHBA-së dhe në mbarë botën gjithashtu), në të cilën porosia dhe pagesa bëhen online ndërsa marrja e porosisë bëhet fizikisht.

2.4 Zanafilla e kontratës së shitjes në formë elektronike

⁵⁰ Neni 3.f, ligji nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”.

⁵¹ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/12/Doktoratura-Zhaneta-Ndregjoni-Fakulteti-Ekonomise-Departamenti-i-Marketingut.pdf> Dr. Zhaneta Ndregjoni, Aplikimi i tregtisë elektronike tek bizneset e vogla dhe të mesme. Rast studimor: Rasti i Tiranës. Tiranë, Nëntor 2014

Siguria në transaksionet elektronike në Internet konsiderohet si një prej çështjeve më të rëndësishme në botën dixhitale. Që nga viti 1996, të dy organizatat ndërkombëtare dhe multinacionale në nivel qeveritar dhe të biznesit janë duke u përpjekur për të nxitur përdorimin e nënshkrimeve elektronike në tregtinë elektronike dhe të përcaktuar një kornizë të përbashkët ligjore për autentikim elektronik në Internet.⁵² Origjina, i referohet pikërisht momentit kur UNCITRAL është themeluar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1996.

Ligji Model për Tregtinë Elektronike (MLEC) pretendon për të mundësuar dhe lehtësuar tregtinë kryer duke përdorur mjete elektronike, duke siguruar ligjvënësit kombëtare me një sërë rregullash të pranuar ndërkombëtare që synojnë heqjen e pengesave ligjore dhe rritjen e parashikueshmërisë ligjore për tregtinë elektronike. Në veçanti, ai ka për qëllim për të kapërcyer pengesat që rrjedhin nga dispozitat ligjore të cilat mund të jenë problematika të ndryshme kontraktuale, është e domosdoshme të sigurojë trajtim të barabartë me bazë letrën dhe trajtim i tillë i barabartë me informacionin elektronik, për të mundësuar përdorimin e komunikimit paperless, duke nxitur efikasitetin në tregtinë ndërkombëtare.

2.5 Përkufizimi i kontratës së shitjes në formë elektronike si institut i së drejtës

⁵²Electronic Signatures: A Transatlantic Bridge? An EU and US Legal Approach Towards Electronic Authentication.

Kontratat e lidhura përmes mjeteve elektronike quhen kontrata në formë elektronike. Propozimi dhe pranimi i ofertës mund të bëhen nëpërmjet mjeteve elektronike, që është forma elektronike e tyre. Në çdo rast, që kontrata elektronike të jetë e vlefshme, duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara nga Kodi Civil, për pjesën e përgjithshme të kontratave, kërkesat e parashikuara për formën konkrete të kontratës, të parashikuar nga Kodi Civil dhe kërkesat e veçanta, të parashikuara në ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".⁵³

2.6 Nevoja për përdorimin e kontratës së shitjes në formë elektronike

Shoqëria jonë moderne mbështetet në një sistem ekonomik që bazohet kryesisht në mekanizmin e kontratave. Tani për tani shoqëria jonë industriale dhe e shërbimit po ndryshon më shumë drejt shoqërisë moderne të informacionit. Një nga treguesit më të rëndësishëm që tregon këtë ndryshim është rritja e ekonomisë dixhitale.⁵⁴

Në këtë këndvështrim, mund të themi se, në ditët e sotme, interneti dhe zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë së informacionit, kanë rezultuar në ndryshimin e standarteve të jetesës. Vitet e fundit, është bërë një progres i ndjeshëm në kuadër të tregtisë elektronike, përse i përse i përket lehtësimit të biznesit përmes kryerjes së shërbimeve në mënyre elektronike. Si rezultat i zhvillimit të teknologjisë dhe tregtisë elektronike, lindi nevoja për përdorimin e kontratës së shitjes në formë elektronike, si një mënyrë më e shpejtë për të kryer biznes.

⁵³ Ligji Nr. 10 128, datë 11.05.2009 "Për tregtinë Elektronike". (Perafruar me Direktiven 2000/31/EC, "on Some legal aspects of Information Society services, especially on electronic commerce in domestic market (Directives on Electronic Commerce)", me CELEX 32000L0031.

⁵⁴ Michael Gisler, K. Stanoevska- Slabeva, M. Greunz, Legal Aspects of Electronic Contract, Sesion 4, faqe 1

KAPITULLI III: RREGULLIMI LIGJOR I KONTRATËS SË SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE NË NIVEL NDËRKOMBËTAR DHE EUROPIAN. PRAKTIKË GJYQËSORE.

3.1 Ligjet Model UNCITRAL-it në rrjedhën kronologjike

Rritja e përdorimit të teknikave elektronike vërtetimi si zëvendësues për nënshkrimet me dorë dhe procedurat e tjera tradicionale vërtetimit ka sugjeruar nevojën për një kuadër ligjor specifik për të reduktuar pasigurinë si për efekt juridik që mund të rezultojë nga përdorimi i teknikave të tilla moderne, e cila mund të jetë përmendur në përgjithësi si "nënshkrimet elektronike".

Pavarësisht nga fakti se shumë vende pranuan gjerësisht parimet e përfshira në Ligjin Model të UNCITRAL mbi E-Commerce, atë nuk mund thjesht të supozohet se parimet e saj arritën qëllimin e botës harmonizimit.⁵⁵ Fakti që teknologjia po ndryshon me shpejtësi paraqet disa sfida në kuadrin e Ligjit Model. U bë e qartë se nënshkrimet elektronike patjetër do të ishin një problem për shkak të teknika të ndryshme të nënshkrimit që po zhvilloheshin. Dispozitat e Ligji Model shpejt u tregua i papërshtatshëm për t'u marrë me të gjitha çështjet e ngritura nga krijimi dhe përdorimi i nënshkrimeve elektronike.⁵⁶

⁵⁵ Faria op cit note 115 at 533

⁵⁶ Eiselen op cit 127 at 314.

3.1.1 Ligji Model UNCITRAL “Për tregtinë elektronike”, i vitit 1996

Ky ligj është miratuar në 12 qershor të vitit 1966 dhe është hartuar me synimin për të unifikuar rregullimet lidhur me tregtinë elektronike në arenën ndërkombëtare. Ligji synon, nëpërmjet rregullimeve uniforme, të kalojë barrierat ligjore për njohjen dhe zbatimin e kontratave elektronike. Ligji model UNCITRAL, do të shërbejë për harmonizimin e legjislacionit në fushën e tregtisë për shkak të specifikës që ka kjo tregti, kapërcimit të barrierave gjeografike dhe realizimit të verpimeve tregtare midis subjekteve në vende të ndryshme. Ligji model rregullon përdorimin e komunikimeve elektronike për realizimin e kontratave ndërkombëtare, lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, njohjen e mesazheve me tëdhëna.⁵⁷

Qëllimet e tij janë për të ndihmuar shtetet të përmirësuar legjislacionin e tyre në lidhje me komunikimet elektronike dhe të shërbejë si një ndihmë referimi për interpretimin e konventave ekzistuese ndërkombëtare dhe instrumenteve të tjera në mënyrë që të shmangen pengesat për tregtia elektronike.⁵⁸

Ligji Model për E-Commerce ka ndikuar në shumë shtete në lidhje me hartimin dhe propozimeve legjislativë. Aktet e fundit dhe ligjet uniforme tani që qarkullojnë në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara janë të ndikuara shumë nga Ligji Model, dhe hartimi komisioneve nga të dy vendet po shkëmbejnë ide mbi subjektet.⁵⁹ Në Bashkimin Evropian, Direktiva e

⁵⁷Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 517, Tiranë 2013

⁵⁸Christoph Glatt, 'Comparative Issues in the Formation of Electronic Contracts', (United Kingdom) (Spring 1998) 6:1 *Int'l J.L. & Info. Tech.* 34, at 57.

⁵⁹Poggi (2000), supra note 5, në 238. Konferenca Uniform Ligji i Kanadasë prodhuar ligjin e vet modelin e bazuar në modelin UNCITRAL. Miratuar për miratim nga provincat në vitin 1999, Uniform Electronic Commerce Act (UECA) mbështetet në qasjen funksionale ekuivalencës pa kërkuar legalizuar nga një burim

Tregtisë Elektronike dhe Direktiva e Nënshkrimit elektronike janë ndikuar edhe në masë të madhe nga Ligji Model dhe Projektregullores.⁶⁰Për më tepër, hartimi komiteteteve për zbatimin e këtyre ligjeve të propozuara duket se ndikohet drejtpërdrejt nga puna e njëritjetrit, duke zvogëluar interpretime divergjente.⁶¹

MLEC (Model Law on Electronic Commerce), është shumë i rëndësishmëm, sepse ishte teksti i parë legjislativ për të miratuar parimet themelore të mosdiskriminimit, neutralitetit teknologjik dhe ekuivalencës funksionale që konsiderohen gjerësisht si elementët themelues të së drejtës moderne të tregtisë elektronike.⁶² Parimi i mosdiskriminimit, ka si qëllim të sigurojë që një dokument të mos mohohet efekti juridik, vlefshmëria ose zbatueshmëria vetëm për arsye se ajo është në formë elektronike. Ndërsa parimi i ekuivalencës funksionale, konsiston në përcaktimin e kritereve sipas të cilave komunikimet elektronike mund të konsiderohen ekuivalente me komunikimet e bazuara në letër.

të caktuar teknologjik. Saskatchewan-së Dokumentet elektronike dhe Informacionit Akti, S.S. 2000 c. E-7.22, për shembull, përmban të ngjashme dhe në disa raste dispozita identike me UECA. Act Electronic Commerce Nova Scotia-së, S.N.S. 2000 c. 26, ka marrë miratimin Mbretërore 30 November, 2000, dhe gjithashtu pasqyron qasjen UECA ndaj shkrimit dhe nënshkrimit, si vepron Electronic Commerce Ontario, S.O. 2000 c. 17. Disa krahina të tjera kanë faturat më parë legjislativat e tyre me qasje të përbashkëta përgjatë vijave të UECA. (Shih Michael Geist, Ligji internetit në Kanada, (Universiteti York: Captus Press, 2000) në 493-499). Kjo qasje nuk është domosdoshmërisht e varur në një sistem të përbashkët të ligjit të interpretimit siç dëshmohet nga Bill 161 tani para Asamblesë Kombëtare Quebec, drejtë një akt për të krijuar një kornizë ligjore për teknologjinë e informacionit, prezantuar fillimisht si një projekt në qershor të vitit 2000 dhe më vonë si faturën e plotë më 14 nëntor 2000. objekti i Projektligjit Bill thuhet në s. 1 (3), si duke përfshirë 'ekuivalencën funksionale e dokumenteve dhe njohjen e vlerës së tyre ligjore, pavarësisht nga mjeti të përdorur, dhe ndershkëmbimin e mediave dhe teknologjive ". Prandaj, ligji civil është gjithashtu në gjendje të mendojë e parimeve të UNCITRAL-it Model themelore. (Teksti i Quebec Bill 161 mund të gjenden në internet në http://ëëë.assnat.qc.ca/archives-36leg1se/eng/Publications/Projets-loi/publics/~~HEAD=pobj_00-a161.htm.)

⁶⁰Shih Poggi (2000), *supra* note 5, at 238.

⁶¹ Shiko Poggi (2000), *supra* note 5, at 238.

⁶²Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

Ligji Model për Tregtinë Elektronike, (MLEC- Model Law on Electronic Commerce 1996) synon të mundësojë dhe lehtësojë tregtinë e kryer përmes mjeteve elektronike, duke u siguruar ligjvënësve vendas një sërë rregulla të pranueshme ndërkombëtarisht me qëllim heqjen e pengesave ligjore dhe rritjen e parashikueshmërisë ligjore për tregtinë elektronike. Në veçanti, ky ligj ka për qëllim të tejkalojë pengesat që rrjedhin nga dispozitat ligjore që nuk mund të ndryshojnë në kontrata duke siguruar trajtim të barabartë për informacionin e bazuar në letër dhe elektronike. Një trajtim i tillë i barabartë është thelbësor për të mundësuar përdorimin e komunikimit pa letër, duke nxitur efikasitetin në tregtinë ndërkombëtare.⁶³

Gjithashtu MLEC-ja, vendos rregulla për formimin dhe vlefshmërinë e kontratave të lidhura me mjete elektronike, për atribuimin e mesazheve të të dhënave, për pranimin e pranimit dhe për përcaktimin e kohës dhe vendi i dërgimit dhe pranimit të mesazheve të të dhënave.⁶⁴

3.2 Llojet e Tregtisë Elektronike

Është e rëndësishme të theksohet fakti se llojet e tregtisë elektronike rrjedhin nga palët që hyjnë në një marrëdhënie juridike e cila synon transferimin e pronësisë mbi një product të

⁶³ Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

⁶⁴ Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

caktuar apo ofrimin e një shërbimi të caktuar. Parë në këtë këndvështrim, rezulton se, llojet e tregtisë elektronike janë:⁶⁵

i. Tregtia elektronike ndërmjet bizneseve ose e njohur gjerësisht me akronimin B2B (biznes- biznes).

Marrëdhënia B2B konsiston në shkëmbimin e produkteve, shërbimeve dhe ose informacionit ndërmjet bizneseve në tregjet elektronike, të cilat nuk ja gjë tjetër vecse faqe internet (web-sites) ku shitësit dhe blerësit ndërveprojnë me njëri- tjetrin për të realizuar transaksionet. Tregtia elektronike është forma më e madhe e tregtisë elektronike. Shembuj në këtë drejtim lidhen me distributorët online, prokurimi elektronik, shkëmbimi i mallrave, krijimi i rrjeteve industriale private etj.⁶⁶

Theksojmë se, nëse prodhuesi i një produkti të caktuar, si psh. Programe kompjuterike i ofron ato drejtpërdrejtë me anë të faqes së tij elektronike drejt konsumatorëve, atëherë kjo marrëdhënie cilësohet si B2C. Ndërsa kur ky prodhues nuk i tregon vetë drejtpërdrejt këto produkte tek konsumatorët, por përdor një firmë ndërmjetëse dhe ia kalon këto asaj pronësinë e produkteve të saj që më pas kjo e fundit t'ua shesë konsumatorëve atëherë në këtë rast marrëdhënia e krijuar midis tyre është marrëdhënie B2B.⁶⁷

ii. Tregtia elektronike e realizuar ndërmjet bizneseve dhe konsumatorëve, e njohur gjerësisht me akronimin B2C (biznes- konsumator).

⁶⁵ Ky klasifikim gjendet në “Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri”, Ë Malltezi, Jonida Rystemaj, Lealba Pelinku, mediaprint, faqe 483.

⁶⁶ United States Agency for International Development (USAID). Dhjetor 2013, faqe 9.

⁶⁷ Ky klasifikim gjendet në “Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri”, Malltezi A., Jonida Rystemaj, Lealba Pelinku, mediaprint, faqe 483.

Tregtia elektronike B2C, e njohur si shitja online (e-tailing), i referohet marketingut dhe shitjes së produkteve online në drejtim të konsumatorëve (individë).⁶⁸ Së pari, tregtia elektronike B2C mbështet ndërveprimin social midis konsumatorëve, duke lehtësuar komunikimin me njëri-tjetrin (dhe bizneset) me anë të postës elektronike, video-konferencave. Së dyti, u garanton konsumatorëve mjetet për të menaxhuar investimet dhe financat personale, duke përdorur veprimet bankare online. Së treti dhe më e rëndësishmja nga pikëpamja e biznesit, konsumatorët mund të blejnë produkte dhe informacione të ofruara nga biznesi.⁶⁹ Kjo formë elektronike mund të ilustruhet nga faqe të njohura nga internet, të cilat ofrojnë produkte si përshembull: Amazon.com apo eBay.

iii. Tregtia elektronike e realizuar ndërmjet bizneseve dhe organeve të qeverisjes, e njohur si B2G (biznes- qeveri).

Tregtia elektronike B2G, përgjithësisht përkufizohet si tregtia që realizohet ndërmjet shoqërive (biznesit) dhe sektorit public, duke përdorur mjetet elektronike. Kjo lloj tregtie elektronike i referohet përdorimit të internetit për prokurimin public, procedurat e licensimit dhe veprime të tjera të lidhura me qeverisjen. Theksojmë se, tregtia elektronike B2G karakterizohet nga dy element: Së pari, sektori publik merr një rol drejtues/ udhëheqës në këtë marrëdhënie. Së dyti, prezumohet se sektori publik ka nevojën më të madhe për ta bërë procedurën e prokurimit sa më efektive.⁷⁰

⁶⁸Managing E-commerce, J. Botha, C.Geldenhuys, Juta &Co, 2007, faqe 97.

⁶⁹E-commerce; a platform for integrated marketing case study on U.S retailing, Inga D.Schimtd, Thomas Dobler, Michael Schenk, faqe 33.

⁷⁰e- Commerce and e- Business, Zorayda Ruth Andam, May 2003, e- Asean Task Force, UNDP APDIP, faqe 12.

iv. Tregtia elektronike e realizuar ndërmjet konsumatorëve, e njohur si C2C (konsumator- konsumator)

Forma e tregtisë elektronike C2C, i referohet tregtisë së realizuar midis dy personave privatë në internet. Ky lloj modeli, ndihmohet nga portale që janë në internet për blerjen e produkteve që ofrohen nga persona të tjerë (që nuk janë biznese). Si shembull të kësaj tregtie, përmendim *eBay* ku individë të thjeshtë mund të sheshin dhe mund të blejnë lirisht produkte të cilat ofrohen nga persona të tjerë.

v. Tregtia elektronike e realizuar ndërmjet konsumatorëve dhe bizneseve , e njohur me akronimin C2B (konsumator- biznes).

Referuar modelit të tregtisë elektronike C2B, vlen të theksojmë se, individët shesin produkte apo ofrojnë shërbime drejt bizneseve. Pra, kjo formë e tregtisë elektronike tregon që kahu i zhvillimit të marrëdhënies tregtare është nga konsumatori tek biznesi.

*Tregtia elektronike krijon sfida dhe mundësi të reja për bizneset.*⁷¹

- Nga këndvështrimi i komunikimit, tregtia elektronike është shpërndarja e mallrave, shërbimeve, informacionit ose pagesave nëpërmjet rrjetit kompjuterik ose me çdo mjet tjetër elektronik.
- Nga këndvështrimi i procesit të biznesit, tregtia elektronike është aplikimi i teknologjisë drejt automatizimit të transaksioneve të biznesit dhe proceseve të punës.

⁷¹Drejt Tregtisë Elektronike, <http://dm-consulting.biz/wp-content/uploads/2014/03/Drejt-Tregtise-Elektronike-shqip.pdf> , parë për herë të fundit më 15 shtator 2016.

- Nga këndvështrimi i shërbimit, tregtia elektronike është një mjet që u përgjigjet dëshirës së bizneseve, konsumatorëve dhe menaxherëve, për të shkurtuar shpenzimet e shërbimit ndërkohë që rrit cilësinë e mallrave dhe shpejtësinë e ofrimit të shërbimeve.
- Nga këndvështrimi i internetit, tregtia elektronike ofron aftësinë në blerjen dhe shitjen e produkteve, informacione në internet dhe shërbime të tjera online.

3.1.3 Ligji Model i UNCITRAL “Për nënshkrimin elektronik”, i vitit 2001

Ky ligj u miratua nga UNCITRAL, në vitin 2001, në funksion të realizimit të tregtisë elektronike. Kontrata, që të jetë një veprim i vlefshëm, duhet të nënshkruhet rregullisht nga të dyja palët. Përsa i përket momentit të nënshkrimit të kontratës elektronike paraqet deri diku problematika. Për të kapërcyer këto vështirësi në fushën ndërkombëtare, UNCITRAL përgatiti ligjin model për nënshkrimin elektronik. Nënshkrimet elektronike lëshohen nga subjekte të licensuar për lëshimin e tyre dhe që një njëshkrim të jetë i vlefshëm duhet të ofrojë një nivel besueshmërie. Ligji përcakton se cilat janë kriteret që duhet të përmbushë nënshkrimi elektronik dhe kushtet për pajisjen e subjekteve me këtë nënshkrim.⁷²

Ligji Model për Nënshkrimet Elektronike (MLES- Model Law on Electronic Signatures) synon të mundësojë dhe lehtësojë përdorimin e nënshkrimeve elektronike duke vendosur kriteret të besueshmërisë teknike për ekuivalencën midis nënshkrimeve elektronike dhe të shkruara me dorë. Kështu, MLES-ja mund të ndihmojë shtetet në krijimin e një kuadri

⁷² Mallezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 518, Tiranë 2013

ligjor modern, të harmonizuar dhe të drejtë për të trajtuar në mënyrë efektive trajtimin ligjor të nënshkrimeve elektronike dhe të japin siguri për statusin e tyre.⁷³

Përdorimi i rritur i teknikave të autentifikimit elektronik si zëvendësues për nënshkrimet e shkruara me dorë dhe procedurat e tjera tradicionale të legalizimit sugjeruan nevojën për një kornizë ligjore specifike për të zvogëluar pasigurinë në lidhje me efektin ligjor që mund të rezultojë nga përdorimi i mjeteve elektronike. Në përgjigje të këtyre nevojave, MLES-ja ndërton parimin themelor në bazë të nenit 7 të Ligjit Model të UNCITRAL mbi Tregtinë Elektronike në lidhje me përmbushjen e funksionit të nënshkrimit në një mjedis elektronik duke ndjekur një qasje teknologjikisht neutrale, e cila shmang duke favorizuar përdorimin të çdo teknologjie ose procesi specifik.⁷⁴

Vlen të theksojmë se, MLES bazohet në parimet themelore të përbashkëta për të gjitha tekstet e UNCITRAL që kanë të bëjnë me tregtinë elektronike, përkatësisht mosdiskriminimin, neutralitetin teknologjik dhe ekuivalencën funksionale. MLES përcakton kriteret e besueshmërisë teknike për ekuivalencën midis nënshkrimit elektronik dhe të shkruar me dorë, si dhe rregullave themelore të sjelljes që mund të shërbejnë si udhëzues për vlerësimin e detyrimeve dhe detyrimeve për nënshkruesin, palën në varësi dhe palët e treta të besuara që ndërhyjnë në procesin e nënshkrimit. Përfundimisht, MLES përmban dispozita që favorizojnë njohjen e certifikatave të huaja dhe nënshkrimit

⁷³ Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

⁷⁴ Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

elektronik bazuar në një parim të ekuivalencës substanciale që shpërfill vendndodhjen e nënshkrimit të huaj.⁷⁵

Në vende të ndryshme të botës, si Amerika, Anglia, trajtimi i legjislacionit për kontratat elektronike, transaksionet dhe tregtia elektronike janë të bazuara në Ligjin Model për Tregtinë Elektronike. Përgjithësisht zhvillimi i tregtisë elektronike ka pësuar rritje në lëvizjet e ndryshme në lidhje me reformën e ligjit⁷⁶. Në këtë pikpamje, qasja e legjislacionit do të sjellë ndikim të rëndësishëm përse i përket zhvillimit teknologjik në fushën e kontratës së shitjes në mënyrë elektronike dhe në nënshkrimet elektronike. Zhvillimet në fushën e tregtisë elektronike dhe konkretisht të kontratës së shitjes elektronike, e ilustruam me dy vende të zhvilluara si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia.

Së pari, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tashmë, në shumë shtete kanë miratuar legjislacionin me qëllim të zbatimit të një Akti Elektronik të Transaksioneve Uniforme 1999 (UETA). Me qëllim të promovimit të uniformitetit në legjislacionin që rregullon kontratat elektronike dhe nënshkrimet elektronike, dy janë iniciativat: UETA dhe Nënshkrimet Elektronike në Aktin Global dhe të Tregtisë Kombëtare (ESIGN). UETA e përkufizon gjerësisht "*nënshkrimin elektronik*" si një simbol me një qëllim për të nënshkruar dokumentin (Uniform, 1999) E-SIGN siguron shumë dispozita për mbrojtjen e konsumatorit të cilat mbrojnë konsumatorët nga hyrja e tyre pa dashje në kontratat

⁷⁵Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

⁷⁶Boss AH (1998). 'Searching for Security in the Law of Electronic Commerce' (1998) 23 *Nova Law Review* 585, 597-8.

elektronike. E-SIGN kërkon që konsumatorët të ofrojnë pëlqimin e tyre dhe palën tjetër për të përmbushur numrin e kërkesave.⁷⁷

Në këtë këndvështrim, theksojmë se, në situatat ku një person ka për qëllim të nënshkruajë një dokument i cili nuk është i qartë, emri në një email, nuk do të të konsiderohet si nënshkrim, siç shihet në praktikën gjyqësore me palë ndërgjyqëse Brantley dhe Wilson (2006).⁷⁸ Në vijim, theksojmë se vlefshmëria e nënshkrimit elektronik është ende problematike pasi këto vendimet duhet të trajtohen me një kujdes të vecantë sepse nënshkrimet elektronike mund të manipulohen me lehtësi nga kjo mangësi e nënshkrimeve elektronike e cila ofron shumë hapësirë palëve kontraktuese për të ndryshuar kushtet e një kontrate të shitjes në mënyrë elektronike. Në ndryshim nga kontratat elektronike të shitjes, theksojmë se, nënshkrimet tradicionale mbrojnë palët nga mashtrimet në mënyrë specifike, identifikimin e nënshkruesit dhe ruajtjen e integritetit të dokumentit.⁷⁹ (Kania, 1999).

Së dyti, në përgjigje të një sërë raportesh dhe konsultimesh nga Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë, përgjigja e parë e Britanisë së Madhe drejt zhvillimit të elektronikës tregtia dhe komunikimi ishte futja e Aktit të Komunikimeve Elektronike 2000.⁸⁰

Akti i Komunikimeve Elektronike 2000, Rregulloret e nënshkrimit elektronik 2002 (Nënshkrimet Elektronike, 2002), kanë të bëjnë me kontratat elektronike, transaksionet dhe nënshkrimet elektronike në Mbretërinë e Bashkuar. Pjesa II e Akti i Komunikimeve

⁷⁷Friedman S E, 'Protecting Consumers From Arbitration Provisions, The Federal Arbitrations Act and E-SIGNs Notwithstanding' (2007-2008)

⁷⁸*Brantley v Wilson* US Dist LEXIS 17722, 6 (2006).

⁷⁹Kania ED (1997). 'The ABA's Digital Signature Guidelines: An Imperfect Solution to Digital Signatures on the Internet' (1999) 7 *CommLaw Conspectus*, 298-9.

⁸⁰Murray J (2003). 'Public Key Infrastructure, Digital Signatures and Systematic Risks' (2003) *Journal of Information, Law & Technology* <<http://elj.warwick.ac.uk/jilt/03-1/murray.html>> at 22 January 2009;

Elektronike 2000 parashikonjohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike dhe atë gjithashtu lehtëson përdorimin e komunikimeve elektronike ose ruajtja elektronike e informacionit si një alternativë ndaj letre ose mjete tradicionale magazinimi.⁸¹

Vlen të theksojmë se, rregulloret e tregtisë elektronike 2002, synojnë që, ofruesit e shërbimeve të ofrojnë informacione të tilla si: hapa teknike që duhen ndjekur për formimin e kontratat, mjetet teknike për korrigjimin e gabimeve të hyrjes, disponueshmëria e termave dhe kushteve të kontratës.⁸²

Një nënshkrim elektronik është çdo gjë në formë elektronike si:⁸³

- (a) përfshirja ose lidhja logjike me ndonjë komunikim elektronik ose të dhëna elektronike;
- (b) prezumohet të jetë e shoqëruar në mënyrë të tillë me qëllim që të përdoret duke përcaktuar origjinalitetin e komunikimit ose të dhënave, integritetin e komunikimit ose të dhënave, ose të dyja.

Akti, vetëm thekson se nënshkrimet elektronike, certifikimi dhe procesi në të cilin nënshkrimet dhe certifikatat të tilla janë krijuar, lëshuar dhe përdorur do të jenë të pranueshme në prova në kuptimin e origjinalitetit të komunikimit ose të të dhënave ose integritetin e komunikimit ose të dhënave.⁸⁴

Duke iu referuar çështjes gjyqësore me palë ndërgjyqëse *Nilesh Mehta kundër J Periera Fernandes S.A.*,⁸⁵ rezulton se, futja automatike e emrit në një adresë e-maili do të njihet si

⁸¹Harrington J (2002) 'UK and European Legislative Initiatives Regulating Electronic Commerce' in M Chissick and A Kelman (eds), *Electronic Commerce: Law and Practice* (3rd ed, 2002) 307-309.

⁸²Tasneem F. Legal Effect of Electronic Contracts: A Comparative Study. 2014 Global Advanced Research Journals.

⁸³ Electronic Communications Act 2000

⁸⁴Tasneem F. Legal Effect of Electronic Contracts: A Comparative Study. 2014 Global Advanced Research Journals

⁸⁵Mehta v Fernandes SA (2006) EËHC 813 (Ch), para 30-31.

një nënshkrim i vlefshëm vetëm nëse qëllimi i përsosur për të nënshkruar dokumentin elektronik është qartësisht e kuptueshme.

Një nga çështjet në fushën e tregtisë elektronike është se, a do të konsiderohen nga gjykatat kontratat elektronike ose të tjera dixhitale, si ato me "shkrim". Gjykata e Mbretërisë së Bashkuar në *Derby & Co.Ltd kundër Weldon (Nr.6)*,⁸⁶ të dhënat e mbajtura në dosjet kompjuterike janë dokumente të vlefshme dhe të pranueshme në gjykatë. Shtetet e Bashkuara gjykatat gjithashtu u përpoqën të zgjerojnë shkrimin për të përfshirë format dixhitale. Këto tendenca sugjerojnë se gjykatat ndoshta do të konsiderojnë forma të kontratave online dhe të tjera digjitale si "shkrim".⁸⁷

3.3 Konventa mbi përdorimin e komunikimeve elektronike në kontratat ndërkombëtare.⁸⁸(KKEKN), UNCITRAL, 2006

Qëllimi i Konventës së Komunikimeve Elektronike synon të lehtësojë përdorimin e komunikimeve elektronike në tregtinë ndërkombëtare duke siguruar që kontratat e lidhura dhe komunikimet e tjera të shkëmbyera në mënyrë elektronike janë po aq të vlefshme dhe të zbatueshme sa ekuivalentët e tyre tradicionale të bazuar në letër.⁸⁹ Konventa zbatohet për të gjitha komunikimet elektronike të shkëmbyera midis palëve, vendet e të cilave janë në

⁸⁶ [1991] 1 W.L.R. 652

⁸⁷ http://www.irfd.org/events/wf2003/vc/papers/papers_global/R38.pdf

⁸⁸ UN Convention on the Use of Electronic in International Contracts.

⁸⁹ Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

shtete të ndryshme kur të paktën një palë ka vendin e saj të biznesit në një shtet kontraktues.⁹⁰

KKEKN është miratuar me synimin që të eleminohen barrierat në realizimin e tregtisë elektronike. Kjo konventë shërbeu si shtesë përplotësimin e kuadrit ligjor të tregtisë elektronike të filluar me miratimin e ligjit model të vitit 1996. Konventa nuk është ndnëshkruar nga vendi ynë dhe ende nuk ka hyrë në fuqi, pasi sic përcakton edhe vetë Konventa, hyrja në fuqi e saj do të bëhet jetë në ditën e parë të muajit pas skadimit të afatit të 6 muajor nga data e depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit dhe miratimit ose aderimit. Megjithatë, arsyeja e trajtimit të kësaj konvente në këtë pjesë bëhet për të krahasuar standartin ndërkombëtar me atë të brendshëm. Po ashtu, kjo Konventë është krahasuar në paragrafin 18, më poshtë, më Konventën për shitjen ndërkombëtare të mallrave, në të cilën kemi aderuar.⁹¹

Vlen të thkesohet, se Neni 9 i Konventës së Komunikimeve Elektronike, përcakton kriteret për vendosjen e barazveshjes funksionale ndërmjet komunikimeve elektronike dhe dokumenteve të letrës, si dhe ndërmjet metodave të vërtetimit elektronik dhe nënshkrimit të shkruar me dorë. Ndërsa neni 10, i kësaj Konvente përcakton kohën dhe vendin e dërgimit dhe pranimit të komunikimeve elektronike, duke i përshtatur rregullave tradicionale për këto koncepte ligjore për t'iu përshtatur kontekstit elektronik dhe inovimit në lidhje me dispozitat e Ligjit Model mbi Tregtinë Elektronike.

⁹⁰ Neni 1 i Konventës mbi Përdorimin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare, UNCITRAL 2006 (US Convention on the Use Of Electronic in International Contracts).

⁹¹ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, "Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri", faqe 518, Tiranë 2013

Përfshihen nga fushëveprimi i Konventës, kontratat e lidhura për qëllime personale, familjare ose familjare, të tilla si ato që lidhen me të drejtën familjare dhe ligjin e trashëgimisë, si dhe transaksione të caktuara financiare, instrumente të negociueshme dhe dokumente të titullit, përfshihen nga fushëveprimi i Konventës.⁹²

Konventa e Komunikimeve Elektronike bazohet në instrumentet më të hershme të hartuara nga Komisioni, dhe në veçanti në Ligjin Model të UNCITRAL mbi Tregtinë Elektronike dhe Ligjin Model të UNCITRAL mbi Nënshkrimet Elektronike. Këto instrumente janë konsideruar gjerësisht tekstet standarde legjislativë që përcaktojnë tre parimet themelore të legjislacionit të tregtisë elektronike, të cilat Konventa përfshin, domethënë mosdiskriminimin, neutralitetin teknologjik dhe ekuivalencën funksionale.⁹³

Për më tepër, Konventa përcakton mjetet juridike në rast të gabimeve të dhëna nga personat fizikë që futin informacion në sistemet e automatizuara të mesazhit.⁹⁴ Gjithashtu, sipas nenit 3 të Konventës, përcaktohet se: palët kontraktuese lejohen që të përjashtojnë zbatimin e saj ose të ndryshojnë kushtet e saj brenda kufijve të lejuar nga dispozitat ligjore të zbatueshme.

Rritja e tregtisë elektronike është rritur në mënyrë proporcionale me përdorimin e kontratave elektronike si një mënyrë më të shpejtë dhe inovative për të kryer biznes. Midis 1998 dhe 2002 shumica e vendeve të përshtatur legjislacionin e tyre të brendshëm tregtar të

⁹² Neni 14 i Konventës mbi Përdorimin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare, UNCITRAL 2006 (US Convention on the Use Of Electronic in International Contracts)

⁹³ Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf parë për herë të fundit më datë 22.05.2017).

njohur kontratat elektronike dhe nënshkrimet, si ligjërisht instrumente të vlefshme. Ende disa vende më pak të zhvilluara janë realizuar këtë detyrë. Megjithatë, pavarësisht zgjerimit paepur e e-commerce dhe nxjerrjen e ligjeve që mbrojnë kontrata e-commerce, shumë biznese dhe përdorues të internetit nuk e di se pikërisht atë ligj zbatohet për kontratat e tyre e-commerce. Ligjet në vijim përbëjnë kornizën themelore ligjore të kontratave elektronike në Shtetet e Bashkuara. Përveç këtyre ligjeve specifike, ka disa ligje ndërkombëtare që mund të zbatohen për kontratat elektronike nëse palët kontraktuese vendosin të veprojnë në përputhje me to.⁹⁵

Ka dy kategori të gjera të kontratave elektronike:

Së pari, ato kontrata që tregtinë me mallrat fizike ose shërbimet.

Së dyti, ato kontrata që tregtojnë me materiale elektronike (softëare, imazheve, e-dorëzuar tekste, etj). Përveç tregtisë / rregullat bazë kontraktuale, secila kontratë në ndonjë nga këto dy kategori mund të jetë subjekt grup tjetër të politikës specifik rregullator. Për shembull, kontratat mbi produktet e duhanit, pijeve, dhe armët e zjarrit janë subjekt për më tej dhe rregulloret e rrepta të qeverisë; dhe kontratat për shërbime të Internetit telekomunikacionit dhe ofruesit e shërbimeve të internetit mund të jetë subjekt i ligjeve të telekomunikacionit vendore dhe rregulloreve. Vendosur në vijim e ligjeve referohen vetëm rregullat bazë kontraktuale çdo kontratë elektronike duhet të ndjekin për të qenë të detyrueshme për dhe të zbatueshme nga palët.⁹⁶

⁹⁵http://www.ibls.com/internet_law_news_portal_view.aspx?s=latestnews&id=1913, parë për herë të fundit në datën 14.09.2016

⁹⁶http://www.ibls.com/internet_law_news_portal_view.aspx?s=latestnews&id=1913

3.4 Konventa për përdorimin e komunikimeve elektronike në kontratat ndërkombëtare (KKEKN) versus kontrata për shitjen ndërkombëtare të mallrave (e njohur si: CISG- Convention on the International Sales of Good).

Në pikpamje krahasuese, të dyja Konventat (KKEKN dhe CISG⁹⁷) i referohen lidhjes së kontratave ndërkombëtare, por në dy mënyra të ndryshme. E para, parashikon regjimin që zbatohet për kontratat që realizohen me përdorimin e komunikimeve elektronike, ndërsa CISG i referohet në mënyrë specifike shitjes ndërkombëtare e cila nuk realizohet me anë të teknologjisë së informacionit.⁹⁸

Rekomandimet për reformën ligjore, për të rregulluar rritjen e shkëmbimeve të automatizuara të informacionit, në tregtinë ndërkombëtare iu bënë për herë të parë UNCITRAL-it⁹⁹ në 1984.¹⁰⁰ UNCITRAL miratoi një ligj model në tregtinë elektronike në 1966 që do të shërbente si model për legjilsacionin e brendshëm të shteteve anëtare.¹⁰¹ Por gjatë implementimit që shtetet anëtare i bënë këtyre rekomandimeve, rezultuan shumë divergjenca sidomos përsa i përkiste nënshkrimit elektronik. Këto divergjenca bënë që

⁹⁷ Është bërë pjesë e sistemit juridik të brendshëm me anë të ligjit nr. 10092, datë 09.03.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”.

⁹⁸ Maltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 520, Tiranë 2013

⁹⁹ UNCITRAL (United Nation Commission on International Trade Law)

¹⁰⁰ Philip M. Nichols, Electronic Uncertainty Within the International Trade Regime, 15 AM.U.INT’L L.REV.1379, 1405 (2000)

¹⁰¹ Philip M. Nichols, Electronic Uncertainty Within the International Trade Regime, 15 AM.U.INT’L L.REV.1379, 1405 (2000)

Shtetet e Bashkuara në 1998 të rekomandonin një konventë ndërkombëtare për tregtinë elektronike të bazuar në parimet para-ekzistuese të ligjit model për tregtinë elektronike.¹⁰²

KKEKN u miratua në formën e sqaj përfundimtare me 23 qershor 2005 dhe iu vendos në dispozicion shteteve anëtare për nënshkrim që prej janarit të 2006. Qllimi kësaj konvente është ti japë zgjidhje praktike për çështjet që lidhen me përdorimin e mjeteve elektronike nga kontratat ndërkombëtare.¹⁰³

Në ndryshim nga CISG, KKEKN aplikohet për përdorimin e komunikimeve elektronike në lidhjen dhe përmbushjen e një kontrate ndërmjet palëve, vendet e ushtrimit të bizneseve të të cilave janë të ndryshme.¹⁰⁴ CISG rregullon vetëm kontratën e shitjes ndërkombëtare të mallrave ndërsa fusha e veprimit të KKEKN është më e gjerë, ajo nuk kufizohet vetëm në shitjesn e mallrave, por të cfarëdolloj transaksioni i cili mund të realizohet duke shfrytëzuar komunikimet elektronike.¹⁰⁵

Termi “*komunikim elektronik*” përfshin cdo pohim, deklaratë kërkesë, njoftim, duke përfshirë këtu ofertën dhe pranimin e saj të bërë me një mjet elektronik, optik, magnetik ose mjete të ngjashme në lidhje me lidhjen dhe zbatimin e një kontrate.¹⁰⁶ Termi “kontratë” në Konventë përdoret në një kuptim të gjerë dhe përfshin për shembull, marrëveshjet e

¹⁰² U.N.Comm'on Int'I Trade Law, Working Group on Electronic Commerce, Note by the Secretariat, Prposal by the United States of America, U.N. Doc/A/CN.9/WG.IV.WP.77 (May 25, 1998)

¹⁰³ Explanatory note by the UNCITRAL secretariat on the United Nations Convention on the Use of Electronic Communication in International Contract, faqe 21

¹⁰⁴ Neni 1/1 i KKEKN

¹⁰⁵ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 521, Tiranë 2013

¹⁰⁶ Explanatory note by the UNCITRAL secretariat on the United Nations Convention on the Use of Electronic Communication in International Contract, faqe 21

arbitrazhit ose marrëveshjet të tjera të detyrueshme pavarësisht nëse titullohen ose jo “kontrata”.¹⁰⁷

Në këtë aspekt, KKEKN legjitimon përdorimin e komunikimeve elektronike jo vetëm në realizimin e kontratës por edhe në përmbushjen e saj. Si në planin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, lidhja e kontratës elektronike nuk i nënshtrohet kufizimeve, por vepron parimi i mirënjohur edhe ndërkombëtarisht lirisë kontraktore, pa patur nevojë që të pajiset me autorizime specifike.¹⁰⁸

Dispozitat e KKEKN lidhur me fushën e zbatimit, rregullat e interpretimit, rregullat për amendimet e propozuara dhe procedurat për derogimin dhe rregullat e paracaktuara rezultuan të ngjashme me dispozitat e Kontratës Ndërkombëtare të Shitjes së Mallrave (CISG). Kështu KKEKN ashtu si CISG kërkon që palët të kenë vende të ndryshme të ushtrimit të biznesit. CISG përveç këtij kriteri kërkon gjithashtu që kur nga aplikimi i rregullave të së drejtës ndërkombëtare private kërkojnë që të zbatohet ligji i një vëndi kontraktues (që ka miratuar konventën CISG).¹⁰⁹ CISG kërkon detyrimisht që vendet e ndryshme të ushtrimit të biznesit të palëve të kontratës të jenë shtete kontraktuese, ndërsa KKEKN nuk kërkon detyrimisht që këto dy shtete të jenë anëtare. Neni 19 parashikon se shtetet kontraktuese mund të deklarojnë se KKEKN do të zbatohet vetëm nëse:

¹⁰⁷Explanatory note by the UNCITRAL secretariat on the United Nations Convention on the Use of Electronic Communication in International Contract, faqe 21

¹⁰⁸ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 521, Tiranë 2013

¹⁰⁹ Neni 1/1 Konvent për shitjen ndërkombëtare të mallrave, miratuar me ligjin 10092, datë 9.3.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Kombeve të Bashkuara”, “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”.

- a) vëndet e ushtrimit të biznesit të palëve ndodhen në shtetet kontraktuese, ose
- b) palët bien dakort që, KKEKN do të jetë ligji rregullues i këtij transaksioni.

Konventa KKEKN, e ka një fushë zbatimi të kufizuar, ajo nuk zbatohet për komunikimet elektronike të shkëmbyera në lidhje me kontratat të lidhura për qëllime personale, familjare ose shtëpiake.¹¹⁰

Ky përjashtim është i ngjashëm me përjashtimin që bën Konventa për Shitjen ndërkombëtare të Mallrave. Përjashtimi i këtyre fushave nga veprimi i Konventës është absolut që do të thotë se Konventa nuk do të zbatohet për kontrata të lidhura për këto qëllime edhe sikur njëra nga palët të mos ishte në dijeni të qëllimit të kontratës. Për më tepër, konventa ka përjashtuar nga veprimi i saj transaksionet financiare pasi ato janë të rregulluara me detaje nga tjetër kuadër rregullues.¹¹¹ Po ashtu nuk rregullohen nga konventa instrumentet e negociueshëm për shkak të vështirësisë që ekziston për të krijuar një ekuivalent të ngjashëm me kontratën shkresore.

Theksojmë se, neni 3 i Konventës njeh dhe rithekson një parim të mirënjohur jo vetëm në legjislacionin e brendshëm; parimin e autonomisë kontraktore. Ky parim i cituar nga neni 3 i KKEKN përdor të njëjtën gjuhë ligjore si CISG. Neni 3 i Konventës u lejon palëve që të përjashtojnë konventën nga aplikimi i saj ose të ndryshojë efektet e dispozitave të saj. Po

¹¹⁰ Neni 2/1/ a I KKEKN

¹¹¹ Explanatory note by the UNCITRAL secretariat on the United Nations Convention on the Use of Electronic Communication in International Contract, faqe 14

ashtu, neni 6 i CISG u lejon palëve të përjashtojnë zbatimin e konventës, të shmangin ose ndryshojnë efektin e ndonjëres prej dispozitave të saj.¹¹²

Së fundi, ngjashmëria midis CISG dhe KKEKN referohet edhe rregullave të interpretimit.

Neni 5 I KKEKN dhe neni 7 i CIGS përcaktojnë se:

- a) Në interpretim të kësaj Konvente, vëmendje duhet ti kushtohet karakterit të saj ndërkombëtar dhe nevojës për të nxitur standartizimin në zbatimin e saj dhe ë respektimin e mirëbesimit në tregtinë ndërkombëtare.
- b) Çështjet që kanë të bëjnë me problemet e rregulluara nga kjo Konventë, të cilat nuk qartësohen shprehimisht në të duhet të zgjidhen në përputhje me parimet e përgjithshme mbi të cilën ajo bazohet ose, në mungesë të këtyre parimeve, në përputhje me ligjin e zbatueshëm në bazë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Është e kuptueshme që ky parim interpretimi duhet të ishte i njëjtë për të dyja konventat nisur nga karakteri i tyre ndërkombëtar dhe tregëtar. Pra, parimet e interpretimit janë parime të përgjithëshme të cilat janë të vlefshme për të dy këto akte. Këto rregulla do të kontribuojnë edhe në krijimin e një uniformiteti duke i orientuar gjykatat që në interpretimin që do i bëjnë konventës të marrin parasysh parimin e mirëbesimit, qëllimin për të nxitur standartizimin, karakterin ndërkombëtar të konventës.¹¹³

¹¹² Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, "Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri", faqe 522, Tiranë 2013

¹¹³ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, "Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri", faqe 523, Tiranë, 2013

Përsa i përket lidhjes së kontratës KKEKN e rregullon kohën e dërgimit dhe të marrjes së informacionit. Neni 10 i saj parashikon shprehimisht që:

- a) Koha e dërgimit të një komunikimi elektronik është koha kur ai lë një sistem informacioni nën kontrollin e krijuesit të informacionit ose të palës që e dërgon në emër të krijuesit të informacionit ose nëse komunikimi elektronik nuk e ka lënë sistemin e informacionit nën kontrollin e krijuesit të tij ose të palës që vepron në emër të krijuesit, konsiderohet koha kur merret komunikime elektronike.
- b) Koha e marrjes së komunikimit elektronik është koha kur informacioni mund të merret nga marrësi në një adresë elektronike të krijuar prej tij. Koha e marrjes së komunikimit elektronik në një adresë tjetër elektronike të marrësit është koha kur ky bëhet u mundshëm për 'tu marrë nga marrësi edhe kur marrësi është i vetëdijshëm që komunikimi elektronik i është dërguar në atë adresë. Një komunikim elektronik prezumohet se mund të merret nga marrësi kur ai arrin adresën elektronike të marrësit.

Kjo konventë synon të standartizojë rregullimet në arenën ndërkombëtare lidhur me realizimin e kontratave elektronike, për këtë arsye kjo konventë vendos edhe standarte të njëjta interpretimi. Kjo konventë do të shërbejë në fuksion të lehtësimit dhe të realizimit të kontratave elektronike duke përcaktuar standarde të trsanparencës, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së konsumatorit. Këto prime garantohen nga Konventa përvec të tjerash edhe

nëpërmjet parashkrimit të detyrimit për të korigjuar gabimet që mund të bëhen gjatë transmetimit të të dhanave nga sistemi i automatizuar.¹¹⁴

a) kontratës pas Kontrata është nënshkruar.

3.5 Llojet e kontratave elektronike në nivel ndërkombëtar ilustruar nëpërmjet praktikës gjyqësore.

3.5.1 Shkrik-Wrap, është ajo kontratë elektronike ku kushtet e kontratës janë të përfshira te produkti, në mënyrë që blerësi të vihet në dijeni të tyre, pasi e ka lidhur kontratën dhe e ka blerë produktin. Këtu përfshihet blerja e programeve kompjuterike ose produkteve të tjera të ngjashme.

Praktika gjyqësore e Shteteve të Bashkuara Amerikane, përsa i përket kontratave elektronike shrink-wrap, rezulton se, gjykatat amerikane kanë dëshmuar për të zbatuar në mënyrë rigoroz kontratat formale standarde.

i. ProCD, Inc. kundër Zeidenberg, 86 F.3d 1447 (7th Cir. 1996).

Gjykatësi Easterbrook¹¹⁵ i qarkut të shtatë, konstatoi se një licencë shrink-wrap e përfshirë me një CD-ROM që përmbante një bazë të dhënash jo të drejtpërdrejtë ishte e zbatueshme për të kufizuar të drejtat e blerësit të CD-së. Ky vendim hodhi poshtë opinionin e gjykatës së rrethit se kushtet e përmbajtura në licencën e kontratës elektronike ndërkombëtare

¹¹⁴ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 525, Tiranë 2013

¹¹⁵ ProCD, Inc. kundër Zeidenberg, 86 F.3d 1447 (7th Cir. 1996).

shrinkërap, ishin të pazbatueshme, sepse blerësi i CD-ROM nuk ishte pajtuar me ta në kohën e blerjes.

ii. *Mortenson Company, Inc. v. Timberline Software Corporation* 140 Wash.2d 568; 998 P.2d 305; 2000 Wash. LEXIS 287 (Wash. 2000).

Në *Mortenson Company, Inc. kundër Timberline Software Corporation*,¹¹⁶Gjykata Supreme e Uashingtonit vlerësoi se kufizimi i dëmeve të shkaktuara nga një licencë shrinkërap ishte e zbatueshme ndaj një të licencuari që paraqiti një ndërtim ofertën \$ 1.95 milion më pak se sa duhet të ketë qenë për shkak të një mosfunksionimi nga softueri. Licenca e softuerit e kufizoi përgjegjësinë e zhvilluesit të softuerit në çmimin e blerjes së softuerit. Gjatë përgatitjes së ofertës, softueri nuk funksionoi në mënyrë të përsëritur, çdo herë duke shfaqur mesazhin e gabimit në vijim: Abort. Nuk mund të gjej alternativë. Mortenson paraqiti ofertën e gjeneruar nga softueri, pavarësisht mesazhet e përsëritura të gabimit, dhe mësoi pasi u dha kontrata që oferta e tij ishte shumë më e ulët sesa që ishte menduar.

iii. *Edmond v. Gateway 2000, Inc.* 29 Conn. L. Rptr. 456 (Conn. Supr. 2001).

Në *Edmond v. Gateway 2000, Inc.*,¹¹⁷ një gjykatë e ndaloi procedurën përparaai dhe kërkoi që një konsumator të paraqiste në arbitrazh, një mosmarrëveshje në lidhje me

¹¹⁶*Mortenson Company, Inc. v. Timberline Software Corporation* 140 Wash.2d 568; 998 P.2d 305; 2000 Wash. LEXIS 287 (Wash. 2000).

¹¹⁷*Edmond v. Gateway 2000, Inc.* 29 Conn. L. Rptr. 456 (Conn. Supr. 2001). *Westendorf v. Gateway 2000, Inc.*, 41 Ucc Rep.

përshtatshmërinë e shërbimit të klientit të ofruar bazuar në kushtet e një kontrate shërbimi që Gateëay kishte përfshirë në kutinë me kompjuterin.

3.5.2 *Click-Wrap* është ajo kontratë elektronike ku blerësit, gjatë lidhjes online të kontratës i kërkohet të klikojë “I agree”/ (pranoj) në mënyrë që të shfaqë punimin se është dakort me kushtet e kontratës dhe para se transaksioni të ketë përfunduar. Edhe kjo formë shfaqet në blerjen e programeve, antivirusese etj.

*i. Treiber & Straub, Inc. v. UPS, Inc., 474 F.3d 379 (7 Cir. 2007)*¹¹⁸

Çështja: Treiber dërgoi një unazë \$ 100,000 nëpërmjet UPS dhe bleu \$ 50,000 siguracionin për pakon nga UPS. UPS humbi pakon dhe mohoi cdo përgjegjësi për humbjen, sepse kushtet e tyre të përdorimit për të cilat Treiber klikoi dy herë “I Agree”, (pranoj), nuk i lejoi dërgesat e një vlerë më shumë se \$ 50,000.

Çështja: A krijojnë një marrëveshje detyruese termat dhe kushtet e UPS-së, si përgjegjësi për tarifën e transportit detar dhe për sigurimin e politikave?

Gjykata vendosi: Termat dhe kushtet janë pranuar dy herë për nga TREIBER dhe tarifa dhe Sigurimi Policor, të dyja ofruan të njëjtën klauzolë të kufizuar me vlerën e artikujve të dërguar të \$ 50.000 ose më pak. Nuk ishte njoftimi i mjaftueshëm dhe marrëveshje e qartë nga TREIBER, pavarësisht nga nëse ai i kuptoi kushtet e marrëveshjes.

¹¹⁸ Contracts 2.0: Making and Enforcing Contracts Online, Association of Corporate Counsel September 2012, faqe 26.

*i. Costar Realty Info., Inc v. Field, 612 F. Supp. 2d 660 (D.MD 2009)*¹¹⁹

Fakte: CoStar e licencuar në regjistrin e saj të pronave të patundshme në Alliance Group. Alliance Group pastaj e ndan qasjen e saj me një palë të tretë, e cila nuk ishte i autorizuar sipas kushteve të përdorimi të rënë dakord nga Alliance Group. CoStar u zhvendos për të zbatuar kushtet e përdorimit.

Issue: A mund të zbatohen kushtet e përdorimit në qoftë se përdoruesi nuk ka shqyrtuar kushtet, dhe në faktësthtë një palë e tretë të marrëveshjes?

Gjykata vendosi: Hapi afirmative duke klikuar një kuti dhe duke pranuar kushtet dhe lidhur marrëveshjen me “AllianceGroup”, duke përfshirë të gjithë ata që Aleanca ndaluar fjalë kalimin e saj. Dështimi për të mos lexuar kontratën nuk e bën atë të pavlefshëm.

*ii. Segal v. Amazon.com, Inc 763 F. Supp. 2d 1367 (S.D. Fla. 2011)*¹²⁰

Fakti: Segal u përpoq për të zhvlerësuar një klauzolë përzgjedhëse të forumit të shitjeve, në marrëveshjen të përmbajtura në Amazon.com, duke pretenduar pjesërisht se për shkak se klauzola është përfshirë në një marrëveshje click-ërap, nuk është e detyrueshme sepse Segal nuk e ka lexuar kontratën.

Çështja: A krijon kontrata click- wrap një marrëveshje detyruese edhe në qoftë se pala nuk i ka lexuar kushtet?

¹¹⁹ Contracts 2.0: Making and Enforcing Contracts Online, Association of Corporate Counsel September 2012, faqe 26.

¹²⁰ Contracts 2.0: Making and Enforcing Contracts Online, Association of Corporate Counsel September 2012, faqe 26.

Gjykata vendosi: Kontratat click- wrap janë të detyrueshme dhe të zbatueshme në të gjithë qarqet federale. Dështimi për të lexuar një kontratë nuk e arsyeton/ justifikon një palë nga të qenit i lidhur me të.¹²¹

3.5.3 **Browse-wrap**, është ajo kontratë elektronike ku thjeshtë fakti se që përdoruesi lundron në një faqe të caktuar interneti do të thotë se i ka pranuar kushtet e kontratës dhe se i ka lidhur atë. Kjo kontratë është një formë e rrezikshme e cila mund ti cënojë rëndë të drejtat e përdoruesit pikërisht për shkak të faktit se ai e ka të pamundur të provojë së nuk kishte dijeni se po lidhte një kontratë online.¹²²

Praktika gjyqësore mbi kontratën elektronike Browse- wrap.

*i. Specht v. Netscape Commc'ns Corp, 306 F.3d 17 (2d Cir. 2002)*¹²³

Fakte: Netscape lejon përdoruesit për të shkarkuar free software duke klikuar në një kuti të caktuar. Software është subjekt i një marrëveshje të licencës që përmban një klauzolë arbitrazhi. Ky përdorues nuk kërkon të pranojë, për të rënë dakord me termat dhe kushtet e kontratës së licencës parashkarkimit të softuerit dhe nuk ka asnjë njoftim për marrëveshjen e licencës deri në përdorimin e fletushkave poshtë faqes tjetër. Faqja tjetër lejon përdoruesin të klikoni mbi një hyperlink që do të marrë përdoruesit në një faqe të internetit për të lexuar termat dhe kushtet e plotë.

Çështja: A janë përdoruesit subjekt të klauzolës së arbitrazhit thjesht sepse ata shkarkuar

¹²² Electronic contracting: legal problem or legal solution? Amelia H. Boss, faqe 2

¹²³ Contracts 2.0: Making and Enforcing Contracts Online, Association of Corporate Counsel September 2012, faqe 29.

softëare?

Gjykata vendosi: Klauzola në këtë rast ishte e pavlefshme, sepse marrëveshja nuk ishte e dukshme parapër përdoruesit ndeshin butonin e download-imit. Gjykata e la të hapur mundësinë për krijimin e një marrëveshje detyruese kur përdoruesi është vënë në një njoftim të qartë se ata janë duke u pajtuar përtermat prapa një lidhje. Për sa kohë që një vëzhgues objektiv do të gjenin kushtet që ishindispozicion, kontrata ka gjasa të gjenden e detyrueshme.

ii. *Southwest Airlines v. Boardfirst, LLC., 2007 U.S. Dist. LEXIS 96230 (N.D. Tex. 2007)*¹²⁴

Fakte: Faqja e internetit në jug-perëndim, lejon pasagjerët të kontrollojnë për fluturime duke filluar 24 orëpara nisjes. Pasagjerët marrin një fletëhyrje për të hipur në aeroplan. "Boardfirst" është një faqe interneti që ndihmon pasagjerët Southwest, të marrin "A" boarding, kalon për një tarifë. Një pasagjer ofron Boardfirst me informacionin që lejon Boardfirsttë hyni në faqen e internetit Jugperëndimore si një agjent. shtypura gjobë në fund të Southëest-sëhomepage tregon se përdorimi i faqeje ju pranoni Kushtet dheKushtet, i cili në atë kohë u kufizuar në, qëllime jo personale komerciale.

Çështja: A është kjo një kontratë e vlefshme? A ka shkelur Boardfirst termat dhe kushtet e përdorimit?

¹²⁴Contracts 2.0: Making and Enforcing Contracts Online, Association of Corporate Counsel September 2012, faqe 30.

Gjykata vendosi: Boardfirst ka pasur njoftim të mjaftueshëm mbi Termat dhe Kushtet për të formuar një kontratë të vlefshme dhe jo tëshkelë kontratën duke përdorur faqen e internetit Jugperëndimore për një qëllim komercial pasi u vu në njoftimin e kushteve.

iii. *Cvent, Inc. v. Eventbrite, Inc. 739 F. Supp. 2d 927 (E.D. Va. 2010)*¹²⁵

Fakte: Cvent pohoi se Eventbrite shkelur kushtet e shërbimit për faqen e saj duke kopjuarpërmbajtje për përdorim Eventbrite-së. Një lidhje me termat ishte në dispozicion vetëm në faqen e parë të faqen e internetit, dhe të përziara në mesin e disa dhjetra lidhje të tjera të së njëjtës madhësi dhe ngjyra nënë fund të faqes.

Çështja: A është një lidhje e vetme në faqen e parë të një vendi të mjaftueshme për të vendosur kushtet e njoftimit të një klienti?

Gjykata vendosi: Sikur Cvent ti bënte kushtet e tyre, të dukshmenë faqen e tyre dhe jo ti fshihte ato. Vendosja e lidhjes dhe faktise ajo ishte vetëm në faqen e parë nuk paraqet njoftim të mjaftueshëm të kushteve që të krijojonte një kontratë të detyrueshme.

Përmbledhje e kontratave në formë elektronike Click- Wrap, Browse- Wrap

1. Një kontratë nuk është më pak një kontratë thjesht sepse ajo është e lidhur nëpërmjet një kompjuteri.¹²⁶
2. Rregullat ligjore në lidhje me marrëveshjet internet janë ende duke u zhvilluar (përmirësuar).¹²⁷

¹²⁵Contracts 2.0: Making and Enforcing Contracts Online, Association of Corporate Counsel September 2012, faqe 30.

¹²⁶Forrest v. Verizon Communications Inc., 805 A.2d 1007 (D.C. App. 2002) (emphasis added).

3. Gjykatat në përgjithësi të zbatojnë parimet tradicionale të ligjit të kontratës për kontratat online.¹²⁸

4. Pjesa më e madhe e marrëveshjeve online marrin formën e një kontrate "click-wrap".¹²⁹

5. Në një marrëveshje "click-wrap", përdoruesi zakonisht manifeston pëlqimin duke klikuar një "ikon" në një web-faqe.¹³⁰

- Megjithatë, gjykatat, kanë zbatuar marrëveshjet browse-wrap bazuar në sa më poshtë:

Arsyetimi:¹³¹

* Njerëzit hyjnë shpesh në kontratat e shërbimit duke mos i parë parë kushtet.¹³²

* Më shumë të ekzekutueshme kundër vizitorëve të shpeshtë të sites.¹³³

*Tre dallime thelbësore ndërmjet kontratave click-wrap dhe browse-wrap.*¹³⁴

¹²⁷ Shih Bluebird, LLC., v. Nolan, No. 302920-V., 2009 WL 1498703 (Md. Cir. Ct. April 28, 2009). Virginia still has not addressed the issue in state courts, but it has been addressed in a federal court interpreting Virginia law. See A.V. v. Iparadigms, LLC, 544 F. Supp. 2d 473, 480 (E.D. Va. 2008) (federal court interpreting Virginia state law). California also has had online contract formation discussed in federal law interpreting state law. See Feldman v. Google, Inc., 513 F. Supp. 2d 229, 236 (E.D. Pa. 2007).

¹²⁸ Shih Bluebird, LLC, No. 302920-V., 2009 WL 1498703 (no page numbers are provided for this case); See A.V. v. Iparadigms, LLC, 544 F. Supp. 2d at 480; See also Juliet M. Moringiello & William L. Reynolds, American Bar Association Electronic Contracting Cases 2008-2009, 65 Bus. Law. 317 (2009) ("The courts uniformly treat those agreements as they would any other form of contracting. If you click, you're bound.").

¹²⁹ Bluebird, LLC., No. 302920-V., 2009 WL 1498703.

¹³⁰ Contracts 2.0: Making and Enforcing Contracts Online, Association of Corporate Counsel September 2012, faqe 5.

¹³¹ Shih Pollstar v. Gigmania Ltd., 170 F. Supp. 2d 974, 981-82 (2000) (browse-wrap held enforceable despite agreement printed in gray and superimposed on slightly different gray background); see also Register.com v. Verio, Inc., 356 F.3d 393, 431 (2d Cir. 2004) (agreement similar to browse-wrap where terms sent after going to website, thus no assent on the first visit to the website but a frequent visitor could be bound).

¹³² Po aty

¹³³ Shi James J. Tracy, Legal Update: Browsewrap Agreements: Register.com, Inc. v. Verio Inc., 11 B.U. J. Sci. & Tech. L. 164, 170 (2005); Register.com v. Verio, Inc., 356 F.3d at 431.

Së pari: Në rastin e kontratave click-wrap, përdoruesit kanë informacion ndihmës në lidhje me kushtet e kontratës pasi atyre u paraqitën të gjitha kushtet e kontratës para se kontrata të lidhet. Megjithatë, me kontratat browse-wrap kushtet e kontratës shfaqen për përdoruesin vetëm nesë ato klikojnë në lidhjen (hyperlinkun) që i drejton në faqen që i referohet “kushteve të kontratës”.

Së dyti: Në mënyrë që të përmbushin qëllimin e tyre primar (si për shembull shkarkimi i programeve ose blerja e një bilete online etj.), përdoruesit duhet të njihen me kontratën click-wrap dhe kushtet e saj që shfaqen duke klikuar në një faqe. Me kontratën browse-wrap, përdoruesit e realizojnë qëllimin e tyre primar pa klikuar në lidhjen (hyperlink) që referon tek “kushtet e kontratës” dhe pa e parë kontratën ose kushtet e saj.

Së fundi, me kontratën browse-wrap përdoruesit nuk mund ta kuptojnë që një kontratë është realizuar. Për shkak të këtyre diferencave, gjykatat e kanë trajtuar këto kontrata ndryshe.¹³⁵

Për të mbështetur transaksionet elektronike në të njëjtën mënyrë si transaksionet konvencionale kontratat elektronike janë të nevojshme, të cilat kryejnë të njëjtin funksion dhe për të përmbushur të njëjtën gjë kërkesat si kontratat konvencionale. Nga bazat e ligjit

¹³⁴ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 518, Tiranë 2013

¹³⁵ Kautsov M.Das, Forum –Selection Clauses In Consumer Clickwrap And Browse-wrap.

të kontratës dhe procesin e përshkruar në seksionet e mëparshme kontraktuese, kërkesat e mëposhtme ligjore mund të jetë përmbledhur mbi kontratave elektronike: ¹³⁶

- b) Identifikimi i qartë i palëve kontraktuese.
- c) Tregues i qartë i lëndës së kontratës
- d) Tregues i qartë i afatit të vlefshmërisë.
- e) Kontrata duhet të ketë nënshkrime të vlefshme nga palët e përfshira që vërteton tyre Pranimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratë. Nënshkrimi duhet të jetë i shoqëruar nga një datë që tregon fillimin e vlefshmërisë së kontratës.
- f) “Non-divorc”, domethënëaskush nuk duhet të jetë në gjendje për të ndryshuar përmbajtjen.

3.6 Kushtet elektronike të ICC, 2004

Kushtet elektronike të ICC konsistojnë vetëm në dy nene. Njëri prej të cilëve jep përkufizimin e “marrëveshjes së tregtisë elektronike”, dhe tjetri përcakton rregullin e dërgimit dhe marrjes së mesazhit elektronik. Këto dy rregullime aplikohen për të gjitha kontratat që lidhen elektronikisht. ¹³⁷

*Kushtet elektronike të ICC 2004:*¹³⁸

¹³⁶ Legal Aspects of Electronic Contracts, Michael Gisler, Katarina Stanoevska-Slabeva, Markus Greunz, faqe 7. Shih në adresën elektronike <http://ceur-ws.org/Vol-30/paper7.pdf>, kontrolluar për herë të fundit më 26.09.2016.

¹³⁷ A. Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 518, Tiranë 2013

¹³⁸ <http://www.iccwbo.org/products-and-services/trade-facilitation/tools-for-e-business/>

- a) janë të dizajnuara për të rritur sigurinë ligjore të kontratave të bëra me mjete elektronike.
- b) të japë me dy artikuj të shkurtër, të lehtë për të përfshirë në kontratat e tua, të cilat e bëjnë të qartë se ju dhe pala juaj synojnë të bien dakord për një kontratë të detyrueshme elektronike.
- c) nuk ndikojnë në lëndën e kontratës në tuaj, dhe nuk do të ndërhyjë në asnjë mënyrë me çdo kusht që mund të keni rënë dakord ndryshe me: ata thjeshtë lehtësojnë procedurat dhe përdorimin e mjeteve elektronike në lidhjes së kontratës.
- d) mund të përdoret për çdo kontratë që përfshin shitjen ose disponimin tjetër të mallrave, të drejtave ose shërbimeve.
- e) mund të përdoret kudo që të hartojë kontrata me mjete elektronik

3.7 Udhëzimi i ICC për kontraktimin elektronik, 2004

Udhëzuesi i ICC plotëson setin e rregullave në funksion të realizimit të tregtisë elektronike. Ky udhëzues është realizuar në formën e një shpjeguesi për kushtet elektronike të sipërmendura. Konkretisht në këtë udhëzues rregullohen: Si aplikohen kushtet elektronike të ICC 2004; vlefshmëria e kushteve elektronike të ICC 2004; kufijtë e kushteve elektronike të ICC; kush kontraktin në emrin tuaj, me kë jeni ju duke kontraktuar; si krijohet një kontratë elektronike; cilat janë specifikimet teknike; si mbrohet konfidencialitetit, si të menaxhohen zbulimet teknike dhe risku.¹³⁹

3.8 Plan- veprimi global i ICC për biznesin elektronik, 2002

¹³⁹ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 519, Tiranë 2013

Ky plan synon të rrisë besimin e përdoruesve tek bizneset që ofrojnë shërbime online. Ky plan përfshin një sërë çështjesh si për shembull formalitetet ligjore të komunikimeve elektronike, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve online, juridiksionin dhe ligji i zbatueshëm, mbrojtja e të dhënave etj.

3.9 Rekomandimet e OECD- së drejtuar për bizneseve për mbrojtjen e konsumatorëve në kontekstin e tregtisë elektronike.

Në mbrojtje të këtyre të drejtave OECD për të garantuar mbrojtje transparente dhe eficiente i ngrakon të gjitha palët pjesëmarrëse në këtë transaksion të bashkëpunojë në mënyrë që të arrijnë nivele të kënaqshme të mbrojtjes. Rekomandimet në fjalë përcaktojnë qartë se cilat janë detyrimet për bizneset kryesisht lidhur me detyrimet për publikimin e informacionit dhe përcaktimin e saktë të cmimit dhe mënyrave të sigurta të pagesës.¹⁴⁰ Ndër rekomandimet e OECD përmendim:¹⁴¹

I. Mbrojtja transparente dhe efektive

Konsumatorëve të cilët marrin pjesë në tregtinë elektronike duhet t'u garantohet mbrojtje transparente dhe efektive, e cila nuk duhet të jetë më pak se niveli i mbrojtjes së dhënë në forma të tjera të tregtisë.

Qeveritë, bizneset, konsumatorët dhe përfaqësuesit e tyre duhet të punojnë së bashku për të arritur këtë mbrojtje dhe për të përcaktuar ndryshimet që mund të jenë të nevojshme për të rregulluar rrethanat e specifike të tregtisë elektronike.

II. Praktika të drejta biznesi, reklamimi dhe marketingu

¹⁴⁰ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, "Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri", faqe 512, Tiranë 2013

¹⁴¹ Malltezi A., Listën e plotë të rekomandimeve të OECD e gjeni në faqen e internetit <http://www.oecd.org/dataoecd/18/13/34023235>

Bizneset e angazhuara në tregtinë elektronike duhet t'u kushtojnë vëmëndjen e duhur interesave të konsumatorëve dhe të veprojnë në përputhje me praktikën e drejtë të biznesit, reklamave dhe marketingut.

Bizneset nuk duhet të përfaqësojnë, të mos veprojnë, ose të angazhohen në praktika që ka të ngjarë të jenë mashtruese, keq-orientuese, apo të padrejta.

Bizneset që shesin, që promovojnë apo që realizojnë marketing me mallra apo shërbime për konsumatorët nuk duhet të përfshihen në praktika që ka të ngjarë të shkaktojnë rrezik të paarsyeshëm në dëm të konsumatorëve.

Sa herë që bizneset vënë në dispozicion informacione për veten ose për mallrat ose shërbimet që ofrojnë, ata duhet të paraqesin këtë informacion në mënyrë të qartë, dukshëm të saktë dhe lehtësisht të arritshëm.

Bizneset duhet të përmbushin detyrimet që marrin përsipër në prezantimet që bëjnë në lidhje me politikat ose praktikën në lidhje me transaksionet e tyre me konsumatorët.

Bizneset duhet të marrin parasysh natyrën globale të tregtisë elektronike dhe, ku është e mundur, duhet të marrin parasysh karakteristikat e ndryshme rregullatore të tregjeve të synuar.

Bizneset nuk duhet të shfrytëzojnë karakteristikat e vecanta të tregtisë elektronike për të fshehu identitetin e tyre të vërtetë ose vendodhjen, apo për të shmagur përmbushjen e standarteve për mbrojtjen e konsumatorit dhe ose/ mekanizmat e zbatimit.

Bizneset nuk duhet të përdorin terma të padrejta kontraktimi.

Reklamimi dhe marketingu duhet të jenë qartësisht të identifikueshëm si të tillë.

Reklamimi dhe marketingu duhet të identifikojnë biznesin në emër të të cilit janë duke u zhvilluar, në të kundërt, reklamimet dhe marketingu do të konsiderohen mashtruese.

Bizneset duhet të jenë në gjendje për të mbështetur çdo prezantim të shprehur apo të nënkuptuar për sa kohë që prezantimi është ruajtur edhe për një kohë të arsyeshme pas realizimit të tij.

Bizneset duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë procedura efektive dhe të thjeshta që lejojnë konsumatorët të zgjedhin nëse ata dëshirojnë ose jo të marrin mesazhe tregtare të pashkruara me e-mail.

Nëse konsumatorët kanë treguar se ata nuk duan të marrin mesazhe tregtare të pa-kërkuara me e-mail, kjo zgjedhje duhet të respektohet.

Në një numër vendesh, mesazhet tregtare të pakërkuara të dërguara me e-mail janë subjekt i rregullimeve specifike ose vetërregullimeve.

Bizneset duhet të kenë kujdes të vecantë lidhur me reklamimin apo marketingun që synon fëmijët, të moshuarit, personat e sëmurë rëndë, dhe të tjerët që nuk mund të kenë kapacitetin për të kuptuar plotësisht informacionin që u është paraqitur.

III. Publikimet online

A. Informacionet rreth biznesit

Bizneset e angazhuara në tregtinë elektronike duhet të sigurojnë për konsumatorët informacion të saktë, të qartë dhe lehtësisht të aksesueshëm, i mjaftueshëm, duke lejuar, të paktën:

- i) Identifikimin e biznesit- duke përfshirë emrin ligjor të biznesit dhe emrin sipas të cilit ai tregton, adresën kryesore gjeografike për biznesin; adresën e e-mailit ose mjete të tjera elektronike të kontaktit, apo numrin e telefonit, dhe, kur është e aplikueshme, një adresë për qëllime të regjistrimit dhe cregjistrim të rëndësishëm në autoritetet qeveritare ose në numrin e licencës;

- ii) Komunikimin e shpejtë, të lehtë dhe efektiv të konsumatorit me biznesin;
- iii) Zgjidhjen e duhur dhe efektive të mosmarrëveshjeve;
- iv) Shërbimi dhe proceset ligjore, dhe
- v) Vendodhja e biznesit dhe drejtuesit e saj sipas ligjit.

Kur një biznes boton anëtarësimin e tij në ndonjë skemë vetërregulluese, shoqatë biznesi, organizatë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ose në cdo organ tjetër certifikues, biznesi duhet t'u sigurojnë konsumatorëve të dhënat e kontaktit dhe një metodë të lehtë për të verifikuar anëtarësimin dhe mundësinë për të patur akses në kodet përkatëse dhe praktikrat e organit certifikues.

B. Të dhënat mbi mallrat ose shërbimet

Bizneset e angazhuar në tregtinë elektronike me konsumatorët duhet të sigurojnë informacion saktësisht dhe lehtësisht të aksesueshëm në përshkrimin e mallrave ose shërbimet e ofruara; të mjaftueshëm për t'u mundësuar konsumatorëve që të marrin një vendim të informuar nëse do të hyjnë në transaksion dhe në mënyrë që i mundëson konsumatorët për të mbajtur regjistrimet e duhura të informacionit.

C. Informacion rreth transaksioneve

Bizneset e angazhuar në tregtinë elektronike duhet të sigurojnë informacion të mjaftueshëm në lidhje me kushtet kontraktore dhe kostot e lidhura me një transaksion në mënyrë që t'u japë mundësi konsumatorëve të marrin një vendim të informuar për të hyrë në transaksion ose jo.

Një informacion i tillë duhet të jetë i qartë, i saktë, i arritshëm, dhe i ofruar në mënyrë të tillë që t'i japë konsumatorit mundësi të mjaftueshme për shqyrtim para se të hyjnë në transaksion.

Ku më shumë se një gjuhë është në dispozicion për të kryer transaksionin, bizneset duhet të vendosin në dispozicion në këto gjuhë të gjithë informacionin e nevojshëm për konsumatorët për të marrë një vendim të informuar lidhur më transaksionin.

Bizneset duhet t'u sigurojnë konsumatorëve një tekst të qartë dhe të plotë të kushteve përkatëse të transaksionit në mënyrë që konsumatorëve t'u krijohet mundësia për të aksesuar dhe për të mbajtur të dhëna të përshtatshme të informacionit të tillë.

Kur është e zbatueshme dhe e përshtatshme për shkak të transaksionit, informacioni duhet të përfshijë të dhënat në vijim:

- i) ndarjen në njësi të kostove totale që mblidhen dhe/ ose vendosen nga biznesi;
- ii) njftimin për kezikencën e shoenzimeve të tjera rutinë të zabtueshme ndaj konsumatorit që nuk mblidhen dhe/ ose vendosen nga biznesi;
- iii) kushtet e dorëzimit, ose përmbushjes;
- iv) kushtet kontraktore dhe metodat e pagesës;
- v) kufizimet ose kushte të blerjes, të tilla si: kërkimi i miratimit prindëror/ kujdestar, kufizime gjeografike ose kohore;
- vi) udhëzimet për përdorimin e duhur, duke përfshirë paralajmërime për sigurinë dhe kujdesin shëndetësor;
- vii) informacion në lidhje me, tërheqjen, përfundimin e këmbimit, kthimi, anulimin dhe/ ose informacioni mbi politikat e rimbursimit;
- viii) garancitë në dispozicion.

Të gjitha informatat që i referohen shpenzimeve duhet të tregojnë monedhën e aplikueshme.

IV. Procesi i konfirmimit

Për të shmangur paqartësitë në lidhje me qëllimin e konsumatorit për të realizuar një blerje, konsumatori duhet të jetë në gjendje, para përfundimit të blerjes, të identifikojë saktësisht mallrat ose shërbimet që ai apo ajo dëshiron të blejë; të identifikojë dhe të korrigojë ndonjë gabim ose ndryshojë rendin; të shprehë pëlqimin e informuar dhe të qëllimshëm të blerjes, dhe të mbajë një rekord të plotë dhe të saktë të transaksionit.

Konsumatori duhet të jetë në gjendje të anulojë transaksion para përfundimit të blerjes.

V. Pagesa

Konsumatorët duhet të pajisen me një mënyrë të lehtë për të përdorur mekanizma të siugrt të pagesave dhe të kenë informacion mbi nivelin e sigurisë së këtyre mekanizmave.

Kufizimet e përgjegjësisë për përdorim të sistemeve të paautorizuara ose mashtruese të pagesave, dhe mekanizmat garantues ofrojnë mjete të fuqishme për të rritur besimin e konsumatorit. Zhvillimi dhe përdorimi i tyre duhet të inkurajohet në kontekstin e tregtisë elektronike.

VI. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe zhdëmtimi

A. Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

Transaksionet ndërkufitare biznes- konsumator, nëse kryehn elektronikisht ose ndryshe janë subjekt i kornizës ekzistuese të ligjit të zbatueshëm dhe juridiksionit.

Tregtia elektronike paraqet sfida ndaj kuadrit ekzistues. Prandaj, konsideratë duhet t'i jepet faktit nëse korniza ekzistuese për ligjin e zbatueshëm dhe juridiksionin duhet të modifikohet, ose të aplikohet ndryshe, për të siguruar mbrojtje efektive dhe transparente të konsumatorit në kontekstin e rritjes së vazhdueshme të tregtisë elektronike.

Gjatë shqyrtimit nëse duhet të ndryshohet korniza ekzistuese, qeveritë duhet të përpiqen që të sigurojnë që korniza të ofrojë drejtësi për konsumatorët dhe bizneset, të lehtësojë

tregtinë elektronike, t'u garantojë konsumatorëve një nivel mbrojtje jo më pak se ajo që garantohet në forma të tjera të tregtisë, si dhe të sigurojë konsumatorët me akses real për zgjidhje të drejtë dhe në kohë të mosmarrëveshjeve dhe zhdëmtim pa kosto ose pengesa të panevojshme.

B. Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve dhe dëmshpërblimi

Konsumatorëve duhet t'u sigurohet mundësi reale për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë, në kohë dhe pa kosto ose pengesa të panevojshme.

Bizneset, përfaqësuesit e konsumatorëve dhe qeveria duhet të punojnë së bashku që të vazhdojnë të përdorin dhe të zhvillojnë politika dhe procedura të drejta, efikase transparente dhe vetërregulluese, duke përfshirë edhe mekanizma alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për të adresuar ankesat e konsumatorëve dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet e konsumatorit që rrjedhin nga tregtia elektronike ndërmjet bizneseve dhe konsumatorëve, duke i kushtuar vëmendje të vecantë transaksioneve ndërkufitarë.

Bizneset dhe përfaqësuesit e konsumatorëve duhet të vendosin mekanizma të brendshëm të drejtë, efikasë dhe transparentë për të trajtuar dhe për t'u përgjigjur ankesave të konsumatorëve në mënyrë të drejtë, në kohë dhe pa kosto, apo pengesa të panevojshme për konsumatorin. Konsumatorët duhet të inkurajohen për të përfituar nga mekanizma të tillë.

Bizneset dhe përfaqësuesit e konsumatorëve duhet të vazhdojnë të krijojnë programe bashkëpunuese vetërregulluese për të adresuar ankesat e konsumatorëve dhe për të ndihmuar konsumatorët në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia elektronike ndërmjet biznesit dhe konsumatorit.

Bizneset, përfaqësuesit e konsumatorëve dhe qeveria duhet të punojnë së bashku për t'u garantuar konsumatorëve mundësi dhe mekanizma të zgjidhjes alternative të konflikteve që

ofrojnë zgjidhje efektive të mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë, në kohë dhe pa kosto ose pengesa të panevojshme për konsumatorin.

Në zbatim të sa më sipër, bizneset, përfaqësuesit e konsumatorëve dhe qeveria duhet të përdorin teknologjitë e informacionit në mënyrë inovative për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorit dhe lirinë e tyre të zgjedhjes.

Përvec kësaj, kërkohet studimii i mëtejshëm për të përmbushur objektivat e seksionit VI në nivel ndërkombëtar.

VII. Privatësia (Privacy)

Tregtia elektronike e realizuar ndërmjet biznesit dhe konsumatorëve duhet të kryehet në përputhje me parimet e njohura të privatësisë të përcaktuara në udhëzimet e OECD që rregullojnë mbrojtjen e privatësisë dhe fluksin ndërkufitar të të dhënave personale (1980), dhe duke marrë parasysh deklaratën ministrore të OECD mbi “Mbrojtjen e privatësisë në rrjetet globale” (1998), për të siguruar mbrojtje të përshtatshme dhe efektive për konsumatorët.

VIII. Arsimi dhe edukimi

Qeveria, përfaqësuesit e biznesit dhe përfaqësuesit e konsumatorëve duhet të punojnë së bashku për të edukuar konsumatorët për tregtinë elektronike, për të nxitur vendim- marrjen e informuar nga ana e konsumatorëve që marrin pjesë në tregtinë elektronike, dhe për të rritur ndërgjegjësimin e biznesit dhe të konsumatorit në lidhje me kuadrin e mbrojtjes së konsumatorëve që vlen edhe për aktivitetet e tyre online.

Qeveria, biznesi, media, institucionet arsimore dhe përfaqësues të konsumatorit duhet të përdorin të gjitha mjetet efektive për të edukuar konsumatorët dhe bizneset, duke përfshirë edhe teknikat të reja të mundësuar nga rrjetet globale.

Qeveria, përfaqësuesit e konsumatorëve dhe bizneset duhet të punojnë së bashku për të siguruar informacion në një formë lehtësisht të arritshme dhe të kuptueshme për konsumatorët dhe bizneset në nivel global në lidhje me ligjet përkatëse për mbrojtjen e konsumatorit dhe mjetet juridike përkatëse.

Nga krahasimi i dispozitave të ligjit tonë me rekomandimet e OECD, rezulton se legjislacioni ynë i ka përmbushur standartet e përcaktuara nga rekomendimet në fushën e komunikimeve dhe tregtisë elektronike.¹⁴²

¹⁴²Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 517, Tiranë 2013

KAPITULLI IV: LEGJISLACIONI I BE-SË DHE PRAKTIKA GJYQËSORE PËR KONTRATËN E SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE

4.1 Direktivat e Bashkimit Europian

Pas Iniciativën Evropiane në E-commerce dhe si rezultat i konferencës Bonit dhe dëgjimit në Kopenhagë në vitin 1998, Komisioni kuptoi nevojën për një kornizë uniforme ligjore për e-nënshkrimet në nivel evropian, për të shmangur ndonjë mospërputhje në tregun e brendshëm dhe të kapur-up me veprimin ndërkombëtar që tashmë është marrë. Direktivat në nënshkrimet elektronike vendosen gurin e themelit për një mjedis të sigurt në tregun e online, si objektivat e saj kryesore janë:¹⁴³

- i. *"Lehtësimi përdorimin e nënshkrimeve elektronike dhe për të kontribuar në njohjen e tyre ligjore;*
- ii. *Harmonizimin e regjimet të Shteteve Anëtare;*
- iii. *Të forcojnë besimin në e-nënshkrimeve dhe të sigurojë një skemë fleksibël në përputhje me nismat ndërkombëtare dhe konkurrues në drejtim të e-aktiviteteve ndërkufitare.*

Direktiva siguron kornizën ligjore për nënshkrimet elektronike dhe CSPs dhe përcakton dy nivele të sigurisë që organizatat mund të aplikojnë për nënshkrimet elektronike në varësi të ndjeshmërisë së transaksionit.

- a) Në bazë të nënshkrimeve elektronike të cilat janë përdorur për nivelin minimal të transaksioneve si një metodë e legalizuara; dhe

¹⁴³Directive 1999/93 EC, OJ L013, 19.1.2000,p.0012-0020, <<http://europa.eu.int>>..

b) nënshkrimeve elektronike të avancuarta të cilat ofrojnë një nivel më të lartë të sigurisë në krahasim me ato bazike për aq kohë sa ata të plotësojnë kërkesat e çuan në nenin 2 (2) të Direktivës.

Direktivat e BE-së ndjekin shembullin e **UNCITRAL-it**, duke kërkuar nga shtetet anëtare për të zbatuar legjislacionin që nuk e mohojnë efekt ligjor të kontratave elektronike vetëm në bazë të formës së tyre. Gjuha në të dy instrumenteve është që të ekuivalencës funksionale, por gjerësi të gjerë është dhënë shteteve anëtare individuale në rregullimin e kontratave elektronike për aq kohë sa pengesa për përdorimin e tyre në përgjithësi nuk janë ngritur. Fakti që një direktivë, më tepër se një rregullore, është përdorur, është një tregues i divergjencave të parashikuara në qasjen brenda vetë Bashkimit.¹⁴⁴

4.1.1 **Direktiva e mbrojtjes së të Dhënave Personale 95/46.**

Europa ka një traditë të gjatë të prioritizimit të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale në treg, që i takon Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vitit 1953 të Këshillit të Evropës (neni 8) dhe të saj 1981 Konventa 108 mbi 'Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të Të dhënave personale ". Në nivel të BE-së, pjesa e parë e legjislacionit në këtë fushë ishte data e vitit 1995 Direktiva e Mbrojtjes (95/46) 43, e ndjekur nga Direktiva për Privatësinë dhe Komunikimet Elektronike (2002/58) dhe, së fundmi, Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (2016/679) 44, e publikuar

¹⁴⁴ELECTRONIC CONTRACTS IN THE UNITED STATES AND THE EUROPEAN UNION: Varying Approaches to the Elimination of Paper and Pen

më 4 maj, 2016, që hyn në fuqi më 24 maj 2016 dhe aplikohet zyrtarisht që nga 25 maji 2018.¹⁴⁵

Direktiva e Mbrojtjes (95/46) është një kornizë rregullatore e cila kërkon të arritur një ekuilibër në mes të një niveli të lartë të mbrojtjes për privatësinë e individëve dhe të lëvizjes së lirë të të dhënave personale në Bashkimin Evropian (BE). Për ta bërë këtë, Direktiva përcakton kufizime të rrepta në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale dhe kërkon që çdo shtet anëtar të ngritur një organ të pavarur kombëtar përgjegjës për aktivitetin mbikëqyrës lidhur me përpunimin e të dhënave personale.¹⁴⁶

Sipas kësaj direktive, përpunimi i të dhënave është i ligjshme vetëm nëse:

- subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij në mënyrë të qartë;
- përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një kontrate në të cilën subjekti i të dhënave është palë;
- përpunimi është i nevojshëm për respektimin e obligimit ligjor të cilit kontrolluesi është subjekti; ose përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave;
- përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e një detyre të kryer në interes të publikut ose në ushtrimin e autoritetit zyrtar dhënë kontrolluesit ose të një pale të tretë;

¹⁴⁵Translatic Digital and Economy and Data Protection: State of Play and Future Implications for the EU-s External Policies
[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU\(2016\)535006_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU(2016)535006_EN.pdf).
European Union, Qershor 2016.

¹⁴⁶Directive 95/ 46/ EC, <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV%3A114012> parë për herë të fundit më datë 18 tetor 2016.

- përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e interesit legjitim të ndjekur nga kontrolluesi ose nga pala e tretë, përveç aty ku interesat e tilla shkelin interesat për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave të cilat kërkojnë mbrojtje themelore.

Disa komentues kanë deklaruar se “e-commerce law” është mbrojtja e të dhënave. Përderisa ky është një mbivlerësim, rëndësia e mbrojtjes së të dhënave nuk duhet të nënvlerësohet. Mbrojtja e të dhënave është ajo fushë e ligjit që rregullon atë që mund të bëhet ligjërisht me të dhënat personale të një individi. Ligji aktual mund të gjendet në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave të vitit 1998 dhe legjislacionin përkatës dytësor.

Një rëndësi të vecantë, paraqet edhe Akti i vitit 1998, i cili u miratua për të zbatuar Direktivën 95/46 / EC, e cila kishte për qëllim harmonizimin e ligjeve për mbrojtjen e të dhënave në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Ligji hyri në fuqi më 1 mars 2000. Akti i vitit 1998, i cili zëvendësoi dhe shfuqizoi Aktin e Mbrojtjes së të Dhënave 1984, është dukshëm më i përhapur sesa paraardhësi i tij për shkak të një përkufizimi më të gjerë të "përpunimit", shtrirjes së ligjit për të mbuluar dosjet manuale (letra) dhe kufizimet e reja mbi atë që Mund të bëhet me të dhënat personale.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit është Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave. DPC ka kompetenca të gjera hetimore për të kontrolluar se të dhënat personale janë duke u përpunuar në përputhje me legjislacionin.¹⁴⁷

¹⁴⁷Peter Carey, The Internet and E-Commerce: A Haëksmere Report, (Hawksmere, London, 2001), fq.44

Për të kuptuar legjislacionin dhe efektin e tij në aktivitetet dhe përmbajtjen e faqeve të internetit, duhet të konsiderohen katër përkufizime themelore:¹⁴⁸

1. *Të dhënat personale* - Akti zbatohet vetëm për të dhënat personale, të përcaktuara si informacione nga të cilat një individ i gjallë mund të identifikohet, p.sh. Emrin, adresën, adresën e-mail, mostrën e ADN-së, imazhin e CCTV, numrin e pasaportës etj.

2. *Përpunimi* - Përkufizimi në Direktivën dhe Aktin është kompleks, por në thelb përfshin praktikisht çdo gjë që mund të bëhet me të dhënat personale, p.sh. Duke e ruajtur atë në hard drive të një kompjuteri, duke e shtypur atë në një tastierë kompjuteri, shtypur atë, duke e kaluar atë në një palë të tretë, duke e shkarkuar nga interneti, etj.

3. *Kontrolluesi i të dhënave* - ky është personi (ose kompania) i cili përcakton qëllimet për përpunimin e të dhënave personale - shumica e bizneseve në Britani të Madhe dhe sigurisht që të gjitha bizneset që kanë faqet e internetit me zonat e regjistrimit të përdoruesve janë për rrjedhojë kontrolluesit e të dhënave.

4. *Subjekti i të dhënave* - subjekti i të dhënave është personi i cili është subjekt i të dhënave personale p.sh. Në lidhje me emrin dhe adresën tuaj, subjekti i të dhënave je ti!

¹⁴⁸Peter Carey, *The Internet and E-Commerce: A Haëksmere Report*, (Hawksmere, London, 2001), fq.45

i. C-362/14, Schrems kundërKomisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave (Data Protection Commissioner), 6 Tetor 2015

U deshën rreth pesë vjet për BE dhe Shtetet e Bashkuara për të rënë dakord mbi Safe Harbour në vitin 2000 si mekanizëm sipas të cilit firmat mund të transferonin të dhënat personale nga BE-ja në Shtetet e Bashkuara në përputhshmëri me Direktivën e Mbrojtjes së të Dhënave. Problemi kryesor nga perspektiva e BE-së ishte se SHBA nuk ka një ligj në përgjithësi, e cila zbatueshëm rregullon mënyrën në të cilën firmat janë lejuar të përpunojnë të dhënat personale që ata posedojnë. Si një çështje e përgjithshme, Kushtetuta e SHBA, ligji i mëvonshëm dhe jurisprudenca Gjykata e Lartë fokusohet të kufizojnë masat në të cilën autoritetet qeveritare dhe zbatimi i ligjit mund të ndërhyj në hapësirë private. Kështu, ndërsa në disa zona (financa, shëndetësi, etj) rregullat për mbrojtjen e të dhënave janë më të rrepta thotë në SHBA se në Bashkimin Evropian, me sanksione të mundshme penale në rast të paautorizuar zbulimi apo keqpërdorimi i të dhënave personale, nuk ka kërkesë të përgjithshme që kontrolluesit e të dhënave dhe / ose përpunuesit e marrë pëlqimin e qartë personale nga individët në lidhje me përdorimin e të dhënave të tyre në sektorë që nuk kanë ligje të veçanta.¹⁴⁹

Ndërkohë, theksojmë se, vetëm Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion të deklarojë një akt të BE-së të pavlefshëm, kur është një kërkesë paraqitur pranë autoriteteve kombëtare mbikëqyrëse që ato mund, madje edhe kur Komisioni ka miratuar një vendim që konstaton se një vend i tretë siguron një nivel adekuat mbrojtjeje personaletë dhënat, të

¹⁴⁹ Translatic Digital and Economy and Data Protection: State of Play and Future Implications for the EU-s External Policies
[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU\(2016\)535006_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU(2016)535006_EN.pdf).
European Union, Qershor 2016.

shqyrtojë nëse transferimi i të dhënave të një personi në vendin e tretë përputhet me kërkesat e legjislacionit të BE-së për mbrojtjen e këtyre të dhënave dhe, në të njëjtën mënyrë siperson i interesuar, ta ngrejë çështjen para gjykatave kombëtare, në mënyrë që gjykatat kombëtares të bëjnë një referencë për një vendim paraprak me qëllim të shqyrtimit të vlefshmërisë së atij vendimi.¹⁵⁰

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian (NJBGJ) dha një vendim më 6 tetor 2015, në të cilën ubefasuan shumë që punojnë në transferimet e të dhënave të BE-SHBA.¹⁵¹ Në aktgjykimin për Mbrojtjen e të Dhënave kundër komisionerit Schrems¹⁵², i vendosur nga Dhoma e Madhe, një konfigurimi më autoritativ i Gjykatës, anuloi vendimin e Komisionit 2000/520 të korrikut 2000 që përcaktonte mbrojtjen e të dhënave të SHBA-ja në rregullat "adekuate" për të kënaqur rregullat që përfshijnë arkitekturën e mbrojtjes së të dhënave të BE-së në lidhje me transferimet e të dhënave personale nga BE-ja tek ndërmarrjet në SHBA.¹⁵³

Çështja u trajtua me z. Schrems, një përdorues austriak dhe përdorues në Facebook që sfidoi ligjshmërinë e transferimit automatik i të dhënave të tij nga Facebook në Irlandë në servera të vendosura në SHBA, duke argumentuar mungesën e nivelit adekuat i mbrojtjes së

¹⁵⁰ The Court of Justice declares that the Commission's US Safe Harbour Decision is invalid, Judgment in Case C-362/14 Maximilian Schrems v Data Protection Commissioner, Luxembourg, Tetor 2015

¹⁵¹ Case C-362/14, Schrems v. Data Protection Commissioner, 6 October 2015

¹⁵² (C-362/14)

¹⁵³ InfoCuria, 'Judgement of the Court (Grand Chamber), Case C-362/14, in re Maximilian Schrems v. Data Protection Commissioner,' 6 October, 2015. The judgement is eorth reading in its entirety, <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?docid=169195&doclang=EN>, parë për herë të fundit më datë 20 nëntor, 2016.

të dhënave në dritën e zbulesave të Snowden rreth mbikëqyrjes në shkallë të gjerë nga SHBAAgjencia e Sigurisë Kombëtare (NSA).

Vendimi GJED-ja i referohet rregullisht për leximin e të dhënave Mbrojtja Direktiva "në dritën e" Kartës Europiane të Drejtave Themelore.¹⁵⁴

GJEDNJ-ja u shpreh se legjislacioni që lejon autoritetet publike të kenë qasje në një bazë të përgjithësuar për të konteksti i komunikimeve elektronike është një lloj për të kompromituar thelbësisht thelbin etë drejtën themelore për respektimin e jetës private.¹⁵⁵ Gjykata gjithashtu sqaroi marrëdhënien e dy dispozitave të Karta e BE-së - e drejta për respektimin e privatësisë (neni 7) dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave (neni 8).

E drejta për respektimin e privatësisë është thelbësore. Është kjo e drejtë që të bëjë rregullat për mbrojtjen e të dhënave vetë mbrojtje privatësinë dhe kështu të kufizojë dhe të përjashtojë të gjitha ndërhyrjet, me përjashtim të rasteve kur ndërhyrja është rreptësisht e nevojshme.¹⁵⁶

Gjykata Europiane e Drejtësisë, gjithashtu e ka konsideruar atë për të vërtetuar ekzistencën e kësaj ndërhyrjeje.¹⁵⁷

*... nuk është relevante nëse informacioni në lidhje me jetën private të personit ka pësuar pasoja të pafavorshme për shkak të kësaj ndërhyrjeje.*¹⁵⁸

¹⁵⁴ InfoCuria, 'Judgement of the Court (Grand Chamber), Case C-362/14, in re Maximilian Schrems v. Data Protection Commissioner,' 6 October, 2015. The judgement is eorth reading in its entirety, <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?docid=169195&doclang=EN> , parë për herë të fundit më datë 20 nëntor, 2016.

¹⁵⁵ Referuara paragrafeve 94 and 95 of the judgment. Shih gjithashtu Case C-293/12 and 594/12 Digital Rights Ireland. E. Guild and S. Carrera (2014), "The Political Life of Metadata: Digital Rights Ireland and the Trail of the Data Retention Directive", CEPS Liberty and Security Series, CEPS: Brussels.

¹⁵⁶ Paragrafi 92.

¹⁵⁷ CEPS Papers in Liberty and Security in Europe, Safe Harbour or into the storm? EU-US data transfers after the Schrems judgment Sergio Carrera and Elspeth Guild No. 85 / November 2015

¹⁵⁸ Paragrafi 87. Gjykata bëri këtu referencë në gjykimin e të Drejtave të të Drejtave të Njeriut, paragrafi 33

Presidenti i sapo emëruar i GJEDNJ-së, Koen Lenaerts, deklaroi kur u pyet për aktgjykimin, që sipas tij ai qëndron në bazë të "identitetit themelor kushtetues" të BE-së.¹⁵⁹ Gjykimi Schrems, me të vërtetë dërgon një kujtesë të fortë për politikëbërësit e BE-së në lidhje me nevojën për të ancoruar në mënyrë të vendosur çdo akt legjislativ për transferimin të të dhënave mbi një kuadër mbrojtjeje në përputhje me Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore dhe BE-në arkitektura e mbrojtjes së të dhënave.¹⁶⁰

4.1.2 Direktiva Europiane, 20 Maj 1997 Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve.

Kjo direktive anksionon pikërisht teorinë e marrjes, pasi çasti i formimit të kontratës përputhet me çastin kur ofertuesi merr njoftimin e dhënies së pëlqimit. Kjo skemë e përbërë nga tri etapa (oferta, pranimi dhe njoftimi i pranimit), quhet gjithashtu dhe teoria e informacionit të ofertuesit për kontrata të lidhura midis personave që nuk janë të pranishëm në të njëjtin vend.¹⁶¹

Direktiva paraqet një kategori të veçantë të *'kontratave për përmbajtjen digjitale që nuk është epajisur në një medium të prekshëm'*, të referuara në këtë dokument si *'kontrata onlineme përmbajtjedixhitale'*. Direktiva nuk jep një përkufizim të shprehur të këtyre kontratave, por citimi 19 shpjegon se *'kontratat për përmbajtjen digjitale të cilat nuk janë*

¹⁵⁹ ECJ President on EU Integration, "Public Opinion, Safe Harbour, Antitrust", The Wall Street Journal, 14 October 2015. Shih paragrafin 60 të gjykimit.

¹⁶⁰ CEPS Papers in Liberty and Security in Europe, Safe Harbour or into the storm? EU-US data transfers after the Schrems judgment Sergio Carrera and Elspeth Guild No. 85 / November 2015

¹⁶¹ E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 67, Tiranë 2013.

*furnizuar në një medium të prekshëm duhet të klasifikohen, për qëllime të kësaj Direktive, as si kontratat e shitjes as si kontratat e shërbimit.*¹⁶²

'Përmbajtja digjitale' është përcaktuar në nenin 2 (11) si 'të dhëna që prodhohen dhe furnizohen në formë dixhitale'. Përkufizimi 19 jep shembuj: "Përmbajtja digjitale nënkupton të dhënat që prodhohen dhe ofruara në formë digjitale, të tilla si programe kompjuterike, aplikacione, lojëra, muzikë, video ose tekstet, pavarësisht nëse ato arrihen përmes shkarkimit ose transmetimit, nga një të mesme të prekshme ose nëpërmjet ndonjë mjeti tjetër."¹⁶³

Për më tepër, duke pasur parasysh dallimin e recitimit 19, *kontratat për online dixhitale përmbajtja i nënshtrohet Direktivës edhe nëse ato nuk përfshijnë pagesën e çmimit për konsumatorit.* Në të vërtetë, edhe pse Direktiva, në Nenin 2 (5) dhe (6), përcakton një *"kontratë shitje"* dhe *"kontratë shërbimi"* si kontrata sipas të cilave konsumatori paguan ose merr përsipër të paguajë një çmim, nuk ka asnjë dispozitë lidhur me kontratat për përmbajtjen digjitale në internet në Direktivën që do t'u bënte atyre një kërkesë të ngjashme që konsumatori të paguajë një çmim.¹⁶⁴

¹⁶² EUROPEAN COMMISSION, DG JUSTICE, Qershor 2014, http://ec.europa.eu/justice/consumer-marketing/files/crd_guidance_en.pdf

¹⁶³ EUROPEAN COMMISSION, DG JUSTICE, Qershor 2014, http://ec.europa.eu/justice/consumer-marketing/files/crd_guidance_en.pdf

¹⁶⁴ EUROPEAN COMMISSION, DG JUSTICE, Qershor 2014 http://ec.europa.eu/justice/consumer-marketing/files/crd_guidance_en.pdf

4.1.2 Direktiva 97/7/CEE “Për kontratat në largësi”, datë 20/05/1997

Nga vetë natyra e tyre, aktivitetet tregtare të kryera në internet kryhen në distancë; dmth shitësi dhe blerësi nuk janë në të njëjtën vendndodhje fizike.¹⁶⁵ Nga një perspektivë e politikës publike, qeveritë janë të shqetësuar se në një mjedis të tillë konsumatorët janë më të prekshëm dhe për këtë arsye kanë nevojë për mbrojtjen e ligjit.

Direktiva 97/7 / EC¹⁶⁶, "*Direktiva e shitjes në distancë*", është një reagim i drejtpërdrejtë ndaj shqetësimeve të tilla dhe prandaj është një komponent kritik i kuadrit rregullator në zhvillim për tregtinë elektronike në Evropë.

Objekti i kësaj Direktive¹⁶⁷ është përafrimi i ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me kontratat në distancë ndërmjet konsumatorëve dhe furnitorëve.

Për qëllimet e kësaj direktive, nënenin 2, pika 1, përcaktohet se: "*Kontratë me distancë*" nënkupton çdo kontratë në lidhje me mallrat ose shërbimet e lidhura ndërmjet një furnizuesi dhe një konsumatori nën një skemë të organizuar të shitjes në distancë ose skemë shërbimesh të drejtuar nga furnizuesi, i cili për qëllime të kontratës bën përdorimin ekskluziv të një ose më shumë mjete të komunikimit në distancë deri në momentin e lidhjes së kontratës;

¹⁶⁵ Julia Hornle, Gavin Sutter, Ian Walden IT Law Unit, Centre for Commercial Law Studies

¹⁶⁶ Directive 97/7/EC of the European Parliament and the Council of 20 May 1997 on the protection of consumers in relation to distance contracts; OJ L 144/19, 4.6.1997.

¹⁶⁷ Directive 97/7/EC of the European Parliament and of the Council of 20 May 1997 on the protection of consumers in respect of distance contracts, neni 2.

Ndërsa në pikën 4, të nenit 2, "mjet i komunikimit në distancë" nënkupton çdo mjet që pa prezencën e njëkohshme fizike të furnizuesit dhe konsumatorit mund të përdoret për lidhjen e një kontrate midis këtyre palëve.

Në vijimësi, vlen të theksojmë se, në kohën e duhur para përfundimit të kontratës së distancës, konsumatorit i jepet informacioni paraprak i mëposhtëm:¹⁶⁸

(a) identitetin e furnizuesit dhe, në rastin e kontratave që kërkojnë pagesa paraprake, adresën e tij;

(b) karakteristikat kryesore të mallrave ose shërbimeve;

(c) çmimin e mallrave ose shërbimeve duke përfshirë të gjitha taksat;

(d) shpenzimet e dorëzimit, sipas nevojës;

(e) aranzhimet për pagesën, dorëzimin ose përmbushjen;

(f) ekzistenca e të drejtës së tërheqjes, përveç rasteve të referuara në nenin 6 (3);

(g) kostoja e përdorimit të mjeteve të komunikimit në distancë, ku llogaritet ndryshe nga norma bazë;

(h) periudhën për të cilën oferta ose çmimi mbetet i vlefshëm;

(i) kur është e përshtatshme, kohëzgjatja minimale e kontratës në rastin e kontratave për furnizimin e produkteve ose shërbimeve që kryhen në mënyrë të përhershme ose periodike.

¹⁶⁸ Directive 97/7/EC of the European Parliament and of the Council of 20 May 1997 on the protection of consumers in respect of distance contracts, neni 4.

4.1.4 Direktiva Europiane 8 qershor 2000, Mbi Tregtinë Elektronike

Ndërkohë, Bashkimi Europian ka implementuar ligjin Model me anë të dy direktivave; Direktiva mbi Nnëshkrimin Elektronik dhe Direktiva mbi Tregtinë Elektronike. Duke iu referuar Direktivës mbi Tregtinë Elektronike, konstatojmë se në kapitullin 2, seksioni 3, rregullon kontratën elektronike. Ajo ka të njëjtat rregullime si ligji model ose UETA, por shkon më tej duke rregulluar edhe disa aspekte të krijimit të kontratës elektronike. Në nenin 10 direktiva prashikon informacionin bazë që duhet të përfshihet në kontratat elektronike bussines to consumer. Ky është një parashikim që nuk synon të rregullojë përmbajtjen e kontratës por të mbrojë interesat e konsumatorit. Më pas neni 11 parashikon momentin kur një kontratë elektronike quhet e përfunduar dhe fillon të prodhojë pasoja juridike.¹⁶⁹

Kjo Direktivë parashikon kufizimin maksimal të gabimeve të tilla duke kërkuar nga shtetet anëtare që të parashikojnë në legjislacionet e tyre që furnizuesi të vërë në dispozicion të marrësit “mjete teknike të përshtatshme, të efektshme dhe aksesibël, që i mundësojnë të identifikojë gabimet e bëra gjatë futjes së të dhënave dhe ti korrigjojë ato dhe kjo të realizohet para së të bëhet porosia”.¹⁷⁰

Direktiva mbi tregtinë elektronike trajton një sërë aspektesh juridike të tregtisë elektronike në tregun e brendshëm.¹⁷¹ Kjo direktivë i referohet disa aktiviteteve dhe disa sektorëve on-line si: gazetat, shërbimet financiare, shërbimet profesionale, tregtisë, publicitetit dhe shërbimet e aksesit në internet. Ajo i drejtohet vetëm ofruesve të shërbimeve që kanë seline e tyre brenda Bashkimit Europian, por mundohet që të shmangë konfliktet që mund të

¹⁶⁹ Cabej, L. Kontratat elektronike, një risi në marrëdhëniet kontraktore.

¹⁷⁰ E drejta e internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 67, Tiranë 2013.

¹⁷¹ Direktiva “Për tregtinë elektronike”, nr. 2000 / 31 CE e Parlamentit Europian, datë 8.06.2000.

lindin me zhvillimet juridike në vendet e tjera të botës. Direktiva i kërkon shteteve të heqin cdo pengesë në përdorimin e kontratave on-line, një mjet efikas për zhvillimin e tregtisë në nivel evropian. Gjithashtu Direktiva kërkon bashkëpunim me vendët e treta sidomos vendet kandidate për Bashkimin Evropian, në kuadër të globalizimit të tregjeve.¹⁷² Kjo është edhe arsyeja që vendi ynë ka përafuar legjilacionin me anëtarëve të nxjerra në përputhje me Direktivat¹⁷³ në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Acquis Communautaire.

4.1.5 Direktiva 2002/ 58- KE- për “e- Privatësinë”

Direktiva 2002/58 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit i 12 korrikut 2002 në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva për privatësinë dhe komunikimet elektronike), ka si qëllim për funksionimin e saj ligjor në raport me shtetet anëtare, si më poshtë:¹⁷⁴

Së pari, kjo Direktivë harmonizon dispozitat e Shteteve Anëtare të kërkuara për të siguruar një nivel të barabartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, dhe në veçanti të drejtën e privatësisë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe të pajisjeve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik në Komunitet.

¹⁷² Kontratat elektronike, një risi në marrëdhëniet kontraktore, Lorena Cabej.

¹⁷³ Direktiva “Për tregtinë elektronike”, Direktiva “Për dokumentin elektronik”, Direktiva “Për tregtinë në distancë” .etj.

¹⁷⁴ Directive 2002/58/EC of the European Parliament and of the Council of 12 July 2002 concerning the processing of personal data and the protection of privacy in the electronic communications sector (Directive on privacy and electronic communications)

Së dyti, dispozitat e kësaj Direktive përcaktojnë dhe plotësojnë Direktivën 95/46 / EC për qëllimet e përmendura në paragrafin 1. Për më tepër, ato parashikojnë mbrojtjen e interesave legjitime të abonentëve që janë persona juridikë.

Së treti, kjo Direktivë nuk zbatohet për veprimtaritë që janë jashtë fushëveprimit të Traktatit që themelon Komunitetin Europian, siç janë ato që mbulohen nga Titujt V dhe VI të Traktatit për Bashkimin Evropian dhe në çdo rast në aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurinë publike, mbrojtjen, Siguria e shtetit (duke përfshirë mirëqenien ekonomike të shtetit kur aktivitetet lidhen me çështjet e sigurisë së shtetit) dhe aktivitetet e shtetit në fushat e së drejtës penale

Sipas kësaj Direktive, Shtetet Anëtare sigurojnë konfidencialitetin e komunikimeve dhe të dhënave përkatëse të trafikut nëpërmjet një rrjeti të komunikimit publik dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, nëpërmjet legjislacionit kombëtar. Në veçanti, ata do të ndalojnë dëgjimin, përgjimin, ruajtjen ose lloje të tjera të përgjimit ose mbikëqyrjes së komunikimeve dhe të dhënave të trafikut përkatës nga persona të tjerë përveç përdoruesve, pa pëlqimin e përdoruesve të interesuar, përveç kur është e autorizuar ligjërisht ta bëjë këtë në përputhje me nenin 15 (1). Ky paragraf nuk do të pengojë ruajtjen teknike që është e nevojshme për transmetimin e një komunikimi pa paragjykuar parimin e konfidencialitetit.¹⁷⁵

4.1.6 Direktiva 2006/ 24- KE- “Mbi Ruajtjen e të Dhënave”

Direktiva e Ruajtjes së të Dhënave përbënte një përgjigje të BE-së ndaj sfidave urgjente të sigurisë, pas sulmeve të mëdha terroriste në Madrid në vitin 2004 dhe në Londër në 2005.

¹⁷⁵Directive 2002/58/EC of the European Parliament and of the Council of 12 July 2002 concerning the processing of personal data and the protection of privacy in the electronic communications sector (Directive on privacy and electronic communications)

Përkundër qëllimit legjitim për krijimin e një skeme mbajtjeje të të dhënave, u shpreh kritika lidhur me ndikimin e madh masa kishte në intimitetin e qytetarëve.

Detyrimi për mbajtjen e të dhënave në pajtim me Direktivën e Ruajtjes së të Dhënave i lejon autoriteteve kompetente kombëtare të rishikojnë sjelljen telefonike dhe të internetit të të gjithë personave në BE sa herë që përdorin telefon ose internet deri në një periudhë prej dy vjetësh.

Sipas kësaj Direktive, parashikohet se, mbajtja e të dhënave të telekomunikacionit në mënyrë të qartë përbën një ndërhyrje në të drejtën e privatësisë së personave të interesuar siç parashihet me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 7 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore.

Rëndësia e raportit të vlerësimit dhe procesi i vlerësimit nuk mund të ekzagjerohet.¹⁷⁶ Direktiva e Ruajtjes së të Dhënave përbën një shembull të shquar të një mase të BE-së që synon të sigurojë disponueshmërinë e të dhënave të krijuara dhe të përpunuara në kontekstin e komunikimeve elektronike për aktivitetet e zbatimit të ligjit. Tani që masa ka qenë e vendosur për disa vite, një vlerësim i zbatimit të tij praktik duhet të vërtetojë domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masës në dritën e të drejtave të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave.¹⁷⁷

¹⁷⁶ In his Opinion of 2005, the EDPS already emphasised the importance of the obligation to evaluate the instrument (see footnote 9, points 72-73)

¹⁷⁷ Shih the EDPS Opinion of 26 September 2005, [OJ C 298, 29.11.2005, p. 1](#). During a conference organised by the Commission in December 2010, the EDPS referred to the instrument as ‘the most privacy invasive instrument ever adopted by the EU in terms of scale and the number of people it affects’, see speech of 3 December 2010, to be found on the EDPS website (<http://www.edps.europa.eu>) under ‘Publications’ >> ‘Speeches & Articles’ >> ‘2010’.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se 'ruajtja e thjeshtë e të dhënave në lidhje me jetën private të një individi përbën një ndërhyrje brenda kuptimit të nenit 8 [KEDNJ]'.

i. Vendim Gjyqësor i Gjykatës së Lartë Italiane, datë 6 shtator 2001 (C-11445/2001)

Në një vendim të datës 6 shtator 2001, Gjykata e Lartë Italiane ka sqaruar një problem i mundimshëm në lidhje me pranimin e dokumenteve elektronike si provë. Çështja kishte krijuar shqetësim të madh midis praktikuesve, edhe në fushën e tregtisë ndërkombëtare, për sa kohë që rregullorja italiane në këtë çështje kishte dhënë dy efekte të ndara të 'dokumentit informatik' si dëshmi.¹⁷⁸

Së pari, një nënshkrim dixhital, ai u barazua me një dokument të shkruar me dorë, në përputhje me kërkesat e formës së shkruar;

Së dyti, iu dha efekti i një "riprodhimi mekanik" sa herë që përputhet me 'kërkesat e kësaj rregulloreje'.

Pothuajse ekskluzivisht me nënshkrimin dixhital dhe certifikimin, shumë akademikë kishin arritur në përfundimin se një nënshkrim dixhital kërkohej domosdoshmërisht për prodhimin e çfarëdo efekti të një dokumenti elektronik, qoftë se një deklaratë "origjinale" e shkruar me dorë ose riprodhimi i një fakti . Pas vendimit, është e qartë se provat e ofruara përmes çdo përfaqësimi të akteve, fakteve apo gjërave të krijuara ose të ruajtura në mënyrë

¹⁷⁸https://www2.warwick.ac.uk/fac/soc/law/elj/jilt/2002_2/scannicchio/

elektronike, kanë të njëjtën vlerë të njohur deri më tani nga gjykatat në telefaks, fotokopje dhe të ngjashme, edhe nëse ajo nuk mbajnë asnjë nënshkrim; qoftë digital apo elektronik. Ky përfundim është konfirmuar nga legjislacioni i fundit i shkurt 2002.¹⁷⁹

Përveç kësaj, pyetjet rreth vlefshmërisë dhe efekteve të vetë kontratës (dhe jo si dëshmi) ende duhet të dorëzohen në vëmendjen e Gjykatës dhe prandaj ende duhet të trajtohen nga rregulloret e mëparshme, që kërkon përdorimin e një sistemi dixhital nënshkrimi për një kontratë elektronike (dmth. çdo lloj marrëveshjeje e lidhur me përdorimin e mjeteve elektronike) të jetë ligjrisht e detyrueshme dhe e zbatueshme¹⁸⁰

Sipas ligjit italian të tregtisë elektronike çështja provave dhe vlefshmërisë dhe efekti i një 'kontratë elektronik 'janë të ndërlidhura në mënyrë rigoroze, sa më shumë që të dyja varen nga ekuivalenca midis elektronike dhe formë' shkruar '.¹⁸¹

Përsa i përket rastit konkret, theksojmë se, paditësi, një punonjës i kompanisë italiane *Autostrade SpA* i cili ishte shkarkuar për shkak të anashkalimit të sistemit elektronik të shpërndarjes dhe rimbursimit të biletave - kishte kundërshtuar aktgjykimin e Apelit për shkak të mungesës së vlerës së provës të të dhënave elektronike të ofruara nga struktura qendrore e të pandehurit. Sipas paditësit, të dhënat elektronike, të cilat kishin vërtetuar se biletat e para magnetizuara të lëshuara nga paditësi, nuk ishin kontabilizuar (biletat ishin vjedhur) nga elektronike deri sa nuk ishin në përputhje me kërkesat e Aktit Italian për

¹⁷⁹https://www2.warwick.ac.uk/fac/soc/law/elj/jilt/2002_2/scannicchio/

¹⁸⁰https://www2.warwick.ac.uk/fac/soc/law/elj/jilt/2002_2/scannicchio/

¹⁸¹See G. Toraldo, (2002) C.T.L.R. 4, N 65 for a comment in English. Recent Italian legislation of February 2002 (see beloë), the decisive distinction between 'digital' and 'electronic' signature and the relationship ? peculiar to the Italian legal system ? between evidence and form as a substantial element of contract's validity ? are not taken into account in that first comment.

njohjen e vlerës së provës me 'dokumentet informatike' (në tekstin e mëtejshëm: dokumentet elektronike).¹⁸²

¹⁸²https://www2.warwick.ac.uk/fac/soc/law/elj/jilt/2002_2/scannicchio/

KAPITULLI V: KONTRATA E SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE SIPAS LEGJILSACIONIT SHQIPTAR

5.1 Kuadri ligjor vendas në lidhje me kontratën e shitjes në formë elektronike

Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK) luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri dhe inovacion. Kjo teknologji mundëson sigurimin e një cilësie më të lartë të jetës për qytetarët, ndihmon në lehtësimin dhe efikasitetin e proceseve të biznesit, si dhe në rritjen e efektivitetit dhe transformimin e qeverisjes.¹⁸³

Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional gjatë periudhës **2008-2013**, u hartuan dhe miratuan një sërë ligjesh në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Përpjekjet e institucioneve shqiptare në këtë periudhë u fokusuan në zhvillimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional në mënyrë që të sigurohej mjedisi efikas për komunikimin me biznesin, ndërtimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturave të përparuara të komunikimit elektronik për nevojat e administratës publike dhe qeverisjes elektronike, rregullimet ligjore për menaxhim të spektrit mbi bazën e parimit të neutralitetit teknologjik për të promovuar zhvillimin e infrastrukturës *broadband*, zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve elektronike për bizneset dhe individët në kuadër të qeverisjes elektronike.¹⁸⁴

Legjilacioni aktual shqiptar është përpjekur maksimalisht që të kapë vonesën e shkaktuar nga faktorët e shumtë ekonomikë dhe politikë që patën pasojat e tyre edhe në mjedisin dixhital. Kështu, ligjvënësit shqiptarë janë përpjekur, në kuadër të Marrëveshjes së

¹⁸³ Vendimi Nr. 284, datë 1.04.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale”, “Axxhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015- 2020”.

¹⁸⁴Vendimi Nr. 284, datë 1.04.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale”, “Axxhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015- 2020”.

Stabilizim Asocimit që t'i përafrojnë ligjet tona sa më shumë me direktivat europiane në këtë fushë. Aktualizimi i legjislacionit në këtë fushë është shumë i rëndësishëm, pasi vëne re se zbatimet konkrete të tregtisë elektronike janë të shumëllojta dhe po prekin dukshëm edhe tregun shqiptar. Për shembull, përdorimi i internetit shërben jo vetëm për shitjet me pakicë, por edhe për shitjet me shumicë, në rastet kur palët janë të dyja profesioniste. Gjithashtu, një nga mënyrat e ndjekura nga prodhuesit për përhapjen e produkteve të tyre është edhe zhvendosja e operacioneve të furnizimit në internet. Midis tyre ata kryejnë shkëmbime elektronike që kanë si qëllim këmbimin e informacioneve dhe kryerjen e transaksioneve në mënyrë të shpejtë.¹⁸⁵

Për të qenë koherent me zhvillimet teknologjike dhe për tu përshatur nevojave të reja, së fundmi mjedisi ynë ligjor është pasuruar me një sërë ligjesh që përbëjnë kuadrin ligjor për realizimin e tregtisë elektronike. Parimet dhe rregullat e së drejtës kontraktore tradicionale, rezultuan jo shumë të përditësuara dhe nuk mundësonin ligjen e kontratave elektronike. Rrjedhimisht, lindi nevoja për plotësim të kuadrit ligjor në këtë aspekt.¹⁸⁶

Në kuadër të tregtisë elektronike theksojmë se, në përputhje me angazhimet e MSA-së janë miratuar dhe hartuar një sërë ligjesh të rëndësishme si:¹⁸⁷

¹⁸⁵ Bashkim Ruseti, Kozata Sevrani, "Sistemet e informacionit të mënaxhimit", ISBN 99943-1-X (E drejta e internetit/ Oltion Spiro)

¹⁸⁶ E. Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, "Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri", faqe 477, Tiranë 2013

¹⁸⁷ Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 në përputhje me zhvillimet më të fundit të *acquis* të BE-së; VKM nr. 248, date 27.04.2007, "Për krijimin e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit", I ndryshuar nga:

-VKM nr. 837, datë 29.07.2009;

- VKM nr. 28, datë 20.01.2010;

* Ligji "Për dokumentet elektronike", nr. 10 273, datë 29.04.2010.

Legjislacioni shqiptar në fuqi për komunikimet elektronike, shoqërinë e informacionit dhe median synon:

*eliminimin e pengesave për funksionim të efektshëm të tregut të brendshëm në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;

* Ligji “Për komunikimet elektronike“, nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar nga ligji 102/ 2012, datë 24.10.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike“.

* Ligji për “Për nënshkrimin elektronik”, nr. 9880, datë 25.02.2008, i ndryshuar nga ligji nr. 10178, datë 29.10.2009 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 30.09.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”.

- i. Vendimi I Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 13.05.2009 “Për miratimin e rregullores për nënshkrimin elektronik”.
- ii. Vendimi I Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për shërbimet që ofrohen nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik”.
- iii. Vendim I Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 05.05.2010 “Për miratimin e dokumentit të politikavë mbi komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.
- iv. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 24.2.2013: “Për miratimin e rregullores për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë”;

Udhëzues nr. 1, “Mbi ligjin për nënshkrimin elektronik”, I Autoriteti Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

Udhëzues nr. 2, “Mbi përdorimin e nënshkrimit elektronik” I Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

Udhëzues nr. 3, “Mbi shërbimin e certifikimit elektronik”, I Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

Udhëzim nr. 4, “Për afatet e përgjithshme”, I Autoritet Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

Udhëzim nr. 5, “Për dokumentacionin e regjistrimit të OSHC” I Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

Udhëzim nr. 6, “Për dokumentacionin e regjistrimit të OSHC”, I Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

Udhëzim nr. 7, “Për deklaratën e përfaqësuesit ligjor”, I Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

Udhëzim nr. 8, “Për deklaratën e personit fizik” I Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik;

*Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”

- i) Vendim I Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 21.1.2009, ‘Për kontratat në largësi”.

*promovimin e konkurrencës në tregun e brend-shëm;

*mbrojtjen e konsumatorit etj.

Për të qenë koherent me zhvillimet teknologjike dhe për t'iu përshtatur nevojave të reja, Shqipëria, ka plotësuar mangësitë ligjore që ndihmojnë në realizimin e tregtisë elektronike në tërësi.

Nëse i referohemi kuadrit rregullues në planin European, do të përmendim:¹⁸⁸

Së pari: Direktivën e Bashkimit European lidhur me Tregtinë Elektronike, (Direktiva 2000/31/EC)

Së dyti: Direktivën mbi Nënshkrimin Elektronik (Direktiva 1999/93/ EC)

Së treti: Direktivën për Shitjen në Distancë (97/7/ EC).

Të gjitha këto direktiva janë transpozuar në legjislacionin tonë duke miratuar ligjet respektive apo edhe vendime të Këshillit të Ministrave (VKM 'Për Kontratat në Largësi'). Legjislacioni ynë është miratuar nën dritën e këtyre direktivave duke arritur një nivel të lartë përafrimi. Në nivel ndërkombëtar, në lidhje me tregtinë elektronike, ekziston ligji model UNICTRAL i 1996, rekomandimet e OECD lidhur me udhëzimet për mbrojtjen e konsumatorëve në kontekstin e tregtisë elektronike dhe Konventa mbi përdorimin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare. Megjithatë, ligji model i UNCITRAL është pak i njohur për legjislacionin tonë dhe ligji për 'Tregtinë Elektronike', nuk bën asnjë referencë direkte në këtë ligj, pasi kyi fundit është influencuar maksimalisht nga Direktiva 2000/31/ EC për tregtinë elektronike.¹⁸⁹

¹⁸⁸Ë Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, "Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri", faqe 478, Tiranë 2013

¹⁸⁹Malltezi A/, J. Rystemaj, L. Pelinku, "Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri", faqe 478-479, Tiranë 2013

Vëndi ynë, ka plotësuar mangësitë ligjore që ekzistonin për realizimin e tregtisë elektronike duke miratuar ligjet e përmendura më sipër. Miratimi i kuadrit ligjor përkatës ka qenë edhe rezultat i angazhimit të marrë përsipër nga vendi ynë në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA). Për këtë arsye edhe ligji “Për tregtinë elektronike” është afruar në përputhje me Direktivën e BE-së 2000/ 31/ EC. Në mënyrë të vecantë rregullimi ligjor i tregtisë elektronike, edhe në vendet e tjera, ka synuar mbrojtjen e konsumatorëve nga dëmtimet që mund t’i sillte një treg i parregulluar. Në këtë kontekst janë të nevojshme rregulla për të garantuar sigurinë juridike dhe besimin e konsumatorit.¹⁹⁰

5.1.1 Cilat janë kushtet e përgjithshme që duhet të përmbushë kontrata e shitjes në formë elektronike sipas Kodit Civil Shqiptar?

Neni 686, dhe nenet në vijim (687, 688 dhe 689) të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përcaktojnë se, kushtet e përgjithshme të kontratës, të përgatitura prej njëres palë kontraktuese, kanë efekt ndaj palës tjetër, në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës kjo e fundit i ka njohur ose duhej t’i kishte njohur, duke treguar një përkujdesje të zakonshme. Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale. Nuk krijojnë efekte juridike ato kushte të cilat vendosin në dobi të atij që i ka përgatitur ato më përpara, kufizime për përgjegjësinë, mundësinë për t’u tërhequr nga kontrata, për të pezulluar zbatimin e saj, ose që caktojnë ndaj palës tjetër afate dekadence, ose kufizime ndaj së drejtës për të bërë prapësime, ndaj

¹⁹⁰Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 486, Tiranë 2013

lirisë kontraktore, në marrëdhënie me të tretët, kushteve të arbitrazhit ose shmangies nga kompetencat e organeve gjyqësore, përveç kur janë miratuar veçmas me shkrim nga pala tjetër.¹⁹¹

5.2 Kontrata e shitjes në formë elektronike sipas ligjit “Për tregtinë elektronike”.

Për të shkurtuar distancat ndërmjet palëve që hyjnë në marrëdhënie kontraktuale, për të nxitur dhe për të shpejtuar kohën e realizimit të kontratave ndërmjet subjekteve që veprojnë në vende të ndryshme, ose edhe në të njëjtin vënd por që përdorin mjetet e komunikimit elektronik, ligji, duke u përshtatur me zhvillimet e shoqërisë së informacionit, prezanton njëmënyrë të re dhe krejt moderne për lidhjen e kontratës elektronike. Sipas ligjit kontrata e elektronike e shitjes është kontrata e lidhur duke përdorur mjetet elektronike.¹⁹²

Kontrata elektronike e shitjes është një marrëveshje e arritur dhe e nënshkruar në rrugë elektronike, pra nuk kemi versionin e kontratës “hard copy”, në letër. Kontrata është një veprim juridik me anë të të cilit palët krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.¹⁹³ I njëjti përkufizim vlen edhe për kontratën e shitjes në formë elektronike (online), por ndryshimi konsiston në faktin se kontratat e elektronike (online) të shitjes krijohen, transmetohen ose ruhen në rrugë elektronike. Kontrata e shitjes në formë

¹⁹¹ Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë

¹⁹² Agita Mallezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri, faqe 495, Tiranë 2013.

¹⁹³ Neni 659 I Kodit Civil

elektronike, sipas legjislacionit tonë rregullohet, nga ligji “Për tregtinë elektronike”, ligji “Për dokumentin elektronik”, si dhe ligji “Për nënshkrimin elektronik”.¹⁹⁴

Sipas ligjit nr. 10 128 datë 11.05.2019 “Për tregtinë elektronike”, neni 1, pika 1 përcakton shprehimisht se, kontratat e lidhura përmes mjeteve elektronike quhen kontrata në formë elektronike. Në vazhdim të kësaj dispozite ligjore përcaktohet se propozimi dhe pranimi I ofertës mund të bëhen nëpërmjet mjeteve elektronike, e cila është forma elektronike e tyre. "Nëpërmjet mjeteve elektronike" nënkuptohet se shërbimi dërgohet nga pika e origjinës dhe merret në destinacionin përfundimtar, me anë të pajisjeve elektronike, për përpunimin (përfshirë edhe kompresimin numerik) dhe ruajtjen e të dhënave.¹⁹⁵

Në çdo rast, që kontrata elektronike të jetë e vlefshme, duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara nga Kodi Civil, për pjesën e përgjithshme të kontratave, kërkesat e parashikuara për formën konkrete të kontratës, të parashikuar nga Kodi Civil dhe kërkesat e veçanta, të parashikuara në Ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Ligji “Për Tregtinë Elektronike” është miratuar pikërisht për këtë qëllim, që të vendosë rregulla për kryerjen e verpimeve tregtare në rrugë elektronike, nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga shoqëria e informacionit, për mbrojtjen e personave pjesmarrës, mbrojtjen ligjore dhe konfidencialitetit të konsumatorëve apo të të dhënave konfidenciale të pjesmarrësve në të, si dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të shërbimeve të informacionit, duke përcaktuar

¹⁹⁴ Lorena Cabej, Kontratat elektronike, një risi në marrëdhëniet kontraktore,

https://issuu.com/enicabej/docs/kontratat_elektronike.docx parë për herë të fundit, më datë 22.09.2016

¹⁹⁵ Ligji nr. 10 128, datë 11.05.2009, “Për Tregtinë Elektronike”, *Perafruar me Direktiven 2000/31/EC, “on Some legal aspects of Information Society services, especially on electronic commerce in domestic market (Directives on Electronic Commerce)”, me CELEX 32000L0031*

përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit.¹⁹⁶ Pra parë në këtë këndvështrim, ligji për tregtinë elektronike, synon në mbrojtjen ligjore të konfidencialitetit të konsumatorëve apo të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve në të.

Vlen të theksohet fakti se, publikimi i informacionit të detajuar të kërkuar nga një numër dispozitash të Ligjit për Tregtinë Elektronike, është shfaqje e një garancie për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve pasi në këtë mënyrë ata njohin se cila është pala me të cilën ata do ta realizojnë kontratën. Ky informacion është i përgjithshëm dhe i referohet emrit tregtar të ofruesit të shërbimit, adresës, të dhënave të regjistruara në regjistrin tregtar etj, si dhe duhet të paraqitet në mënyrë të qartë e të saktë që të jetë lehtësisht i kuptueshëm nga ana e konsumatorit. Përveç këtij informacioni, konsumtaroi, mbi të gjitha është i interesuar për një element thelbësor sic është cmimi. Në këtë aspekt, ligji përcakton se cmimi duhet të jetë përfundimtar dhe se në atë të jenë përfshirë tatimi e kostot e transportit apo të dërgimit të tij deri në destinacionin përfundimtar, të përfituesit apo të marrësit.¹⁹⁷ Ky parashikim, vjen në një linjë me përkufizimin që ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit, i jep cmimit dhe se çfarë duhet të përfaqësojë ai.¹⁹⁸

Ligji “Për tregtinë elektronike”, përveç të drejtave të njohura më sipër e plotëson kuadrin e mbrojtjes së konsumatorit duke referuar në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorit: Konsumatori, qoftë ai i tregut real qoftë konsumatori elektronik është i mbrojtur nga:¹⁹⁹

¹⁹⁶ Neni 1 I Ligjit, nr. 10128, datë 11.05.2009, “Për tregtinë elektronike”, i ndryshuar.

¹⁹⁷ Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 508, Tiranë 2013

¹⁹⁸ Neni 3/ 2 I ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, e përkufizon cmimin e mallit si: “Cmimi I shitjes së mallit”, është cmimi përfundimtar për një njësi të mallit ose për sasinë e dhënë të tij, përfshirë TVSH-në dhe të gjitha taksat e tjera”.

¹⁹⁹ Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 508, Tiranë 2013

a. E drejta e mbrojtjes së shëndetit, medisit dhe sigurisë së jetës;

b. E drejta e mbrojtjes së interesave ekonomikë;

c. E drejta e ankimit;

ç. E drejta për dëmshpërblim;

d. E drejta e edukimit;

dh. E drejta e marrjes së informacionit;

e. E drejta e përdorimit të shërbimeve publike;

ë. E drejta e mbrojtjes ligjore

f. E drejta e organizimit në shoqata ose bashkime për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe e drejta e përfaqësimit në organet e tyre vendimmarrëse.²⁰⁰

Pavarësisht gjithë këtyre garancive, sërish konsumatorët elektronikë mbeten disi skeptikë përsa i përket tregut virtual. Shqetësimet mbi privatësinë dhe sigurinë në internet dekurajojnë disa konsumatorë.²⁰¹

Për të garantuar edhe këtë aspekt të tregtisë elektronike, ligji “Për tregtinë elektronike”, siguron konsumatorët se, ngarkohet me përgjegjësi ofruesi i shërbimit për transmetimin e dhënave elektronike nëse ofruesi (i produktit/ mallit) ndërhyt nëpërmjet përdorimit të ligjshëm të teknologjisë së njohur dhe të përdorur gjerësisht nga industria e komunikimeve

²⁰⁰ Neni 4 I ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”.

²⁰¹ Alan T. Saracevic, The full All- Important Last Mile to Your Front Door; Delivery Companies Strive to Improve Fulfillment Services, SAN FRANCISCO EXAMINER, March 7, 2007.

elektronike, për marrjen e të dhënave mbi përdorimin e informacionit. Në këtë mënyrë ligji ndalon marrjen dhe përdorimin e të dhënave që mund të ruhen gjatë shkëmimit të të dhënave.²⁰²

5.2.1 Subjektet e kontratës së shitjes në formë elektronike

Bazuar në fushën e internetit, theksomë se, kontratat të cilat do të nënshkruhen midis **tregtarëve**(shitësi) dhe **konsumatorëve**(blerësi), përkufizohen si *kontrata në largësi*. Sipas fushës së zbatimit të nenit 36 të ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit”²⁰³, përcaktohet se, kontrata në largësi është çdo kontratë për mallin apo shërbimin, e lidhur ndërmjet tregtarit dhe konsumatorit, sipas një skeme organizimi shitjeje në largësi ose ofrim shërbimi nga tregtari, i cili, për qëllimet e kontratës, përdor ekskluzivisht një ose më shumë mjete të komunikimit në distancë, deri në çastin e lidhjes së kontratës dhe përfshirë këtë çast.

i. Tregtari ose ofruesi i shërbimit(shitësi)

Sipas ligjit për tregtinë elektronike, ofruesi i shërbimit, është çdo person fizik ose juridik, që ofron një shërbim të shoqërisë së informacionit.

ii. Konsumatori (Blerësi)

Sipas ligjit për tregtinë elektronike, konsumator, është çdo person fizik, i cili blen ose përdor mallra a shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime, të cilat nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin ose ushtrimin e profesionit.

5.2.2 Objekti i kontratës së shitjes në formë elektronike

²⁰²Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 509, Tiranë 2013

²⁰³ Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

Referuar ligjit për tregtinë elektronike, objekt i kontratës së shitjes në formë elektronike, janë **produktet** ose **shërbimet** të ofruar nga *shoqëria e informacionit*, për kryerjen e veprimeve tregtare në rrugë elektronike, për mbrojtjen e personave pjesëmarrës, mbrojtjen ligjore të konfidencialitetit të konsumatorëve apo e të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve në të, si dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të shërbimeve të informacionit, duke përcaktuar përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit. Termi, “*shërbimet e shoqërisë së informacionit*”²⁰⁴, i referohet shërbimeve, që ofrohen përkundrejt pagesës, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit. Pra, shërbimet e shoqërisë së informacionit konsistojnë pikërisht në shitjen online (në rrugë elektronike), të mallrave. Nga përkufizimi i mësipërm, rezulton se, një shërbim që të konsiderohet shërbim i shoqërisë së informacionit duhet të përmbushë disa kritere.²⁰⁵

Së pari, kërkohet që shërbimet të ofrohen kundrejt pagesës. Megjithatë nuk është në cdo rast e nevojshme që shërbimi të paguhet direkt nga marrësi, pasi mund të përdoren edhe mënyra të tjera indirekte për pagesën. Kostot e shërbimit mund të mbulojnë nga reklamat. Për shembull, shoqëritë që ofrojnë internet falas, rregullohen nga ky ligj.²⁰⁶

Së dyti, këto shërbime duhet të ofrohen në distancë. Ofrimi shërbimit në distancë nënkupton që palët e përfshira në transaksion, nuk duhet të jenë të pranishëm në kohën e realizimit të veprimit. Arsyeja e përfshirjes së një kriteri të tillë është se palët në distancë

²⁰⁴ Ligji Nr. 10 128, datë 11.05.2009, “Për tregtinë elektronike”, i ndryshuar

²⁰⁵ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri, faqe 488, Tiranë 2013

²⁰⁶ Directive 2000/31/EC on certain aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market, Arno R. Lodder, faqe 5.

nuk mund të komunikojnë ballë për ballë (pa përdorur mjetet elektronike, të komunikimit).²⁰⁷

Së treti, përdorimi i mjeteve elektronike është një tjetër kriter në përcaktimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit. Si e tillë, shërbimi duhet të dërgohet dhe të merret duke përdorur pajisje elektronike. Referuar metodës së shitjes tradicionale, konkretisht atyre shoqërive të informacionit të cilat i bëjnë dhe i marrin porositë me postë nuk janë shërbime të shoqërisë së informacionit si dhe nuk janë as objekt i ligjit për tregtinë elektronike. Shërbimet e një konsumatori i cili i merr porositë me postë, por që i ka porositur duke përdorur një faqe interneti, është i përket shërbimit të shoqërisë së informacionit dhe për rrjedhojë është edhe objekt i ligjit për tregtinë elektronike.

Së katërti, shërbimi duhet të ofrohet me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit (blerësit/ konsumatorit). Pra, shërbimi i ofruar duhet të vijë si rezultat i kërkesës së blerësit/ konsumatorit.

Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, për të ofruar shërbimet e veta në distancë, siguron që këto shërbime:²⁰⁸

- a) të mos cenojnë të drejtat e njeriut;
- b) të garantojnë mbrojtjen e konsumatorit dhe të investitorëve, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) të sigurojnë mbrojtjen e minoreneve;
- d) të vendosin masa mbrojtëse për mosndërrhyrjen në shërbimet e tij dhe mospërdorimin e tyre për qëllime kriminale;

²⁰⁷ Directive 2000/31/EC on certain aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market, Arno R. Lodder, faqe 6.

²⁰⁸ Ligji Nr. 10 128, datë 11.05.2009, "Për tregtinë elektronike", i ndryshuar

- e) të ofrohen për të gjithë klientët njëloj, pa dallime ndërmjet sekseve, racave, besimit, etnisë apo bindjeve të personave që i përfitojnë ato;
- f) të mos cenojnë sigurinë kombëtare dhe sigurinë e publikut;
- g) të mos cenojnë shëndetin publik;
- h) të ofrohen, në çdo rast, me pëlqimin paraprak të përfituesit të shërbimit.

Ndryshimet ligjore, të vitit 2013 në ligjin “Për tregtinë elektronike”, kanë shtuar dispozitën 5/1 e cila parashikon se, ofrimi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit, nga një ofrues shërbimi, i themeluar në një vend anëtar i Bashkimit Europian, për arsye që i përkasin fushës së rregullimit të koordinuar, nuk kufizohet në Republikën e Shqipërisë.

Kontrata e shitjes në formë elektronike, në vetvete është një dokument elektronik e nëshkruar elektronikisht nga palët kontraktuese, të cilët janë tregtari nga njëra anë dhe konsumatori nga ana tjetër.

Në vijimësi të përcaktimit të kontratës së shitjes në formë elektronike si një dokument elektronik, vlen të theksojmë se, dokumenti elektronik është rregulluar nga ligji “**Për dokumentin elektronik**”,²⁰⁹ i cili e përkufizon si cdo informacion i krijuar me “cilësi dokumentare”, i dërguar, i marrë ose i ruajtur në formë elektronike nga një sistem kompjuterik apo nga një mekanizëm i ngjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshëmërinë, në përputhje me nenet 5 deri në 9 të këtij ligji. Përmbajtja e dokumentit elektronik përfshin të gjitha format e të dhënave, pasyruar me shkronja, numra, simbole, zë dhe imazh”.²¹⁰

Ligji “Për dokumentin Elektronik”, ligjin për tregtinë elektronike, e përkufizon “tregtinë

²⁰⁹ Ligji Nr. 10 273, DATË 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”.

²¹⁰ Neni 3/1, ligji nr. 10273, datë 24.09.2010, “Për dokumentin elektronik”.

elektronike” si: “kryerja nga subjektet e këtij ligji të një veprimtarie, nëmëpërmjet shkëmbimit të domumenteve elektronike, për tregtimin e mallrave dhe / ose të shërbimeve”²¹¹

Pra, sipas këtij përkufizimi, të gjitha veprimtaritë që realizohen për tregtimin ose shkëmbimin e mallrave dhe/ ose shërbimev, duke përdorur dokumentet elektronike, do të përkufizohen si tregti elektronike.²¹²

Në vijimësi të analizës ligjore lidhur me kontratën elektronike të shitjes, theksojmë se, kuadri ligjor shqiptar njeh një sërë garancish në funksion të mbrojtjesh së të drejtave të konsumtaorit, një ndër të cilat, përveç ligjeve të përmendura si më sipër, është edhe Ligji **“Për mbrojtjen e të dhënave personale”**.²¹³

Që prej datës 10.03.2008 mbrojtja e të dhënave personale rregullohet nga ligji nr. 9887 **“Për mbrojtjen e të dhënave personale”**, ligji i cili ka transapozuar dispozitatat e Direktivës 95/46/EC. Megjithatë për shkak të veçantive që paraqesin komunikimet elektronike i nënshtrohet rregullimeve edhe të ligjeve të tjera. Kështu konfidencialiteti dhe mbrojtja e tyre rregullohen edhe nga nenet 121-131 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, **“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar. Nisur nga fryma e këtyre dy dispozitave ligji u ka akorduar mbrojtje të veçantë të dhënave personale. Sipas nenit 121, sipërmarrësit ofruesi i shërbimit (duhet të marrin masa ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike të të dhënave, për të mbrojtur sekretin e ekomunikimve

²¹¹ Neni 3/f, ligji nr. 10128, datë 11.05.2009, Për tregtinë elektronike”, I ndryshuar.

²¹² E. Maltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 480, Tiranë 2013

²¹³ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

elektronike dhe të dhënave vetjake si dhe për të ndaluar aksesin e pautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.²¹⁴

Detyrimi për të mbrojtur të dhënat personale dhe konfidencialitetin e dokumenteve nuk bie vetëm mbi sipërmarrësin (ofruesi i shërbimit) por edhe mbi të autorizuarit dhe punonjësit e tij gjatë gjithë periudhës së kryerjes së veprimtarisë, por dhe pas përfundimit të saj. Po ashtu ligji kërkon që sipërmarrësi mund të marrë dijeni për mesazhe ose të dhëna të transmetuara nëpërmjet rrjetit të tij, vetëm në masën që i nevojitet për të kryer detyrën në sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.²¹⁵

Në mënyrë që të garantohet mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti, sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar që, individualisht ose kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njëri tjetrin, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve, të ofruara prej tyre. Po ashtu, sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të informojnë përdoruesit e tyre për ekzistencën e ndonjë rreziku të veçantë, mënyrën sesi rreziku mund të reduktohet nga përdoruesit, si dhe kostot e mundshme, që duhet të mblulohen nga përdoruesi, nëse rreziku që ndodh jashtë masave, që mund të marrë sipërmarrësi.²¹⁶

Theksojmë se, konfidencialiteti i komunikimit elektronik sipas këtij ligji përfshin:

a) Përmbajtjen e komunikimit;

²¹⁴ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 510, Tiranë 2013

²¹⁵ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 510, Tiranë 2013

²¹⁶ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 510, Tiranë 2013

b) *Të dhënat e trafikut të vendodhjes në lidhje me komunikimet;*

c) *Të dhëna për përpjekjet e pasukseshme për vendodhjen e lidhjes.*²¹⁷

Duhet theksuar fakti se, për të garantuar kanale të sigurta komunikimi ligji ndalon “të gjitha format e mbikqyrjes, përgjimit, ndërprejres, regjistrimit, ruajtjes, transferimit dhe devijimit të komunikimeve, si dhe të dhënat, referuar pikës 1 të këtij neni, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për përcjelljen e mesazheve, të faksit, të postës elektronike, të sekretarisë telefonike, mesazheve anore, mesazheve të shkurtra apo për rastet e parashikuara me ligj”.²¹⁸ Mbrojtja e të dhënave personale nuk shtrihet vetëm në drejtim të konsumatorëve, por të gjithë subjektet e përfshira në transaksionet elektronike përfitojnë nga kjo mbrojtje.²¹⁹

Sipas këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të certifikimit përdor vetëm ato të dhëna personale, të cilat janë të nevojshme për të përmbushur shërbimet e certifikimit dhe vetëm në atë shkallë, që është e nevojshme për qëllimet e lëshimit dhe të mbajtjes së certifikatës. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit i dorëzon Autoritetit, me kërkesë të këtij të fundit, të dhënat për identitetin e zotëruesit të kodit të nënshkrimit.²²⁰

a) kur kjo është e nevojshme për ndjekjen e veprave penale ose të shkeljeve ligjore dhe kur një kërkesë e tillë vjen nga organet e ngarkuara me ligj për hetimin e tyre;

²¹⁷ Neni 123/ 1, ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Rpublikën e Shqipërisë”, I ndryshuar.

²¹⁸ Neni 123/ 2, ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Rpublikën e Shqipërisë”, I ndryshuar

²¹⁹ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 511, Tiranë 2013

²²⁰ Malltezi A., J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 511, Tiranë 2013

b) për të shmangur rrezikun, që i kanoset sigurisë kombëtare ose rendit publik;

c) për të kryer detyrat, që u ka ngarkuar ligji autoriteteve fiskale, doganore apo organeve të tjera, në hetimin e shkeljeve ligjore;

ç) kur për një gjë të tillë vendos gjykata.

Kjo mbrojtje përvecse nga parashikimi i kuadrit të nevojshëm rregullues, garantohet edhe nga krijimi i organizmave përkatës, të cilat përvec të tjerave kanë si objektiv mbrojtjen e të dhënave personale që publikohen gjatë komunikimeve elektronike. Në këtë rast, përmendim Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit e cila ka si objektiva kryesorë:²²¹

- a) Mbrojtjen e të dhënave personale dhe pronësinë intelektuale, baza e të dhanave dhe mbrojtja e konfidencialitetit të të dhënave;
- b) Mbrojtja nga krimi elektronik, biznesin elektronik (tregtinë elektronike, dokumentin elektronik, nënshkrimin elektronik dhe pagesat elektronike);
- c) Legjislacioni mbi komunikimin elektronik dhe kuadrin rregullues përkatës.²²²

5.2.3 Informacioni që duhet ofruar

i. Informacioni i përgjithshëm

²²¹ Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 511, Tiranë 2013

²²² Strategjia ndërsektoriale për shoqërinë e informacionit 2008-2014, faqe 34.

Neni 3, i ligjit “Për Tregtinë Elektronike”, parashikon se, ofruesi i shërbimit në ushtrimin e veprimtarisë siguron për marrësit e shërbimit dhe për autoritetet përkatëse informacion, të paktën, për:

- a) *emrin tregtar të ofruesit të shërbimit dhe, nëse nuk ka të tillë, emrin me anë të të cilit ai është regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë;*
- b) *adresën e vendit, në të cilën është vendosur selia apo qendra kryesore e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit;*
- c) *adresën e postës elektronike apo çdo detaj tjetër që lejon komunikimin e shpejtë dhe efikas me ofruesin e shërbimit;*
- d) *të dhënat e regjistrimit në regjistrin tregtar të ofruesit të shërbimit, sidomos numrin unik të identifikimit të personit;*
- e) *të dhëna të veçanta të autoritetit përgjegjës mbikëqyrës, kur veprimtaria e ofruesit të shërbimit është objekt i ushtrimit të saj nëpërmjet pajisjes së tij me autorizim të veçantë;*
- f) *profesionet e rregulluara, duke treguar edhe:*
- g) *entit publik profesional ose institucionin e ngjashëm me të, ku ofruesi i shërbimit është i regjistruar;*
- h) *titullin profesional dhe shtetin e lëshimit apo të fitimit të tij;*
- i) *referimin për rregullat, që rregullojnë profesionin dhe juridiksionin e zbatuar në shtetin e krijimit të tij, si dhe mjetet për informim për to;*
- j) *numrin unik të identifikimit të subjektit apo NIPT-in*

Pra, ligji për tregtinë elektronike parashikon se, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, duhet të vendosë në mënyrë të qartë, të saktë dhe lehtësisht të kuptueshëm, për mallrat apo shërbimet, që ai ofron ose parashikon të ofrojë në të ardhmen, veçanërisht për çmimet. Në këtë mënyrë, informacioni duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm, se çmimi i ofruar prej tij është përfundimtar dhe se në të janë përfshirë tatimi e kostot e transportit apo të dërgimit të tij deri në destinacionin përfundimtar, të përfituesit apo të marrësit.

Referuar, pikës b, të nenit 3, të ligjit për tregtinë elektronike, vlen të komentohet se²²³, mund të ndodhë që marrëdhënia juridike civile që krijohet midis tregtarit dhe konsumatorit të jetë një marrëdhënie me një element ndërkombëtar, për shembull, oferta të vijë nga një shtet tjetër dhe konsumatori të jetë në Shqipëri ose anasjelltas. Ndodhur në këto kushte, ligjvënësi, duhet të përcaktojë në mënyrë të saktë “qendrën kryesore të veprimtarisë së tij”.

ii. Informacion i vecantë

Ligji për tregtinë elektronike, parashikon se, ofruesi i mallit dhe/ose shërbimit jep informacion të plotë, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe përpara se të bëhet kërkesa nga marrësi i shërbimit.²²⁴ Ky informacion konkret iu drejtohet personave të cilëve duan të lidhin kontratë të shitjes në formë elektronike. Ky informacion ka të bëjë me:

a) hapat e ndryshëm proceduralë, që do të ndiqen për lidhjen e kontratës;

b) kushtet kontraktore të palëve;

²²³E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 58, Tiranë 2013

²²⁴Neni 13, i Ligjit Nr. 10 128, datë 11.05.2009, “Për tregtinë elektronike”,(version i konsoliduar me ndryshimet e miratuara me ligjin Nr. 135/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128 dt. 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”)

- c) mënyrat teknike për identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve, përpara paraqitjes së kërkesës/porosisë;
- d) gjuhët e ofruara për lidhjen e kontratës;

Qëllimi i publikimit të këtij informacioni është që të jetë sa më e qartë dhe e kuptueshme procedura që do të ndjekë marrësi i shërbimit/ blerësi në lidhjen e kontratës së shitjes nëformë elektronike, pra ky informacioni i sipërpërmendur, duhet ti vendoset në dispozicion blerësit përpara se ai të bëjë porosinë.²²⁵

5.2.4 Lidhja e kontratës së shitjes në formë elektronike

Neni 14, i ligjit për “Tregtinë Elektronike”, parashikon kushtet, që duhet të plotësojë kontrata e shitjes në formë elektronike në mënyrë që të quhet e tillë.Çasti i lidhjes së kontratës së shitjes elektronike, kalon në tre faza:

Së pari: Ofruesi i shërbimit jep një fletëpërmbledhje të kushteve, të përgjithshme e të veçanta, që i aplikohen kontratës, si dhe njofton pa vonesë për marrjen e porosisë nga marrësi i shërbimit nëpërmjet mjeteve elektronike, përveç rasteve kur palët jokonsumatore bien dakord ndryshe.

Së treti: Kontrata elektronike quhet e lidhur kur ofruesi merr një mesazh elektronik, që përmban deklarimin e marrjes së konfirmimit dhe pranimin e ofertës.

Së treti: Propozimi dhe pranimi i ofertës, të bërë nga palët në marrëdhënien juridike, që lind për shkak të tregtisë elektronike ndërmjet tyre, vlerësohen se janë marrë, kur palët,

²²⁵Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 498- 499, Tiranë 2013

paraprakisht, t'i kenë provuar njëra-tjetrës se janë në gjendje t'i marrin ato në rrugë elektronike. Në këtë rast, parashikimet e Kodit Civil për pranimin apo refuzimin e ofertës, të parashikuara në kushtet e përgjithshme të kontratave, janë të zbatueshme edhe për këtë qëllim.²²⁶

Për ta përmbledhur, **momenti përfundimtar** i lidhjes së kontratës elektronike kalon në këto etapa:²²⁷

- a) *Marrësi i shërbimit tregon që ka pranuar/ shërbimin*
- b) *Ofruesi i shërbimit deklaron marrjen e pranimin*
- c) *Ofruesi i shërbimit i dërgon ofruesit një mesazh elektronik i cili përmban konfirmimin dhe pranimin e ofertës.*

I referohemi pikërisht nenit të sipërcituar, 14, pika 3, I cili përcakton se: “*Propozimi dhe pranimi i ofertës, të bërë nga palët në marrëdhënien juridike, që lind për shkak të tregtisë elektronike ndërmjet tyre, vlerësohen se janë marrë, kur palët, paraprakisht, t'i kenë provuar njëra-tjetrës se janë në gjendje t'i marrin ato në rrugë elektronike*”. Nga formulimi i kësaj dispozite duket që nuk është shumë e qartë lidhur me definicionin e aftësisë së palëve për të marrë propoziminin dhe pranimin me rrugë elektronike. Ligji është disi i vakët në këtë pikë, ashtu si Direktiva e Bashkimit Europian për tregtinë elektronike. Në ndryshim nga këto, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Përdoriminin e Komunikimeve Elektronike në Kontratat Ndërkombëtare i jep zgjidhje kësaj situate duke

²²⁶ Ligji nr. 10 128, datë 11.05.2009, “Për Tregtinë Elektronike”, *Perafruar me Direktiven 2000/31/EC, “on Some legal aspects of Information Society services, especially on electronic commerce in domestic market (Directives on Electronic Commerce)”*, me CELEX 32000L0031.

²²⁷ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 500, Tiranë 2013.

përcaktuar se termi “i aksesueshëm”, nënkupton se informacioni nga të dhënat kompjuterike duhet të jetë i lexueshëm dhe i interpretueshëm.²²⁸

Në këtë kuadër theksojmë se, si çdo kontratë tjetër edhe kontrata elektronike duhet të nënshkruhet në mënyrë që të jetë e vlefshme. Ky moment, pra nënshkrimi i kontratës elektronike, rregullohet nga ligji “Për nënshkrimin elektronik”, i cili e përkufizon “nënshkrimin elektronik” si: “të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar”.²²⁹

Parë në këtë këndvështrim themi se, në momentin që kontrata elektronike është e nënshkruar rregullisht, atëherë ajo ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe forcë provuese si forma shkresore, përcaktim ky i cili gjendet në nenin nr. 4, në ligjin “Për nënshkrimin elektronik”.

Theksojmë se, për ta bërë sa më të plotë këtë kornizë ligjore është miratuar edhe ligji “**Për nënshkrimin elektronik**”,²³⁰ i cili krijon kuadrin e nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e nënshkrimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj është i rëndësishëm sa i përket realizimit të tregtisë elektronike, pasi nënshkrimi elektronik shoqëron dokumentet elektronikë.²³¹

²²⁸ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 500-501, Tiranë 2013.

²²⁹ Ligji 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

²³⁰ Ligji Nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”.

²³¹ Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 480, Tiranë 2013

Parë në këtë këndvështrim, një vend të rëndësishëm zë edhe ligji “Për nënshkrimin elektronik” i cili garanton edhe mbrojtjen e të dhënave të subjekteve që kërkojnë të pajisen me nënshkrim elektronik. Në nenin 1, të ligjit “Për nënshkrimin elektronik”, përcaktohet shprehimisht se, qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e nënshkrimeve elektronike në Republikën Shqipërisë. Ndërsa neni 3 të këtij ligji, jepet kuptimi i nocionit “Nënshkrim elektronik”, i cili citon se: “nënshkrim elektronik” janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar. Në kuadër të këtij ligji, është më rëndësi të theksohet fakti se, veprimet juridike dhe aktet e hartuara nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, mund të bëhen edhe përmes një dokumenti elektronik, të cilit i bashkëlidhet një nënshkrim elektronik i kualifikuar. Dokumenti elektronik, i cili mban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore.²³²Nëse veprimi juridik është një kontratë, atëherë secila prej palëve duhet të nënshkruajë të njëjtin dokument me nënshkrimet elektronike të kualifikuara përkatëse.²³³

Për sa më sipër, rezulton se, nënshkrimi elektronik është nënshkrimi i cili përdoret për të bërë të mundur realizimin e një kontrate elektronike. Pra, e thënë me fjalë të tjera, secila

²³² Neni 4, I ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

²³³ Neni 5, I ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

prej palëve duhet të nënshkruajë të njëjtin dokument me nënshkrimet elektronike të kualifikuara²³⁴

Sikurse u trajtua në mënyrë të detajuar edhe pak më lart, ligji pëcakton rregullat e lidhjes së kontratës që zbatohen ndaj kontratave tradicionale, do të zbatohen edhe ndaj kontratave elektronike. Është e kuptueshme që nuk do të ketë ndonjë dallim përsa i përket rregullave që zbatohen kur blihet një libër online apo kur blihet një i tillë në librari. Kjo pasi, kontrata në vetvete nuk ndryshon dhe interneti nuk ndryshon karakterin e kontratës, por thjesht mënyrën e lidhjes së saj.²³⁵

5.2.5 Kontratat që nuk mund të lidhen në formë elektronike janë:

Sipas legjisllacionit shqiptar, jo të gjitha kontratat mund të lidhen formë elektronike. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e mëposhtme:²³⁶

- a) *Për kontratat e lidhura për të krijuar, ndryshuar apo shuar të drejta mbi sendet e paluajtshme përveç kontratës së qirasë për pasuri të paluajtshme me afat deri në 9 vjet;*
- b) *Për kontratat, që me ligj kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike dhe profesionistëve, që ushtojnë apo japin një shërbim publik;*

²³⁴ Sipas nenit 3/3, I ligjit “Për nënshkrimet elektronike”, “Nënshkrimet elektronike të kualifikuara”, janë nënshkrimet elektronike të avancuara, të cilat:

- a) Mbështeten në një certifikatë të kualifikuar, që është e vlefshme në catin e krijimit të nënshkrimit.
- b) Janë prodhuar me një mjet të sigurtë për krijimin e nënshkrimeve.

²³⁵ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 496, Tiranë 2013.

²³⁶ Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku., Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 496, Tiranë 2013.

- c) *Për kontratat, që me ligj kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike dhe profesionistëve, që ushtrojnë apo japin një shërbim publik;*
- d) *Për kontratat e parashikuara nga Kodi i Familjes dhe veprimet juridike, të parashikuara nga Kodi Civil pjesa III, titulli III “Trashëgimia me testament”*
- e) *Për shërbimet financiare ose shërbimet e sigurimit, për të cilat zbatohet marketingu në distancë”.*²³⁷

Theksojmë se, për kontratat e lidhura për të krijuar, ndryshuar apo shuar të drejta mbi sendet e paluajtshme, sipas Kodit Civil, kërkohet të ndiqet një formë e caktuar. Ajo duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet përndryshe do të jetë absolutisht e pavlefshme.²³⁸

Arsyeja e përjashtimit të kontratave në pikën b), të paktën përse i përket Direktivës së Bashkimit Europian, lidhet me faktin se do të ishte shumë të kërkoje nga Shtetet Anëtare për të dixhitalizuar gjykatat dhe autoritetet publike në një kohë të shkurtër.²³⁹

Ndërsa, përjashtimi i kontratave të parashikuara nga Kodi i Familjes dhe veprimet juridike të parashikuara nga Kodi Civil pjesa III, titulli III, “Trashëgimia me testament” janëpërjashtuar pasi janë veprime që për shkak të natyrës së tyre ndër-personale (intuita personale) nuk mund të lidhen si kontrata elektronike.²⁴⁰

5.2.6 Rëndësia dhe përgjegjësia e ofruesit të shërbimit ndërmjetës

²³⁷ Neni 12, ligji nr. 10128, datë 11.05.2009, “Për tregtinë elektronike”, I ndryshuar

²³⁸ Neni 83, I Kodit Civil, nr. 7850, datë 29.07.1994, I ndryshuar.

²³⁹ Directive 200/31/EC on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market, Arno R. Lodder, faqe 17.

²⁴⁰ Malltezi A, J. Rystemaj, L. Pelinku., Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 497, Tiranë 2013.

E gjithë procedura e lidhjes së kontratës së shitjes në formë elektronike realizohet nga një ndërmjetës, i cili lehtëson komunikimin e palëve. Ndërmjetësi në lidhjen e kontratës elektronike, është ai që ofron shërbimin i cili mundëson realizimin e kontratës elektronike. Ky subjekt ka rol krejtësisht pasiv duke u përqëndruar vetëm në lehtësimin e komunikimit e duke mundësuar vetëm transmetimin e mesazheve elektronike.²⁴¹

Pra, në këtë rast themi se, ai që siguron shërbimin nuk është në dijeni e as nuk kontrollon informacionin që transmetohet ose ruhet.²⁴² Për analogji një paralele, përmendim shërbimet postare. Për shembull, nëse një letër përmban një fotografi të kopjuar në mënyrë të paligjshme, shërbimi postar nuk ka përgjegjësi për shkeljen e së drejtës së autorit. E njëjta situatë vlen edhe për ndërmjetësin që realizon komunikimin elektronik.²⁴³

Neni 15, pika 1, i Ligjit për Tregtinë Eelektronike përcakton se, kur ofrimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit konsiston në transmetimin një rrjet komunikimi të informacionit të siguar nga marrësi i shërbimit, ose në ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi, ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar nëse ofruesi i shërbimit plotëson tre kushte:

- a) *nuk inicion transmetimin*
- b) *nuk zgjedh ose modifikon përmbajtjen e informacionit të transmetuar*
- c) *nuk zgjedh marrësin e transmetimit*

²⁴¹ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 503, Tiranë 2013.

²⁴² Recitali 42, Directive 2000/31/ EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market ("Directive on electronic commerce).

²⁴³ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 503, Tiranë 2013.

Ligji i garanton një mbrojtje të vecantë ofruesit të shërbimit të transferimit të të dhënave në kushtet kur ai nuk ka dijeni për informacionin që transmetohet dhe për aktivitetin e paligjshëm.²⁴⁴

Ndërsa neni 17 i këtij ligji²⁴⁵, përcakton se, kur një shërbim i shoqërisë së informacionit konsiston në ruajtjen e informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit:

- a) nuk ka ose nuk mund të ketë dijeni për veprimtarinë e paligjshme të marrësit ose të përmbajtjes së informacionit dhe, për sa u përket pretendimeve për dëme, nuk është në dijeni të fakteve a rrethanave prej të cilave rrjedh aktiviteti apo informacioni i paligjshëm;
- b) me marrjen e këtij informacioni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacion.

Theksojmë se, përtej këtyrë rasteve të sipërpërmendura, ndërmjetësi, është përgjegjës penalisht dhe civilisht.

5.3 Pagesa dhe mënyrat e pagesës

Pagesa, natyrisht, është një element kyç i kontratës së shitjes në mënyrë elektronike. Në vend të kartave të kreditit, parave elektronike (e-money) përdoret gjithnjë e më shumë në

²⁴⁴ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 503, Tiranë 2013.

²⁴⁵ Ligji nr. 10 128 , datë 11.05.2009, “Për tregtinë elektronike”, i ndryshur

kontraktimin nëpërmjet internetit. Paraja elektronike mund të konceptohet më mirë si një forma dixhitale e parave të gatshme dhe përdoret kryesisht për pagesa me vlerë të kufizuar.²⁴⁶

Pagesa duhet të trajtohet në të njëjtin cast me ekzekutimin e kontratës, nëse kemi të bëjmë me shkarkim të veprave ose të informacioneve të dixhitalizuara. Ekzistojnë disa mënyra pagese që përkrijnë dhe mishërojnë parimin e kryerjes së menjëhershme të transaksionit. Kështu mund të përmendim kartat e kreditit, që po përdoen gjithmonë e më shumë kohët e fundit në Shqipëri, pagesat e quajtura *cyber-cash*, në të cilat përfshihet në mënyrë të vecantë pagesa PayPal. Të dyja këto mjete pagesa janë rregulluar nga legjislacioni shqiptar në fuqi, me vendimin nr. 11, datë 06.02.2008 të Bordit Drejtues të Bankës së Shqipërisë.²⁴⁷

Pagesa nëpërmjet internetit shtron disa probleme juridike të pamohueshme. Pagesa është faza para shkarkimit të dokumentit në format numerik, pasi përbën hapin e parë të një procedure virtuale tregtare. Shkëmbimi në linjë përputhet me akordin e vullneteve pasi ekziston një qëllim kontraktual. Por nuk ekziston asnjë provë e shkruar e kësaj kontrate. Një gjë e tillë i jep aktit të kryerjes së pagesës një rëndësi të vecantë.²⁴⁸

Theksojmë se, sot në europë ekzistojnë të paktën 150 mënyra të pagesës online. Ato grupohen në disa kategori:²⁴⁹

²⁴⁶Prof. Lucas Bergkamp and Serge Clerckx, Hunton &Ëilliams, Brussels, Electronic Contracting in Europe, (Volume 5 Number 47, December 13, 2000), parë për herë të fundit më datë 24.05.2017.

²⁴⁷Fletorja Zyrtare 15/ 2008

²⁴⁸E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 70, Tiranë 2013

²⁴⁹E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 72-73, Tiranë 2013

Pagesa me kartë bankare (ose kartë krediti). Blerësi përdor kartën e tij bankare për të kryer pagesën. Ai duhet të verifikojë paraprakisht se faqja e internetit ku ai do të kryejë blerjen është pajisur me mjetet e nevojshme të sigurisë në pagesa. Përgjegjësia e sigurisë në pagesa rëndon mbi ofruesin e shërbimit. Megjithatë në shoqërinë e informacionit nuk janë aspak të rralla rastet kur konsumatori gjendet në një pozitë të rralla rastet kur konsumatori gjendet në një pozitë të tillë që kryen një blerje në një faqe ku nuk jepet asnjë garanci dhe që gjithashtu mbetet shumë e vështirë për tu zbuluar shumë kohë pasi të jetë kryer pagesa.

Pagesa me numër elektronik bankar. Disa banka kanë bërë të mundur pagesën e një shërbimi ose produkti nga ana e konsumatorit pa dhënë numrin e kartës së tyre bankare. Është vetë banka që lëshon numra elektronikë bankarë që kanë një afat të përcaktuar vlefshmërie.

Pagesa pa kartë bankare. Pagesat kryhen pa dhënë numrin e kartës bankare. Këtu hyn edhe shërbimi i famshëm PayPal. Në fakt, numrii kartës përdoret, por vetëm njëherë: në castin e regjistrimit në shërbimin PayPal. Nevojitet krijimi i një llogarie ku regjistrohet e-mail, adresa postare dhe informacioni që lidhet me llogarinë bankare. Të gjitha transaksionet që do të kryhen verifikohen nga konsumatori në llogarinë e tij PayPal.

Pagesa nëpërmjet shërbimeve internet të bankave (e-banking). Bankat propozojnë (është koha të masivizohet dhe në Shqipëri një praktikë e tillë), transferimin e shumave nëpërmjet internetit. Ky mekanizëm kërkon një kohë më të gjatë realizimi dhe rrjedhimisht zbatohet në rastet kur kemi të bëjmë pagesa periodike, si për shembull derdhja e pagave.

Rreziqet teknike të pagesave online. Rreziku më rëndësishëm kundrejt tyre është teknika e quajtur *phishing*. Në bazë të kësaj teknike qëndron uzurpimi i identitetit të një klienti. Piratët informatikë, duke marrë trajtat e bankës i dërgojnë një e-mail klientit, ku i kërkojnë të dhëna në lidhje me llogarinë e tyre bankare. Argumentet që ata shpesh përdorin kanë natyrë alarmante: tentativë vjedhje të llogarisë, probleme serioze në lidhje me llogarinë. Në përgjithësi, edhe pse e-mailet e dërguar janë të përafërta në grafikë me e-mailet zyrtarë, një konsumator i kujdesshëm mund ta kuptojë mjaft lehtë se bëhet fjalë për mashtrim.²⁵⁰

Së fundmi në Shqipëri po prezantohet dhe mënyra e pagesës nëpërmjet telefonit celular. Disa veprime të tregtisë elektronike kryhen me anë të internetit, email-it si dhe celularit, tabletave dhe pajisjeve të tjera elektronike. Gjithashtu pjesë e procesit janë njoftimet dhe konfirmimet e identitetit dhe kërkesës së produktit.²⁵¹

Megjithëse blerja online është e shpejtë dhe e lehtë, shumica e klientëve nuk mendojnë për procesin. Që procesi të punojë si duhet, sistemi për kryerjen e pagesave duhet të lidhet me një rrjet bankash për kontrollin, verifikimin dhe përpunimin e dhënave, në mënyrë që informacioni, pra të dhënat e pagesave, të siguruara nga ana e klientit të mund të dërgohen në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme. Zgjidhja është një shërbim i përpunimit të pagesave që lidh dyqanin tuaj online me institucionet përkatëse. Për shkak të informacioni i pagesave është shumë kritik, besimi dhe konfidenca janë elemente thelbësore të çdo transaksioni pagese.²⁵²

²⁵⁰E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 73, Tiranë 2013

²⁵¹USAID, Drejt Tregtisë Elektronike, Zhvillimi i Tregtisë Elektronike si një mundësi inovative online për rritjen e biznesit tuaj, faqe 10

²⁵² USAID, Drejt Tregtisë Elektronike, Zhvillimi i Tregtisë Elektronike si një mundësi inovative online për rritjen e biznesit tuaj, faqe 28.

5.3.1 Rëndësia e parasë elektronike

Paraja elektronike i referohet parasë dhe transaksioneve që kryhen me të, duke përfshirë në këto transaksione edhe mjetet elektronike. Kjo nënkupton edhe përdorimin e një rrjeti kompjuterash (si për shembull, interneti). Paraja elektronike mund të përdoret vetëm në mënyrë elektronike. Ajo mund të ruhet në një kartë, në një hard disk ose në mjete të tjera. Paraja elektronike nënkupton të gjitha veprimet që kryhen në mënyrë elektronike, rezultati i të cilave është kalimi i fondeve nga një llogari bankare në një tjetër. Paraja elektronike i gjen fillimet në gjysmën e dytë të viteve '80 në Japoni. Shumëkush mund të mendojë që paraja elektronike ka lindur si nevojë e bankave tregtare. Në fakt, pionierët e parë të krijimit të kësaj paraje ishin disa kompani jobanka, të tilla si kompanitë telefonike apo kompanitë e transportit. Arsyet kryesore të hedhjes në treg të këtij produkti ishin zëvendësimi i parasë cash dhe përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve, duke fituar kështu besimin e tyre. Në vitin 1987, filluan të krijoheshin ndërmarrje të përbashkëta midis kompanive jobanka, të cilat prodhuan një kartë të përbashkët, e pranueshme në të gjitha degët e këtyre kompanive.²⁵³

a) Paraja elektronike në Shqipëri

Historia e parasë elektronike në Shqipëri fillon në vitin 2003, me hapjen e një numri të vogël të ATM-ve (sporteleve automatike). Sot, një pjesë e mirë e bankave që operojnë në Shqipëri kanë krijuar një rrjet të zgjeruar ATM-sh në Tiranë dhe në disa qytete të tjera. Vitet e fundit është rritur numri i përdoruesve të ATM-ve, nga 34,090 në rreth 295,250.

²⁵³ Paraja elektronike, e ardhmja e parasë, faqe 10.

[file:///C:/Users/Administrator/Downloads/Paraja_elektronike_E_ardhmja_e_parase%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Administrator/Downloads/Paraja_elektronike_E_ardhmja_e_parase%20(1).pdf)

Kjo, ka ardhur si rezultat i kalimit të pagës së buxhetorëve nëpërmjet rrugëve bankare. Megjithë hezitimin nga një pjesë e nëpunësve të administratës publike, tashmë të gjithë punonjësit e kësaj administrate paguhen nëpërmjet llogarive, në bankat e nivelit të dytë. Si rrjedhojë, tërheqja e pagave nëpërmjet këtyre llogarive është kthyer në një veprim shumë të zakonshëm.²⁵⁴

5.4 Forma Ligjore që kërkohet për nënshkrimin e kontratës së shitjes në mënyrë elektronike

Lidhur me formën ligjore të kontratave elektronike, vlen të theksojmë se, nga njëra anë, ligji nuk kërkon ndonjë formë konkrete për kontratat elektronike, por ai referon në dispozitat e Kodit Civil sa i përket kushteve që ai parashikon për formën dhe për vlefshmërinë e kontratave. Megjithatë ngelet ende e paqartë se cilën nga kërkesat për formë duhet të respektojnë kontratat elektronike. Gjithsesi kjo, është një çështje e diskutueshme edhe për disiplina të tjera, të cilat ende nuk kanë arritur në një përfundim të pranuar gjerësisht.²⁵⁵

Ndërsa nga ana tjetër, kontrata elektronike duke qenë një dokument elektronik, duhet të plotësojë kushtet për formën dhe vlefshmërinë e dokumentit elektronik të përcaktuara në

²⁵⁴ Paraja elektronike, e ardhmja e parasë, faqe 26

[file:///C:/Users/Administrator/Downloads/Paraja_elektronike_E_ardhmja_e_parase%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Administrator/Downloads/Paraja_elektronike_E_ardhmja_e_parase%20(1).pdf)

²⁵⁵ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 501, Tiranë 2013.

ligjin “Për dokumentin elektronik”.²⁵⁶ Neni 5, i këtij ligji²⁵⁷ përcakton vlefshmërinë ligjore të dokumentit elektronik nëse:

- a) *Krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve tëngjashme dhe programeve elektronike, duke përmbushur plotësisht kërkesat e nënenet 6, 7, dhe 8 të këtij ligji.*

Theksojmë se, përgjatë ciklit të dokumentit, në veprimet e përfshira në të, dokumenti elektronik duhet të sigurojë disa kritere:²⁵⁸

- a) *nënshkrim elektronik, sipas legjislacionit për nënshkrimin elektronik;*
- b) *të dhënat e krijuesit të dokumentit elektronik;*
- c) *pacënueshmërinë e dokumentit elektronik;*
- d) *akses në përmbajtjen e dokumentit elektronik përgjatë gjithë ciklit të dokumentimit;*
- e) *qartësi në leximin e përmbajtjes së tij.*

Struktura e dokumentit elektronik, duhet të përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe ajo e posacme e tij të cilat janë të pandashme.²⁵⁹

²⁵⁶ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 496, Tiranë 2013.

²⁵⁷ Neni 5, I Ligjit nr. 10 273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”.

²⁵⁸ Neni 6, i Ligjit nr. 10 273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”.

²⁵⁹ Neni 7, i Ligjit nr. 10 273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”.

- a) pjesa e përgjithshme paraqet informacionin e përmbajtjes së dokumentit elektronik.
Nëse dokumenti elektronik ka për qëllim t'i dërgohet një marrësi të përcaktuar, kjo pjesë përmban edhe emrin e marrësit;
- b) pjesa e posaçme përfshin një apo disa nënshkrime elektronike dhe informacion, që i përkasin kohës së krijimit të dokumentit elektronik, si dhe të dhëna të tjera, që i përkasin cilësisë dokumentare, sipas parashikimeve të nenit 3 pika 2 të këtij ligji.

Gjithashtu, dokumenti elektronik duhet të ketë formën e paraqitjes së brendshme dhe formën e paraqitjes së jashtme:²⁶⁰

- a) forma e brendshme e paraqitjes së dokumentit elektronik është forma numerike, e përftuar nga përpunimi, dërgimi, marrja dhe ruajtja e dokumentit elektronik me një sistem programesh dhe pajisjesh kompjuterike;
- b) forma e jashtme e paraqitjes së dokumentit elektronik është paraqitja vizuale dhe e kuptueshme e përmbajtjes së tij në ekranin e kompjuterit apo në pajisje të tjera të ngjashme ose në letër apo në mjete të tjera të materializuara, prodhuar nga forma e brendshme e paraqitjes, sipas shkronjës “a” të këtij neni.

Nën frymën e ketyre dispozitave ligjore, sikurse e përmend edhe më sipër, kontrata elektronike duhet të nënshkruhet rregullisht që të mund të jetë e vlefshme. Lidhur me këtë çështje, kuadri ynëligjor është plotësuar dhe janë krijuar edhe strukturat përkatëse për licensimin e ofruesve të shërbimit të certifikimit i.e **Autoritetit Kombëtar për**

²⁶⁰ Neni 8, I Ligjit nr. 10 273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”.

Çertifikimet Elektronike. Megjithatë nga regjistri i mbajtur deri tani nga ky Autoritet rezulton që është regjistruar si ofrues shërbimit të çertifikimit vetëm Posta Shqiptare sh.a.²⁶¹

4.5 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

i. Detyrimet e shitësit/ ofruesi i shërbimit

Së pari, shitësi, ka detyrimin, që në një kohë të arsyeshme, konsumtarit, ti sigurojë të gjithë informacionin e përshtatshëm, të dhënë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, për identitetin e tregtarit, karakteristikat kryesore të mallrave dhe shërbimeve, çmimin dhe kosto të tjera të zbatueshme, detajet për dorëzimin dhe pagesën, kushtet për rikthimin e mallit ose për refuzimin e shërbimit, afatin e vlefshmërisë së ofertës dhe të drejtën e konsumatorit për të hequr dorë nga kontrata brenda periudhës së përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.²⁶²

Së dyti, konsumatori duhet të marrë konfirmim me shkrim nga tregtari, në një kohë të arsyeshme, gjatë zbatimit të kontratës dhe sidomos në çastin e dërgimit të mallit, për informacionet e mëposhtme:²⁶³

a) kushtet dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës së tij, për të hequr dorë nga kontrata;

b) adresën gjeografike, në të cilën konsumatori mund të dërgojë ankesat e tij;

c) garancitë dhe shërbimet pas shitje, të cilat ekzistojnë;

²⁶¹ Agita Malltezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, faqe 502, Tiranë 2013.

²⁶² Neni 37, pika 1, e ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”,

²⁶³ Neni 37, pika 2, e ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”,

ç) vendimin për anulimin e kontratës, kur kjo ka një afat të papërcaktuar ose ka afat më të gjatë se një vit.

Së treti, tregtari duhet të përmbushë porosinë e marrë nga konsumatori brenda një afati maksimal prej 30 ditësh kalendarike, nga dita pasardhëse e ditës kur konsumatori ia dërgon porosinë furnizuesit.

ii. *Detyrimet e blerësit/ konsumatori (tregtari)*

Të drejtat e blerësit/ konsumatorit

Së pari, konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata pa penalizim dhe pa dhënë asnjë arsye, brenda një afati prej 14 ditësh kalendarike, duke filluar nga dita e dorëzimit të mallit ose e lidhjes së kontratës për ofrimin e shërbimit, nëse shërbimi nuk është siguruar brenda këtij afati.

Parë në këtë këndvështrim, theksojmë se, e drejta e tërheqjes, justifikohet me idenë se konsumatori, nuk e sheh produktin në çastin e blerjes dhe mund të pësojë zhgënjim kur ta marrë atë, pasi nuk përkon me pritshmëritë që ai ka për produktin, bazuar në informacionin e dhënë nga shitësi.²⁶⁴ Në vijimësi të këtij qëndrimi, themi se, kjo logjikë referohet në mënyrë direkte kontratave në largësi²⁶⁵, një prej të cilave është dhe kontrata e shitjeve në shtëpi, pasi shitblerja nuk kryhet në qendrën tregtare, por në vendbanimin e konsumatorit. Vlen për tu theksuar fakti, se e drejta e tërheqjes rrjedh nga teoria gjermane e **punktacionit**, sipas së cilës kontrata do të jetë e ekzekutueshme vetëm pas një afati të

²⁶⁴ E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 75, Tiranë 2013

²⁶⁵ Shih VKM Nr. 69, datë 21.01.2009, “Për kontratat në largësi”.

caktuar reflektimi.²⁶⁶ E drejta e tërheqjes, gjendet në direktivën europiane të vitit 1997²⁶⁷, e cila ka të bëjë me kontratat në distancë ashtu dhe në ligjin tonë për mbrojtjen e konsumatorëve.

Së dyti, nëse çmimi i mallit ose shërbimit mbulohet, plotësisht ose pjesërisht, nga kredia e dhënë nga tregtari, ose nga kredia dhënë konsumatorit nga një palë e tretë, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet palës së tretë dhe tregtarit, marrëveshja e kredisë anulohet, pa penalizim, nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij të heqjes dorë nga kontrata, sipas pikës 3 të këtij neni.

Së treti, konsumatori ka të drejtë të kërkojë anulimin e një pagese, kur karta e tij e pagesës, për kontratën në largësi, është keqpërdorur me mashtrim dhe konsumatori rikreditohet ose i rikthehet shuma e paguar.

5.5.1 Ligji i zbatueshëm dhe juridiksionet kompetente

Në fushën kontraktuale mund të lindin, shumë konflikte me karakter ndërkombëtar. Dimensionin ndërkombëtar i marrëdhënieve kontraktore në fushën e internetit merr rëndësi akoma në të madhe, rrjedhimisht studimi i normave të konfliktit në këtë fushë është me interes të vecantë. Në rastin kur paraqitet një situatë konfliktuale, shtrohet çështja e gjetjes

²⁶⁶ E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 75, Tiranë 2013

²⁶⁷ Direktiva 97/7 CE, datë 20 maj 1997, në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve në fushën e kontratave në distancë.

së ligjit që do ti zbatohet kontratës dhe juridiksionit që do të gjykojë mosmarrëveshjet që mund të lindin nga mosrepektimi i pretenduar i saj.²⁶⁸

Parimet e së drejtës ndërkombëtare në fushën kontraktuale nuk janë më në dorë të shteteve. Tashmë, në pjesën dërrmuese të saj, fusha e së drejtës së detyrimeve rregullohet nga konventat ndërkombëtare. Përsa i përket kompetencës juridiksionale, ekziston Rregullorja e Këshillit të Bashkimit Europian në lidhje me kompetencën gjyqësore, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, që ka hyrë në fuqi më 1 mars 2002. Kjo rregullore parashikon dy kritere të përcaktimit të kompetencës së përgjithshme të gjykatës së ndodhur në territorin ku i padituri ka banimin. Në këtë mënyrë, rregullorja vë theksin te nocioni i banimit, në dëm të nocionit të kombësisë, ç'ka tregon evolucion në fushën e së drejtës ndërkombëtare private.²⁶⁹

Rregullorja parashikon gjithashtu rastin kur kontrata ka njohur një fillim ekzekutimi. Në këtë rast, neni 5 paragrafi 1, i jep kompetencë “gjykatës së vendit ku detyrimi, që shërben si bazë e veprimit, ka qenë ose duhet të ekzekutohet”. Këtu preket dhe çështja e kontratës së lidhur nëpërmjet internetit. Si në rastin e furnizimit të shërbimit, ashtu edhe në rastin e shitjes së mallrave nëpërmjet internetit, do të shtrohet çështja e dhënies së kompetencës së gjykatës që do të marrë në shqyrtim një konflikt: do të jetë gjykata e vendit ku ndodhet tregtari ose serveri i faqes që ka vënë në linjë ofertën apo vendi ku ndodhet marrësi i ofertës? Në rastet kur kemi një fillim ekzekutimi do të thotë se detyrimi që ka lindur është

²⁶⁸E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 81, Tiranë 2013

²⁶⁹E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 81, Tiranë 2013

një fillim ekzekutimi do të thotë se detyrimi ka vendbanimin e tij. Rrjedhimisht, pranohet se gjykata kompetente do të jetë gjykata e vendit të banimit të marrësit të shërbimit.²⁷⁰

Parimet e rregullores së 1 marsit 2002 (ndryshe e quajtur Rregullorja Bruksel 1), janë marrë nga ligji ynë nr. 10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare Private”.²⁷¹ Sipas këtij ligji, “gjykatat shqiptare kanë juridiksionin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vëndqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë përveçse kur rregullat e këtij kreu parashikojnë ndryshe”. Po ashtu neni 80 i këtij ligji përcakton raste të tjera të juridiksionit ndërkombëtar. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe në rastet e mëposhtme:

- a) kur paditen njëkohësisht disa persona së bashku dhe njëri prej tyre ka vëndqëndrimin e tij në Republikën e Shqipërisë, si dhe kur personi juridik i paditur ka selinë e tij në Republikën e Shqipërisë;
- b) kur padia ka për objekt një kontratë ose pretendime që rrjedhin nga një kontratë dhe vendi, në të cilin është përmbushur ose duhej përmbushur detyrimi, ndodhet në Republikën e Shqipërisë;
- c) nëse objekt i gjykimit janë pretendimet, që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit dhe vendi, ku është kryer apo ka ndodhur veprimi që ka shkaktuar dëmin, është në Republikën e Shqipërisë;

²⁷⁰E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 81-82, Tiranë 2013

²⁷¹Ligji nr. 10 428, date 2.6.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

ç) kur padia ka për objekt mosmarrëveshje, që rrjedhin nga veprimtaria e një dege ose filiali të një personi juridik, me seli në Republikën e Shqipërisë;

d) kur padia rrjedh nga detyrimi për ushqim që ka një person kundrejt një personi, i cili ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë;

dh) paditë, që burojnë nga trashëgimia ligjore dhe ajo testamentare kur:

i) trashëgimlënësi ka pasur vendqëndrimin e tij, në kohën e vdekjes, në Republikën e Shqipërisë;

ii) pasuria trashëgimore ose pjesa më e madhe e saj ndodhet në Republikën e Shqipërisë.

Ndodhur në këto kushte theksojmë se, referuar temës së disertacionit, kontratës së shitjes në formë elektronike, na interesojnë pikat b dhe c të nenit 80, që kanë të bëjnë me detyrimet kontraktuale dhe me ato jashtëkontraktore. Ligji shqiptar për tregtinë elektronike nuk bën fjalë në lidhje me ligjin që duhet të zbatohet. Në këtë mënyrë, i referohemi ligjit të vjetër nr. 10 428 datë 2.6.2011 “*Për të drejtën ndërkombëtare private*”, që rregullon zbatimin e së drejtës ndërkombëtare private në Shqipëri.²⁷² Kështu, sipas nenit 46, pika 1, ligji i zbatueshëm për kontratën përcaktohet sipas rregullave që vijojnë:

a) një kontratë shitjeje rregullohet nga ligji i vendit ku shitësi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

²⁷²E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 86, Tiranë 2013

- b) një kontratë për furnizimin e shërbimeve rregullohet nga ligji i vendit ku ofruesi i shërbimit ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;
- c) një kontratë në lidhje me të drejtat reale mbi pasurinë e paluajtshme apo të drejtën e përdoruesit të një pasurie të paluajtshme rregullohet nga ligji i vendit ku ndodhet pasuria;
- ç) pavarësisht nga shkronja "c" e kësaj pike, një kontratë qiraje e lidhur për përdorim individual të përkohshëm të një pasurie të paluajtshme, për një periudhë prej jo më shumë se gjashtë muajsh të njëpasnjëshëm, rregullohet nga ligji i shtetit ku qiradhënësi ka vendbanimin e tij të zakonshëm, me kusht që qiramarrësi të jetë person fizik dhe të ketë vendqëndrimin e tij të zakonshëm në të njëjtin shtet;
- d) një kontratë franshizingu rregullohet nga ligji i shtetit ku franshizingmarrësi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;
- dh) një kontratë për furnizimin e mallrave rregullohet nga ligji i shtetit ku furnizuesi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;
- e) një kontratë për shitjen e mallrave me ankand rregullohet nga ligji i shtetit ku zhvillohet ankandi, nëse ky shtet mund të përcaktohet;
- ë) një kontratë e lidhur brenda një sistemi shumëpalësh, që bashkon ose lehtëson bashkimin e shumë palëve të treta, që blejnë dhe shesin interesa në instrumentet financiare, në përputhje me rregullat e legjislacionit përkatës, dhe e rregulluar nga një ligj i vetëm, rregullohet nga ai ligj.

Ndërsa referuar po ketij neni (42), pikës 2, përcaktohet se: Kontratat, të cilat nuk janë përmendur shprehimisht në pikën 1 të këtij neni, ose kur elementet e kontratës përfshijnë tiparet e më shumë se një nga llojet e kontratave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kontrata rregullohet nga ligji i shtetit, ku pala që duhet të përmbushë shërbimin që karakterizon kontratën ka vendbanimin e saj të zakonshëm në çastin e lidhjes së kontratës. Pra, bazuar tek kjo dispozitë ligjore, rezulton se, ligji i zbatueshëm do të jetë ligji i palës që ka marrë përsipër përmbushjen e detyrimit, që përbën në thelb shkakun parësor të kontratës. Sipas teorisë së shkakut, detyrimi i njëres palë ka të bëjë me objektin e detyrimit të palës tjetër dhe anasjelltas. Në këtë mënyrë, në një kontratë shërbimi, shkakun i palës që ofron shërbimin është detyrimi i palës tjetër që të paguajë dhe shkakun i palës që paguan është detyrimi i palës tjetër që të kryejë shërbimin. Por nuk mund të ketë pagesë pa kryerjen e shërbimit, që në këtë rast rezulton të jetë detyrimi kryesor. Në këtë kuptim themi se, detyrimi që karakterizon kontratën është kryerja e shërbimit.²⁷³

Në vijimësi të këtij ligji, neni 37, parashikon se, përpara lidhjes së çdo kontrate në largësi, në një kohë të arsyeshme, konsumatorit i sigurohet i gjithë informacioni i përshtatshëm, i dhënë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, për identitetin e tregtarit, karakteristikat kryesore të mallrave dhe shërbimeve, çmimin dhe kosto të tjera të zbatueshme, detajet për dorëzimin dhe pagesën, kushtet për rikthimin e mallit ose për refuzimin e shërbimit, afatin e vlefshmërisë së ofertës dhe të drejtën e konsumatorit për të hequr dorë nga kontrata brenda periudhës së përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.²⁷⁴ Ky informacion është

²⁷³E drejta e internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 87, Tiranë 2013

²⁷⁴Pika 3 e Neni 37, i ligjit për mbrojtjen e konsumatorit “Konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata pa penalizim dhe pa dhënë asnjë arsye, brenda një afati prej 14 ditësh kalendarike, duke filluar nga dita e

domosdoshëm për konsumatorin, në mënyrë që ai të sigurohet për mallin ose shërbimin që do ti jepet, pasi kontratat në largësi quhen të përfunduar pikërisht në momentin e dorëzimit të sendit.

Saktësisht, dy janë rastet e përfundimit të kontratës:

- a) Në momentin kur dorëzohet sendi
- b) Dhe kur pronësia mbi sendin transferohet në mënyrë të menjëhershme, në mënyrë elektronike.²⁷⁵

Sipas nenit 37, të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, në lidhje me kontratat në largësi, për shitësin ose ofruesin e shërbimit parashikohet detyrimi që ata të japin informacionin e përshtatshëm në lidhje me identitetin e tregtarit, karakteristikat kryesore të mallrave dhe shërbimeve, çmimin dhe kosto të tjera të zbatueshme, detajet për dorëzimin dhe pagesën, kushtet për rikthimin e mallit ose për refuzimin e shërbimit, afatin e vlefshmërisë së ofertës dhe të drejtën e konsumatorit për të hequr dorë nga kontrata brenda periudhës së përcaktuar.²⁷⁶

Në fushën e internetit, kontrata që do të lidhen midis tregtarit dhe konsumatorëve klasifikohen si kontrata në largësi dhe në këtë mënyrë paraqitet e nevojshme që tregtari të japë cdo të dhënë që konsiderohet e domosdoshme për konsumatorin, në mënyrë që ai të sigurohet për mallin ose për shërbimin që do të jepet, pasi kontratat në largësi quhen të përfunduara në momentin kur bëhet dorëzimi i sendit. Shërbimet kanë disa specifika që lidhen me momentin e realizimit, që mu të jetë i menjëhershëm (shkarkim ose dic quhet

dorëzimit të mallit ose e lidhjes së kontratës për ofrimin e shërbimit, nëse shërbimi nuk është siguruar brenda këtij afati.

²⁷⁵ Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013. Faqe 57

²⁷⁶ Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013. Faqe 57

ndryshe, doënload-im) ose në një çast të mëvonshëm me lidhjen e kontratës. Do të jemi në praninë e dy rasteve të përfundimit të kontratës: kur dorëzohet sendi dhe kur pronësia mbi sendin transferohet në mënyrë të mjenjëhershme, në mënyrë elektronike.²⁷⁷

Duke iu referuar nevojës së identifikimit të tregtarit, ligji për mbrojtjen e konsumatorëve plotësohet mjaft mirë me ligjin për tregtinë elektronike, i cili përshkruar saktësisht serinë e të dhënave që duhet të japë tregtari nëse hyn në një marrëdhënie juridike civile me një konsumator.²⁷⁸

Së pari, është pikërisht neni 7 i ligjit për tregtinë elektronike i cili parashikon që ofruesi i shërbimit në ushtrimin e veprimtarisë duhet të paraqitet me emrin e tij tregtar. Nëse ofruesi nuk ka një emërtim të tillë, duhet të japë emrin me anë të të cilit ai është regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë, pra emrin e tij personal që është regjistruar si person fizik.

Së dyti: Ofruesi i shërbimit duhet të japë adresën e vendit ku është vendosur selia apo qendra kryesore e veprimtarisë së tij. Kjo pikë kërkon një koment të shkurtër. Mund të ndodhë që marrëdhënia juridike civile që krijohet midis tregtarit dhe konsumatorit të jetë një marrëdhënie me një element ndërkombëtar, për shembull oferta të vijë nga një shtet tjetër dhe konsumatori të jetë në Shqipëri ose anasjelltas. Në këtë mënyrë lind nevoja që të përcaktohet saktë “qendra kryesore veprimtarisë së tij”.

Ekzistojnë dy pikëpamje kryesore mbi përcaktimin e selisë së një shoqërie tregtare. Secila prej këtyre teorive sjell pasoja mbi legjilacionin e zbatueshëm për shoqërinë. Kështu *teoria e parë*, e vë theksin tek liria e zgjedhjes për themeluesit e shoqërisë dhe i lejon ata që

²⁷⁷Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013, faqe 57

²⁷⁸Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013, faqe 58

ta themelojnë shoqërinë në një juridiksion të caktuar, edhe pse shoqëria nuk ka lidhje ekonomike me atë juridiksion. Shoqëria rregullohet nga ligji për shoqëritë tregtare në juridiksionin e themelimit të saj: kështu ky rregull i së drejtës ndërkombëtare private njihet si “*teoria e themelimit*”.²⁷⁹ Zgjidhja e dytë e ndalon këtë liri në përcaktimin e themeluesve duke iu referuar një faktori objektiv që është *selia e vërtetë ose vendodhja e zyrës qendrore*.²⁸⁰

Prezantimi i të dyjave teorive është i rëndësishëm pasi ligji për shoqëritë tregtare, në nenin 8 të tij²⁸¹, është pak evaziv dhe nuk e sqaron përfundimisht se cila nga këto dy teori sanksionohet prej tij. Nëse në paragrafin e dytë të ligjit për shoqëritë tregtare thuhet se një shoqëri është subjekt i dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare kur zyra e saj qendrore ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, në paragrafin e parë, neni 8 lë shumë vënd për interpretim.²⁸² Parimi sipas nenit 8 është zbatim i teorisë së selisë së vërtetë. Megjithatë, ky parim njih një përjashtim të madh, që padashur mund të kthehet në parim, pasi u jep mundësi themeluesve ose ortakëve të shoqërisë të përcaktojnë teorinë e themelimit, ndonëse veprimtarinë krytregtare mund ta zhvillojnë në një vend tjetër. Si rrjedhim mund të dalim në konkluzionin se, për shoqëri që kanë zyrën qendrore në Shqipëri, do të zbatohet legjilacioni shqiptar, dhe si rrjedhim, edhe ligji për mbrojtjen e konsumtarit dhe ai për tregtinë elektronike. Ndërkohë ligji për tregtinë elektronike i

²⁷⁹ Thomas Bachner, Edmund- Philip Schuster, Martin Einner, Projekt BINJAKËZIMI cards 2004, “Përmirësimi I sistemit gjyqësor për çështjet tregtare”, botimet Dudaj.

²⁸⁰ Ibid

²⁸¹ Neni 8, Zyra Qendrore “1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në statut, zyra qendrore e shoqërisë tregtare është vendi ku zhvillohet pjesa kryesore e veprimtarisë së saj tregtare. 2. Nëse zyra qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, shoqëritë tregtare u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji”.

²⁸² Neni 8 i Ligjit 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar: “1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në statut, zyra qendrore e shoqërisë tregtare është vendi, ku zhvillohet pjesa kryesore e veprimtarisë së saj tregtare. 2. Nëse zyra qendrore ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, shoqëritë tregtare u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji”. <http://www.qkr.gov.al/nrc/documents/ligji9901.pdf>

referohet konceptit të “qendrës kryesore të veprimtarisë”. Në botën dizhitale, ku një ofrues shërbimesh mund të kryejë tregti në shumë vende të botës, një konceptim i tillë është jorealit. Pra, arrijmë në përfundimin se do të ishte më e vlefshme ndarja si vijon: për shoqëritë që ndodhen jashtë shtetit, referimi do të jetë juridiksioni i selisë që ato e kanë të shënuar në statut, ndërsa për shoqëritë tregtare me qendër në Shqipëri do të zbatohen dispozitat më të favorshme të ligjit shqiptar me konsumatorin.²⁸³

Gjithcka do të ishte më e lehtë nëse ligji për tregtinë elektronike do të kishte parashikuar që, përvec qendrës kryesore të veprimtarisë, të përfshihej edhe koncepti i përfaqësisë që parashikohet në nenin 9 të ligjit për shoqëritë tregtare, nëse shoqëritë ofertuese mund ta kishin këtë mundësi, në mënyrë që të krijohet një lidhje e prekshme me konsumatorin, duke patur parasysh se marrëdhëniet juridiko-civile në distancë mbeten edhe të dyshimta, të paktën në vendin tonë.²⁸⁴

Identifikimi i ndërmarrjes ose shoqërisë ofertuese është i domosdoshëm, në mënyrë të vecantë në përsepektivën e fillimit të procedurave pas shitjes, për reklamimet e mundshme dhe për rastet e lindjes së konflikteve. Në këtë kuptim, emetimi i vetyëm i postës elektronike të ofertuesit është i pamjaftueshëm. Sic vihet në dukje nga sa paraqitëm më lart, ligjet kryesore në këtë fushë, ai për tregtinë elektronike, si dhe për mbrojtjen e konsumatorit, janë plotësues të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.²⁸⁵

Së treti, ofertuesi duhet të japë adresën e postës elektronike apo çdo detaj tjetër që lejon komunikimin e shpejtë dhe efikas me ofruesin e shërbimit. Një vërejtje në lidhje me

²⁸³Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013, faqe 59

²⁸⁴Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013, faqe 58

²⁸⁵Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013, faqe 60

terminologjinë që përdor ligji në këtë rast: shpeshherë, si në këtë pikë ashtu dhe në pika të tjera të ligjit për tregtinë elektronike, vihet re referimi vetëm ndaj termit “ofertues të shërbimit”. Megjithatë, ofertuesi i shërbimit duhet marrë në kontekstin e gjerë, pra qira injë malli, por që, për të kryer një gjë të tillë përdor mjetet elektronike të komunikimit, si dhe të lidhjes së kontratës.

Së katërti, ofertuesi duhet të japë të dhënat e regjistrimit në regjistrin tregtar, në mënyrë të vecantë numrin unik të identifikimit të personit (NUIS që ka zëvendësuar Numrin e Identifikimit të Personit të tatueshëm ose NIPT). Edhe kjo e dhënë përbën një element sigurie të fortë për konsumatorin, pasi ai mund të klikojë mjaft lehtë në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit e cila sipas, ligjit, mban regjistrin tregtar.

Këto katër elemente duhet të përfshihen në çdo komunikim që kryen tregtari me konsumatorin. Mund të ndodhë që një veprimtari tregtar të rregullohet nëpërmjet autorizimeve të veçanta që duhet të lëshojnë institucionet shtetërore. Kështu, për shëmbull, do të jetë rasti i veprimtarisë së shitjes së mallrave ushqimore specifike, që mund të kryhet pasi të jetë dhënë licenca nga organet përkatëse. Nëse do të kemi të bëjmë me një veprimtari të tillë tregtare, ofertuesi duhet të japë të dhëna në lidhje me organin mbikqyrës të aktivitetit të tij.²⁸⁶

Pasi parashtruam kriteret ligjore të identifikimit, vlen të theksojmë se dallimi midis shitësve profesionistë dhe shitësve joprofesionistë kryehet nëpërmjet vlerësimit të pavarur të fakteve nga ana e gjykatës. Përshembull gjykata ka cilësuar si shitës profesionist një individ që rishiti një numër të konsiderueshëm objektesh koleksioni në një faqe interneti të

²⁸⁶ Oltion Spiro, *E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike*, Tiranë 2013, faqe 60

specializuar për ankandet, pa e deklaruar aktivitetin e tij pranë organeve tatimorë dhe regjistrit tregtar. Gjykata e quajti aktivitetin si punë e fshehur dhe e dënuan kësisoj individin për fshehje të të ardhurave.²⁸⁷

5.5.2 Autoritetet mbikqyrëse dhe Sanksionet

a) Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve

Sipas ligjit “Për Tregtinë Elektronike”, përsa i përket ndjekjes dhe zbatimit të detyrimeve, të përcaktuara në këtë ligj, ngarkohet Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit, të përcaktuara në ligjin "Për mbrojtjen e konsumatorit. Për qëllime të mbikëqyrjes, ofruesit e shërbimit të shoqërisë së informacionit u ofrojnë personave të autorizuar akses në pajisjet kompjuterike dhe japin, pa vonesë, informacionin dhe dokumentet e transmetuara, që kanë lidhje me subjektin e mbikëqyrjes.

Pikat e kontaktit dhe kooperimi

Neni 21/ 1, të Ligjit “Për Tregtinë Elektronike”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet zbatuese bashkëpunojnë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj. Autoritetet zbatuese, brënda 90 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përcaktojnë pikat e kontaktit për bashkëpunimin me shtetet anëtare dhe Komisionin e Bashkimit Europian dhe ku ofruesit dhe marrësit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit:
 - a) sigurojnë informacion të përgjithshëm mbi të drejtat dhe detyrimet kontraktore, mbi ankesat dhe mekanizmet e demshperblimit ne dispozicion ne rast

²⁸⁷ Oltion Spiro, E drejta e Internetit @ aspekte të shkëmbimeve elektronike, Tiranë 2013, faqe 61

mosmarrëveshjeje, si dhe aspekte praktike të përdorura në këto mekanizma sipas legjislacionit në fuqi.

b) sigurojnë informacionin për autoritetet, ose organizatat kompetente që ofrojnë informacion shtesë ose asistencë praktike sipas legjislacionit në fuqi.

2. Autoritetet zbatuese sigurojnë që pikat e kontaktit janë të arritshme në rrugë elektronike.

Sanksionet

1. Një person juridik, ofrues i shërbimit të shoqërisë së informacionit, dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë për rastet e mëposhtme:

a) shkelje të detyrimit për informacion të përgjithshëm (neni 7);

b) shkelje të detyrimit për informacion të përgjithshëm për komunikimet tregtare (neni 8);

c) shkelje të detyrimit për sigurimin e aksesit për lidhjen e kontratës (neni 13 pika 1);

d) shkelje të detyrimeve të pikave 2 e 3 të nenit 20 të këtij ligji;

e) për mosrespektim të nenit 9 për komunikimet tregtare të pakërkua.

2. Nëse shkeljet e mësipërme janë kryer nga persona fizikë, ofrues të shërbimit të shoqërisë së informacionit, në këtë rast ata dënohen me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3. Shkeljet e parashikuara nga ky ligj, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe, sipas fushës së tyre të veprimit, autoritetet mbikëqyrëse vendosin

gjobat, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij.²⁸⁸

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve²⁸⁹

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, që rrjedhin nga hyrja në marrëdhënie me njëri-tjetrin, për shkak të ofrimit dhe të pranimit të shërbimeve në distancë, zgjidhen nga gjykata e arbitrazhit, sipas klauzolave të arbitrazhit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në rast mungese të marrëveshjes për arbitrazh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata e rrethit gjyqësor.

b) Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik

Sipas nenit 10, pika 1, përcaktohet se: Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, në vazhdim Autoriteti, është institucioni që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.²⁹⁰

Gjithashtu, një tjetër funksion që lidhet me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik, i referohet momentit kur urdhëron shfuqizimin e certifikatave të kualifikuara në rast se:²⁹¹

a) nuk kanë sigurinë e mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave;

²⁸⁸ Neni nr. 23, I ligjit nr. 10 128 datë 11.05.2009, “Për tregtinë elektronike”, (version i konsoliduar me ndryshimet e miratuara me ligjin Nr. 135/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128 dt. 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”

²⁸⁹ Neni 24, po aty. (Referuar ligjit për tregtinë elektronike).

²⁹⁰ Ligji nr. 9980, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”.

²⁹¹ Neni 10 I Ligjit nr. 9980, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”.

b) mjetet e krijimit të nënshkrimit elektronik kanë mangësi për sigurinë dhe mundësojnë falsifikimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara apo të të dhënave, që lidhen me këtë nënshkrim, pa u zbuluar.

2. Autoriteti konstaton pavlefshmërinë e certifikatave të kualifikuara, që janë të falsifikuara.

3. Procedura e çregjistrimit dhe informimi i të tretëve rregullohen me akte nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

b) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Sipas nenin 8, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar), AKEP-i²⁹²ka si kompetencë: mbikëqyr, kontrollon

²⁹² a) mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji;
b) rregullon aksesin dhe interkoneksionin midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe siguron që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme;
c) miraton ofertën e referencës për aksesin dhe/ose interkoneksionin, si dhe ofertën e referencës për akses të hapur në rrjetin lokal të sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij ligji, me aktet nënligjore, si dhe tarifa të orientuara në kosto;
ç) përcakton sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg;
d) kryen regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit;
dh) ndërmerr dhe përcakton masat mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mos lejuar praktika antikonkurruese;
e) bashkëpunon me ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;

dhe monitoron veprimtarinë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike; të kryejë regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike; ndërmerret dhe përcakton masat mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike etj.

5.6 Të dhëna statistikore sipas Postës Shqiptare²⁹³

Zhvillimet e mëdha në komunikimet elektronike paraqesin sfida të mëdha për ofruesit e shërbimeve postare për shkak të rritjes së ndjeshme të mundësive të zëvendësimit të shërbimeve postare me shërbimet e rrjeteve elektronike të cilat kanë çuar në reduktime të ndjeshme të numrit total të objekteve postare kudo në botë. Megjithatë zhvillimet në komunikimin elektronik dhe tregtinë elektronike kanë rritur kërkesat për pakot/ paketat postare ndërkombëtare. Me zhvillimet e fundit në të aksesit broadband dhe tregtisë elektronike në Shqipëri, këto tendenca botërore të shërbimeve postare kanë filluar të shfaqen edhe në Shqipëri.

Numri total i objekteve të postuara të pranuar gjatë vitit 2016 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë vitit 2016 ishte rreth 24 milion, që përbën një rritje me rreth 13 për qind në krahasim me vitin 2015. Posta Shqiptare sh.a vazhdon ta ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 94 për qind të tregut të shërbimit postar kundrejt 6 për qind që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve.

ë) përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave, të caktuara për transmetime radio e televizive, të cilat administrohen nga KKRT-ja;

²⁹³ Raporti Vjetor I Veprimtarisë së AKEP-it, 2016.

Përdorimi mesatar për banor i shërbimeve Postare në Shqipëri është shumë i ulët krahasur me vëndet e BE-se dhe të rajonit.

5.7 TVSH-ja dhe taksa doganore për blerjet online

Vendimi nr. 919, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Datë 31.07.2014, ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë’”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 9, 10, 40 deri 42, 47, 119, pika 7, 149, 150 deri 152, 153, pikat 1, 2, 3, 154, 161 deri 168, 169, 177, 178, 179, 184, 188, të ligjit nr. 102/ 2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Financave Këshilli i Ministrave vendosi:

1. Në kreun 2 “Përjashtimi nga detyrimi i importit”, seksioni 5, “Dërgesat me vlerë të papërfillshme, të vendimit nr. 919, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave neni 116 “Mallra me vlerë të papërfillshme”, ndryshohet si më poshtë vijon:

Sipas nenit 116, pika 1, ***Mallra me vlerë të papërfillshme***, parashikon: *“Në përputhje me nenin 117, cdo dërgesë mallrash me karakter jotregtar, e përbërë nga mallra me vlerë të papërfillshme, të dërguara drejtpërdrejt nga një vend tjetër te një marrës në Republikën e Shqipërisë përjashtohet nga detyrimet e importit”.*

Pika 2 e këtij vendimi, sipas qëllimit të pikës 1 (si më sipër), përcakton se mallrat me vlerë të papërfillshme janë:

- a) *mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga interneti që importohen ndërmjet dërgesave postare vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 22 euro;*

b) dërgesat e mallrave nga një individ jashtë Republikës së Shqipërisë për një individ në Republikën e Shqipërisë, të një natyre rastësore, pa pagesë dhe që përmbajnë vetëm mallrat e destinuara për përdorim personal ose familjar prej marrësit, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 euro”

Sirezultat i këtij ndryshimi, të muajit qershor 2016, nga deklaratat e punonjësve pranë Postës Shqiptare rezulton se, blerjet online ishin bërë mjaft të preferuara nga konsumatorët, kryesisht moshat e reja. Shuma e blerjeve luhet nga 100 deri në 900 euro, por pjesa më e madhe e pakove, mbi 75 % të tyre kanë një vlerë rreth 100 euro. Këto pako, paguajnë 22.4 euro më shumë, me ndryshimet përkatëse.

Deri përpara ndryshimeve përkatëse, dërgesat online deri në 145 euro nuk kishin nevojë për zhdoganim, dhe posta ta sillte mallin ose produktin e porositur, direkt në shtëpi. Ndërsa me hyrjen në fuqi të vendimit të qeverisë, në momentin që vlera e faturës do të kalojë 22 euro, në këtë moment do të fillojë procesi i zhdoganimit. Blerësi shqiptar duhet të paraqitet në Postë ose në Rinas, sipas vëndit në cilin ka ardhur malli i porositur, të plotësojë deklaratën doganore dhe më pas të bëjë pagesën e doganës në bankë. Në castin pasi ka kryer pagesën i lind e drejta për ta tërhequr mallin.

Sipas intervistës së marrë nga **Drejtori Shërbimit Postar Dritan Monka**, disa nga elementët që kontribuojnë në rritjen e blerjeve online janë si më poshtë:

“Elementi kryesorë që ne vumë re ishte ndryshimi i legjislacionit që iu bë rritja, me saktë ulja e dyshemesë së tatueshme nga 20 mijë Lekë të reja, në 22 Euro. Kjo bëri që njerëzit të stepen dhe pati një reagim edhe në media, c’ka do të thotë që është një nga elementët thelbësorë të blerjeve online. Në lidhje me sigurinë ne nuk kemi konstatuar asnjë

problematikë që mund të ndikojë në blerjet online. Cilësia e produkteve ndikon, cilësia e produkteve që tregtojnë në vend, në të dy rastet edhe për rastine shitjeve online dhe për blerjet online. Në rastin e shitjeve online bëhet fjalë që cilësia e produkteve të caktuara duhet të jetë e lartë dhe nga ajo që kemi vënë re një pjesë e mirë e shitjeve online, janë me produkte të artizanantit ose me produkte autoktone shqiptare, dhe blihen kryesisht të huaj të apasionuar që mund të jenë turistë në Shqipëri ose nga emigrantë shqiptarë që ndodhen jashtë. Në rastin e blerjeve online duke qenë që njerëzit kanë humbur besimin në cilësinë e produkteve që tregëtohen në dyqanet shqiptare, dhe sidomos cmimet të tyre, abuzimin me cmimet i drejtohen blerjeve online, për të ulur kostot e tyre, pavarësisht se koha e lëvrimit të mallrave mund të jetë relativisht e gjatë. Përfitimi të cmimet e blerjeve i shtynë njerëzit që ti përdorin.

Aspekti tjetër që mund të ndikojë në rritjen e blerjeve online është cilësia e shërbimit postar. Sa më cilësor të jetë shërbimi postar aq më shumë njerëzit do të drejtohen blerjes online. Është një faktor që mendoj, se nëse cilësia do të ishte e dobët do të ishte frenuese për blerjet online, njerëzit do të tentonin mos ta përdornin si shërbim do të gjenin një rrugë alternative. Dhe kur themi cilësi nuk ka të bëjë thjeshtë që një objekt duhet të vijë e të mos humbasë, apo të mos jetë i dëmtuar apo edhe të vijë në destinacion brenda një kohe të caktuar nga vendi i origjinës.”.

5.8 MBROJTJA E KONSUMATORIT, SI GARANCI E KONTRATËS SË SHITJES NË FORMË ELEKTRONIKE

5.9 Evoluimi ligjor i konceptit të konsumatorit pas viteve '90 deri në ditët e sotme në Shqipëri

Mbrojtja e konsumatorit është një fenomen mbarë botëror.²⁹⁴ Parë në këtë këndvështrim vlen të theksohet se, më 15 Mars 1962 presidenti Amerikan John F. Kennedy, ka thënë: “konsumatorët si përkufizim na përfshijnë të gjithë ne. Janë grupi më i madh ekonomik, të cilët ndikojnë dhe ndikohen nga pothuajse çdo veprim ekonomik publik apo privat. Megjithatë, ata janë i vetmi grup i rëndësishëm, zëri i të cilëve nuk dëgjohet aq shpesh shpall katër të drejtat themelore të konsumatorit:

- a) e drejta e sigurisë;
- b) e drejta e informimit;
- c) e drejta e zgjedhjes;
- d) e drejta për tu dëgjuar.

5.9.1 Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

Pas viteve 1990, vëndi ynë u përfshi nga ndryshime të mëdha politike, ekonomike dhe tregtare. I tërë sistemi ligjor duhej të ndryshohej në përputhje me parimet e reja ku mbështetej organizimi dhe funksionimi i shtetit.²⁹⁵ Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “*Për dispozitat kryesore kushtetuese*”,²⁹⁶ është akti i parë i një sistemi pluralist, i cili afirmoi se parimet kryesore ku do të mbështetet organizimi dhe funksionimi i organeve shtetërore

²⁹⁴ Sinanaj, A. Mbrojtja e konsumatorit në Shqipëri. Maj 2017.

²⁹⁵ Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 27, Tiranë 2013.

²⁹⁶ Ky ligj është shfuqizuar me ligjin. 8417, datë 21.10.1998, i cili solli hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

janë: parimi i ndarjes së pushteteve, sovraniteti i takon popullit, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pluralizmi politik, barazia e shtetasve përpara ligjit.²⁹⁷

Vlen të theksojmë se, ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në nenin 10 parashikon: *“Ekonomia e vëndit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike në rolin rregullues të shtetit. Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror dhe nuk duhet të çënojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut.”* Ndërsa neni 12 përcakton se: *“Personi juridik e fizik i huaj mund të fitojë të drejtën e pronësisë në kushtet e parashikuara dhe të garantuara me ligj. Personit të huaj fizik e juridik i garantohet e drejta të kryejë veprimtari ekonomike të pavarur, të investojë brenda vëndit, të formojë ndërmarrje të përbashkëta ose të vetën në kushtet e përcaktuara me ligj. I garantohet, gjithashtu, e drejta e riatdhesimit të fitimeve.”*

Në këtë kuadër themi se, në këtë periudhë në vëndin tonë tashmë u ndërmorën hapa të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së vëndit, iniciativës së lirë private si dhe mbrojtjes së pronës publike dhe asaj private.

Një moment historik i rëndësishëm i cili vlen të theksohet, është pikërisht viti 1991 kur shteti shqiptar vendosi marrëdhëniet diplomatike me Komunitetin Ekonomik European ndërsa viti 1992 shënon një tjetër hap të rëndësishëm, e cila është pikërisht nënshkrimi i Marrëveshjes dhe Tregtisë së Bashkëpunimit. Synimi kryesor ka qenë zhvillimi dhe

²⁹⁷Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 27, Tiranë 2013.

realizimi i një sërë reformash të rëndësishme, si parakushte për integrimin në Bashkimin European.²⁹⁸

5.9.2 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Gjithashtu, një mbrojtje të vecantëpërsa i përket konsumatorit²⁹⁹, i kushton edhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Së pari, prodhuesit mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkatuara nga të metat e produkteve të tij.³⁰⁰

Së dyti, ata mbajnë përgjegjësi kur mashtrojnë në mënyrë publike në lidhje me karakteristikat e produkteve. si: përbërja, cilësia, natyrë, çmimi, identiteti etj., duke i shkaktuar dëmkonsumatorëve³⁰¹

²⁹⁸ Cani, Eralda “Transplantet ligjore të nevojshme për procesin e integrimit dhe kushtet e brendshme institucionale e administrative për suksesin e tyre.” Artikulli mund të gjendet online në:

http://ajls.org/doc/2_ECani_Transplantet_Ligjore_Referim_AlShkenca_2010.pdf

²⁹⁹ Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 28, Tiranë 2013.

³⁰⁰ Përgjegjësi e prodhuesit për dëmet që rrjedhin nga të metat e produkteve rregullohet nga neni 628 – 634 të Kodit Civil.

Në kuptim të këtij kodi, prodhues quhet prodhuesi i një produkti të përfunduar, të një lënde të parë ose fabrikuesi i një pjese përbërëse të produktit, si dhe çdo person tjetër që paraqitet si i tillë (prodhues), duke vënë mbi produktin emrin e tij, markën ose një shenjë tjetër dalluese.

³⁰¹ Sipas Nenit 635, “Publikimi mashtrues”

Personi që publikon ose shkakton bërjen publike të një njoftimi lidhur me produktet ose shërbimet, që ofron vetë në rastin e një veprimtarie profesionale, ose të një ndërmarrjeje, ose të një personi për të cilin ai vepron, kryen një veprim të paligjshëm në qoftë se njoftimi është mashtrues në një ose disa drejtime të mëposhtme:

- a) natyra, përbërja, sasia, cilësia, karakteristikat ose përdorimet e mundshme;
- b) origjina, mënyra ose data e prodhimit;
- c) madhësia e prodhimit stok të tij;
- ç) çmimi ose metoda e llogaritjes së tij;
- d) arsyeja ose qëllimi i ofertës speciale;
- dh) cilësitë e atribuara, dëshmitë ose vlerësime të tjera të bëra nga të tretët, ose deklaratat të lëshuara prej tyre, terminologjia shkencore ose profesionale e përdorur, të dhënat teknike ose statistikore;
- e) kushtet e livrimit të produkteve, të ushtrimit të shërbimeve ose të kryerjes së pagesës;
- f) shtrirja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e garancisë;
- g) identiteti, cilësitë, kompetencat ose tagret e atij që fabrikon

Së treti, konkurenca e pandershme,³⁰² e cila sjell si pasojë dëmtimin e interesave ekonomike tëkonsumatorit.³⁰³

Kodi Civil mbron interesat e konsumatorëve dhe kur trajton kontratat e veçanta.³⁰⁴ Dy institute të tjera që rregullohen nga Kodi Civil dhe janë pjesë e marrëdhënievejuridike konsumatore është instituti i heqjes dorë³⁰⁵ dhe e drejta për t'u tërhequr ngakontrata.³⁰⁶

5.9.3 Ligji nr. 8192, datë 06.02.1997 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

Ligji nr. 8192, datë 06.02.1997 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, është ligji specifik në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve. Ky ligj synon të mbrojë shëndetin dhe interesat ekonomike të konsumatorëve, duke mundësuar vendosjen në treg të produkteve të sigurta. Ligji përkatës rendit³⁰⁷ të drejtat bazë të konsumatorëve.³⁰⁸ afirmimin e tyre si të drejta

ose ka fabrikuar produktet, që ofron ato ose të atij që kryen shërbim, që drejton, mbikëqyr ose ndihmon në këto veprimtari;

gj) krahason me produkte dhe shërbime të tjera.

³⁰²Konkurenca e pandershme rregullohet në nenin 638 dhe 639 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

³⁰³Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 29, Tiranë 2013.

³⁰⁴Kontrata e shitjes parashikon detyrimin e shitësit për ti dorëzuar blerësit, sendet, objekt i kontratës së shitjes në cilësinë e parashikuar nga palët në kontratë. Afati ligjor për të kundërshtuar të metat e sendit, parashikuar në nenin 717 të Kodit Civil, është dy vjet nga data që sendet i janë dorëzuar blerësit. Kjo garanci ligjore aplikohet nëse palët nuk kanë parashikuar një garanci tjetër kontraktore. Kodi Civil parashikon dhe një sërë të drejtash të tjera për blerësin kur sendet janë dorëzuar me të meta, ose kur çmimi nuk është i drejtë, ose kur sipërfaqja e sendit të paluajtshëm nuk është në përputhje me madhësinë e parashikuar nga palët në kontratë.

Kodi Civil rregullon nga neni 1024 – 1049 kontratat bankare, duke parashikuar një mbrojtje minimum për debitorin, klient i bankës.

³⁰⁵Rregullohet në nenin 672 të Kodit Civil.

³⁰⁶Rregullohet në nenin 696 të Kodit Civil

³⁰⁷Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 30, Tiranë 2013

³⁰⁸Sipas nenit 3 të këtij ligji: “Të drejtat bazë të konsumatorëve janë:

a) Mbrojtja e shëndetit të tyre.

b) Mbrojtja e interesave të tyre ekonomike.

c) Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në rrugë gjyqësore.

d) Organizimi në shoqata ose bashkime që kanë si qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në përputhje me legjislacionin.

e) Informimi i mjaftueshëm.”

2. Garantimi i të drejtave nga shteti.

a) Shteti detyrohet të mbrojë të drejtat bazë të konsumatorëve.

pozitive dhe synon mbrojtjen e grupeve të konsumatorëve vulnerabël.³⁰⁹ Ligji rregullon mjaftueshëm detyrimet e tregtarit për të vendosur në treg mallra të sigurta dhe për të njoftuar konsumatorin në lidhje me çmimin, cilësinë ose rrezikshmërinë kur vendos në treg mallra të rrezikshme.³¹⁰

5.9.4 Ligji nr. 9135, datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve.”

Ligji nr. 9135, datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, shfuqizoi Ligjin nr. 8192, datë 06.02.1997. Ligji i vitit 2003 zgjeron më tej fushën e tij të zbatimit³¹¹ dhe shton listën e të drejtave bazë të konsumatorëve³¹² Ligji është më i plotë në kuadër të praktikave

b) Trajton me përparësi mbrojtjen e grupeve të konsumatorëve më të dobët dhe më të ndjeshëm si: fëmijët, pleqtë, të varfërit ekonomikisht, ata të zonave të thella, invalidët, të sëmurët dhe ata me aftësi të kufizuara mendore e fizike”.

³⁰⁹“Konsumator vulnerabël” është një term shumë i përdorur, por që nuk ka ndonjë përkufizim ligjor të gjithëpranuar për shkak të heterogjenitetit të këtij grupi. Çdo sektor ka specifikat e tij në lidhje me përcaktimin e një grupi për t’u konsideruar si “konsumator vulnerabël”.

Ngjarje të përkohshme jetësore, si: fëmijëria, sëmundja etj.; faktorë të tregut si: pabarazi në informacion, fuqia e tregut, transaksionet komplekse, arsimimi etj., si dhe mjediset, sistemet, produktet apo shërbimet e paakusueshme për të gjithë, shndërrojnë një konsumator në konsumator vulnerabël. Pavarësisht këtyre, duhet mbajtur në konsideratë fakti se grupe të caktuara janë më të prekura strukturalisht nga të qëniet vulnerabël ose i pambrojtur: si grupet në pakicë, të moshuarit, njerëzit me aftësi të kufizuara etj.

Grupi Këshillues për konsumatorët pranë Komisionit Europian pohon se ky term është ngushtësisht lidhur me termin “konsumator mesatar”. Pamundësia e dhënies së një përcaktimi të ngurtë është pasojë e lëvizjes së konceptit “vulnerabël” brenda dhe jashtë strukturave të tregut, në varësi të industrisë përkatëse.

Për më tepër:

http://ec.europa.eu/consumers/empowerment/docs/eccg_opinion_consumers_vulnerability_022013_en.pdf

³¹⁰Teliti, E. Kontratet Konsumatore, faqe 30, Tiranë 2013

³¹¹Sipas nenit 2 të tij: “Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve, nga njëra anë dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve e ofruesve të shërbimeve, nga ana tjetër, si dhe përcakton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, që kane lidhje me interesat e konsumatorit.”

Ligji i vitit 2003 mirëpërcakton palët në marrëdhënien juridike konsumatore, ku: nga njëra palë qëndron konsumatori dhe pala tjetër mund të jetë prodhues, shitës, furnizues ose ofrues shërbimesh.

³¹²Sipas nenit 4: “Të drejtat bazë të konsumatorëve janë:

- a) e drejta e mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës;
- b) e drejta e mbrojtjes së interesave ekonomike;
- c) e drejta e ankimit;
- ç) e drejta për dëmshpërblim;
- d) e drejta e edukimit;
- dh) e drejta e njoftimit;
- e) e drejta e përdorimit të shërbimeve publike;
- ë) e drejta e mbrojtjes ligjore;

të padrejtatregtare, në përcaktimin e detyrimeve të tregtarëve dhe në lidhje me kushtet e padrejta dhe përputhshmërinë kontraktuale.³¹³

Risia e këtij ligji në raport me ligjin pararendës konsiston në trajtimin e disakontratave konsumatore si: shitja dhe ofrimi i shërbimit jashtë qendrave të tregtimit³¹⁴, shitja dhe ofrimi i shërbimit në largësi³¹⁵, shitja e energjisë, shërbimet e ujit dhe të telekomunikacionit³¹⁶, kontratat elektronike³¹⁷ dhe kontratat e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme.

Rregullimi i këtyre kontratave pasqyron tentativën e legjislatorit shqiptar për të disiplinuar marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike të kohës, të cilat kanë dalë jashtëskemës së zakonshme të tregtisë dhe mundësohen nëpërmjet zhvillimit dhe epërsisë që kamarrë teknologjia e informacionit.

Ligji i vitit 2003 synon të ofrojë një mbrojtje më të madhe të konsumatorit, duke krijuar struktura të posaçme shtetërore për mbrojtjen e konsumatorin.³¹⁸ Këtij të fundit i njihet e drejta për t'u ankuar në këto organe, pranë shoqatave të konsumatorëve, tek Avokati i Popullit³¹⁹ ose në rrugë gjyqësore kur i cënohen të drejtat.

f) e drejta e organizimit në shoqata ose bashkime për mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe e drejta e përfaqësimit në organet e tyre vendimmarrëse.”

Lista e të drejtave të konsumatorit është shtuar me të drejta bazë (madje mund të pohojmë që disa prej tyre janë dhe të drejta themelore, meqenëse parashikohen nga Kushtetuta në kapitullin e të drejtave themelore të njeriut), të cilat janë ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën. Nëse konsumatori njih disa nga të drejtat e tij, atëherë ai do të përfitojë nga ushtrimi i të drejtave të tjera.

³¹³Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 31, Tiranë 2013

³¹⁴Kjo kontratë e cila sot njihet me emrin kontratat e lidhura jashtë qendrave të tregtimit rregullohet në nenin 30 dhe 31 të këtij ligji.

³¹⁵Ose siç njihet kontrata në largësi ose në distancë rregullohen nga neni 32- 36.

³¹⁶Rregullohen nga neni 37 – 38. të Ligji nr. 9135, datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

³¹⁷Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” është akti i parë që trajton dhe normon, nën titullin e tregtisëm elektronike, kontratat elektronike.

³¹⁸Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 31, Tiranë 2013

³¹⁹Institucioni i Avokatit të Popullit rregullohet nga ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Neni 2 i këtij ligji parashikon: “**Avokati i Popullit** mbrohet të drejtat, liritë dhe interesat

Zhvillimi i ekonomisë së tregut, nënshkrimi i tregtisë së lirë me shumë vende të rajonit, prona private dhe investime të shumta në fusha të ndryshme të ekonomisë kanë qenë faktorë shtytës që shteti shqiptar të hartojë dhe miratojë akte ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.³²⁰

5.9. 5Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve.”

Nënshkrimi i **Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit**, në qershor të vitit 2006 solli një epokë dhe frymë të re në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.³²¹ Kështu, në përputhje me kuadrin rregullator të Komunitetit Europian, parlamenti shqiptar miratoi më datë 17.04.2008 ligjin nr. 9902 **“Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”**.³²² Ky ligj rregullon në mënyrë të detajuar të drejtat e konsumatorëve, detyrimet e prodhuesve, praktikat e padrejta

e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj.”

Në këtë mënyrë, çdo konsumator ka të drejtë vëre në lëvizje institucionin e Avokatit të Popullit kur janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në aktet për mbrojtjen e konsumatorit nga veprime ose mosveprime të paligjshme ose të parregullta të administratës publike.

Është mëse e qartë që nuk mund të jetë objekt i punës së institucionit të Avokatit të Popullit, ankesat kur pala tjetër është një person privat. Në këtë rast, konsumatori duhet të përdorë rrugët e tjera të ankimit.

³²⁰Teliti, E. Kontratat Konsumatore, faqe 31, Tiranë 2013

³²¹Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon në nenin 76: “Palët do të bashkëpunojnë për përafrimin e standardeve për mbrojtjen e konsumatorëve në Shqipëri me standardet komunitare. Mbrojtja e efektshme e konsumatorit është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut, mbrojtje e cila varet nga zhvillimi i një infrastrukture administrative për të siguruar mbikqyrjen e tregut dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë.

Për këtë qëllim, dhe në kuadër të interesave të tyre të përbashkëta, Palët do të inkurajojnë dhe garantojnë:

- një politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën komunitare;
- harmonizimin e legjislationit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri me atë ekzistues në Komunitet;
- mbrojtje efektive ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit, dhe ruajtjen e standardeve të duhura të sigurisë;
- monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe garantimin e aksesit tek drejtësia në rast mosmarrëveshesh.”

Gjithashtu mbrojtja e konsumatorit gjendet dhe në Shtojcën IV të MSA-së që lidhet me shërbimet financiare.

³²²Ky ligj është ndryshuar me ligjin nr. 10 444, datë 14.07.2011 dhe me ligjin nr. 15/2013, datë 14.02.2013.

tregtare, kushtet e padrejta në kontrata dhe përputhshmërinë kontraktuale, kontratat konsumatore, sidhe strukturat përgjegjëse në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikqyrjen etregut.³²³

Vlen të theksojmë se, pavarësisht të legjislacionit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve, specifikisht konsumatorëve elektronike, ato sërish nuk mund të gjejnë përgjigje për pyetjet e tyre që lidhen me kushtet kontraktore, pasi sic ndodh edhe për konsumatorët në tregjet reale, leximi i kushteve kontraktore nuk do të sjellë asnjë përfitim, por ata priren të besojnë që do të ketë më pak risk nëse bien dakord me kushtet standarte të kontratës.³²⁴

Sipas ligjit *për tregtinë elektronike*³²⁵, konsiderohet konsumator “*çdo person fizik, i cili blen apo përdor mallra a shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllim, të cilat nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin ose ushtrimin e profesionit*”.

Konsumatori cilësohet si pala me e rrezikuar në nënshkrimin e kontratës së shitjes në formë elektronike, përse i përket identitetit të treguesit, mënyrës së përdorimit të teknologjisë për realizimin e transaksioneve.

Parë në këtë prizëm, vlen të theksojmë se, për shkak të problematikave të ndryshme që prekin konsumatorin, shteti si dhe bizneset të përforcojnë mbrojtjen e konsumatorëve,

³²³ Ligji në fuqi, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar, lë jashtë objektit të tij të rregullimit kontratat elektronike, të cilat rregulloheshin nga ligji i vitit 2003. (Dr. Ersida Teliti, Kontratat Konsumatore, Tiranë 2013).

Kontratat elektronike janë objekt rregullimi nga ligji nr. 10 128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”. Ky ligj ka për objekt vendosjen e rregullave për kryerjen e veprimeve tregtare në rrugë elektronike, nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga shoqëria e informacionit, për mbrojtjen e personave pjesëmarrës, mbrojtjen ligjore të konfidencialitetit të konsumatorëve apo e të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve në të, si dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të shërbimeve të informacionit, duke përcaktuar përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit.

³²⁴ E. Mallezi, J. Rystemaj, L. Pelinku, “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”, faqe 512, Tiranë 2013

³²⁵ Neni 3 ligji Nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”, I ndryshuar.

sepse pozita e tij është gjithmonë e rrezikuar gjatë transaksioneve elektronike, specifikt, kontratës së shitjes në formë elektronike.

KONKLUZIONE

Bazuar mbi punën kërkimore shkencore për realizimin e këtij studimi, duke analizuar , trajtuar dhe përshkruar në mënyrë të thelluar me qëllim evidentimin dhe identifikimin e problematikave të ndryshme gjatë analizimit të bërë legjislatit të tregtisë elektronike dhe praktikës gjyqësore ndërkombëtare, në lidhje me kontratën e shitjes në formë elektronike, kemi arritur në disa konkluzione si më poshtë.

Në kuadër të funksionimit të tregtisë elektronike për realizimin e kontratës së shitjes në formë elektronike, rezulton se, vëndi ynë i ka plotësuar mangësitë ligjore që ekzistonin në përputhje me Direktivat e Bashkimit Europian. Dhe në këtë rast, një ndër të cilët është dhe ligji për tregtinë elektronike, i cili paraqet një rëndësi të vecantë përse i përket kontratës së shitjes në formë elektronike, pasi ai synon të mbrojë konsumatorët nga dëmet apo pasojat që mund ti shkaktojë një treg i parregulluar.

Përse i përket formës ligjore të kontratave elektronike, vlen të theksojmë se, nga njëra anë, ligji nuk kërkon ndonjë formë konkrete për kontratat elektronike, por nga ana tjetër ai referon në dispozitat e Kodit Civil sa i përket kushteve që ai parashikon për formën dhe për vlefshmërinë e kontratave. Megjithatë *mbetet ende e paqartë* se cilën nga kërkesat për formë duhet të respektojnë kontratat elektronike.

Nga tërësia e funksionimit e kuadrit institucional dhe ligjor në fushën e mbrojtjes së konsumatorit vërehet se edhe pse në fushën e përshtatjes dhe harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së janë bërë hapa shumë pozitive përpara, sërish ngelet shumë për t'u përmirësuar në kuadrin ligjor dhe institucional. Organet dhe institucionet përgjegjëse janë

relativisht të reja dhe për këtë arsye eksperiencia e tyre në lidhje me zbatimin e ligjit mbetet e pakët në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Në fushën e kontratave të shitjes në formë elektronike, në Shqipëri, nuk ka pasur raste praktike gjyqësore në mënyrë që të krijohej opinion gjyqësor, mbi këtë fushë kontraktuale dinamike dhe aktuale. Në mungesë të saj, gjithmonë i referohemi gjykatave të huaja të cilat sjellin larmishmëri çështjes e problematikash.

Në fushën kontraktuale elektronike mund mund të lindin konflikte të ndryshme me karakter ndërkombëtar. Dimensionin ndërkombëtar i marrëdhënieve kontraktore në fushën e tregtisë elektronike merr rëndësi akoma në të madhe, veçanërisht nga studimi i normave të konfliktit në këtë fushë është me interes të veçantë. Në çastin kur paraqitet një situatë konfliktuale, shtrihet çështja e gjetjes së ligjit që do të zbatohet kontratës dhe juridiksionit që do të gjykojë mosmarrëveshjet që mund të lindin nga mosrepektimi i pretenduar i saj.

Nocioni i territorit “*zhdukjet*” dhe transaksionet e ndryshme apo shitjet-blerjet marrin një zhvillim të madh nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes në formë elektronike. Si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar një ndër shqetësimet kryesore të konsumatorit për nënshkrimin e kontratës së shitjes në formë elektronike, është pikërisht siguria ligjore, në lidhje me transferimin e të dhënave të tij, në mungesë të një destinacioni “konkret”.

Ndonëse Bashkimi Evropian ka miratuar një sërë ligjesh në lidhje me direktivat që lejojnë zbatimin e koncepteve të përgjithshme evropiane të mbrojtjes së konsumatorit në kontratat elektronike, sërish pozita juridike e konsumatorit mbetet e rrezikuar, në nivel kombëtar dh ndërkombëtar.

Mungesa e informacionit nga ana e konsumatorëve përsa i përket kushteve kontraktore për nënshkrimin të kontratës së shitjes në mënyrë elektronike për shërbime dhe produkte të caktuara sipas ligjit, rrit rrezikun për nënshkrimin e një kontrate fiktive.

Me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 919, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Datë 31.07.2014, ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se, konsumatori shqiptar i cili blen në mënyrë elektronike (online), në momentin që vlera e faturës do të kalojë 22 euro, në këtë moment do të fillojë procesi i zhdoganimit. Ky vendim ka krijuar ulje të ndjeshme në numrin e konsumatorëve të cilët blejnë në mënyrë elektronike produkte apo shërbime të caktuara.

Nga ky studim, rezultoi se, interneti luan një ndikim të madh në kontratën e shitjes në mënyrë elektronike. Kjo ndodh sepse, interneti bën të mundur krahasimin e çmimeve me një grup më të madh alternativash të tregut sesa ajo që është e mundshme në botën fizike. Në internet, *konsumatorët* kanë mundësi të ndryshme qoftë për të zgjedhur produktin ashtu edhe çmimin përkatës, sesa në tregun fizik. Interneti është duke përmbysur strukturat tradicionale të tregut, duke siguruar një infrastrukturë të përbashkët globale për shpërndarjen e një a gamë të gjerë të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Publikisht shërbimet e komunikimit elektronik në dispozicion në internet hapin mundësi të reja për

përdoruesit, por edhe rreziqe të reja për të të **dhënat personale dhe privatësinë**. Ndodhur në këto kushte argumentojmë se, pozitën juridike të konsumatorit, mbetet ende e rrezikuar, si pala më e dobët në marrëdhënien kontraktore të shitjes elektronike.

Duke u bazuar për gjatë gjithë hulumtimit kërkimor- shkencor të këtij punimi, konkludojmë se, Direktivat e BE-sëndjekin shembullin e ligjit Model UNCITRAL-it, të cilat kërkojnë nga shtetet anëtare që të zbatojnë legjislacionin që nuk e mohojnë efekt ligjor të kontratave elektronike vetëm në bazë të formës së tyre.

Gjithashtu, nga ky studim arrihem në përfundimin se Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Anlgia, përse i përket trajtimit të legjislacionit për kontratën e shitjes në formë elektronike dhe tregtisë elektronike rezulton, se janë të bazuara në Ligjin Model për Tregtinë Elektronike.

Një vënd të rëndësishëm në këtë gjykim ka zënë edhe çështja e provave elektronike, nëse përbën provë ligjore në gjykatë. Sipas Gjykatës së Mbretërisë së Bashkuar rezulton se, të dhënat e mbajtura në dosjet kompjuterike janë dokumente të vlefshme dhe të pranueshme në gjykatë. Pra kjo gjykatë pohon duke thënë se provat elektronike duhet të konsiderohen njësoj si provat të nënshkruara me shkrim.

Nga analizimi i praktikave gjyësore në nivel ndërkombëtar, ka rezultuar se, në përgjithësi ato zbatojnë parimet tradicionale të ligjit të kontratës për kontratën e shitjen në formë elektronike. Gjithashtu, nga eksperiencia e tyre gjyqësore, gjykatat shprehen se, njerëzit hyjnë shpesh në kontratat e shërbimit duke mos i parë parë kushtet kontraktuale.

Nga krahasimi i dispozitave të ligjit tonë me rekomandimet e OECD, rezulton se legjislacioni ynë i ka përmbushur standartet e përcaktuara nga rekomandimet në fushën e komunikimeve dhe tregtisë elektronike.

Konludojmë se, si çdo kontratë tjetër edhe kontrata elektronike duhet të nënshkruhet në mënyrë që të jetë e vlefshme. Ky moment, pra nënshkrimi i kontratës elektronike, rregullohet nga ligji *“Për nënshkrimin elektronik”*, i cili e përkufizon *“nënshkrimin elektronik”* si: *“të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar”*. Parë në këtë këndvështrim themi se, në momentin që kontrata elektronike është e nënshkruar rregullisht, atëherë ajo ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe forcë provuese si forma shkresore, përcaktim ky i cili gjendet në nenin nr. 4, në ligjin *“Për nënshkrimin elektronik”*.

Si rezultat i krahasimit të dy Konventave Ndërkombëtare në këtë studim, rezultoi se, CISG, (Konventa e Kombeve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave) është formuar si rezultat i përpjekjeve të UNICTRAL-it (Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare). Konludojmë se, ajo shërben si një urë lidhëse ndërmjet sistemeve të ndryshme ligjore të botës, konkretisht ndërmjet sistemit të *“cili law”* dhe sistemit *“common law”*. Gjithashtu, në vijimësi të krahasimit që iu bë dy konventave më të rëndësishme në nivel nërkombëtar në kë fushë, rezultoi se, CISG rregullon vetëm kontratën e shitjes ndërkombëtare të mallrave ndërsa fusha e veprimit të KKEKN është më e gjerë, ajo nuk kufizohet vetëm në shitjesn e mallrave, por të cfarëdolloj transaksioni i cili mund të realizohet duke shfrytëzuar komunikimet elektronike.

Pagesa nëpërmjet internetit për kryerjen e transaksioneve të ndryshme bankare shtron disa probleme juridike të pamohueshme. Rreziku më rëndësishëm kundrej tyre është teknika e quajtur *phishing*. Në bazë tëkësaj teknike qëndron uzurpimi i identitetit të një klienti. Piratët informatikë, duke marrë trajtat e bankës i dërgojnë një e-mail klientit, ku i kërkojnë të dhëna në lidhje me llogarinë e tyre bankare. Argumentet që ata shpesh përdorin kanë natyrë alarmante: tentativë vjedhje të llogarisë, probleme serioze në lidhje me llogarinë.

REKOMANDIME

Bazuar në konkluzionet e arritura në këtë punim rekomandimet e mëposhtme do të ishin një indicje për studime dhe kërkime të mëtejshme në fushën kontraktuale të shitjes në formë elektronike.

Kontrata të shitjes ligjërish të vlefshme në formë elektronike janë një parakusht për zhvillimin e mëtejshëm të ligjit për tregtinë elektronike dhe për konsumatorët të cilët nënshkruajnë këto kontrata dhe si e tillë siguria ligjore duhet të jetë e madhe referuar anës praktike dhe zgjidhjes së konflikteve të mundshme.

Ligjvënësi shqiptar duhet të përcaktojë se cila gjykatë është kompetente për zgjidhjen e problematikave ndaj kontratave të shitjes në formë elektronike, pasi sipas ligjit shqiptar për tregtinë elektronike nuk përcaktohet një fakt i tillë. Në këtë mënyrë, i referohemi ligjit të vjetër nr. 10.428 datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, që rregullon zbatimin e së drejtës ndërkombëtare në Shqipëri.

Përsa i përket palës kontraktore të shitjes në formë elektronike, i rekomandojmë konsumatorëve shqiptarë, që në rastin kur shërbimet nuk ofrohen dhe nuk ekzekutohen sipas parashikimeve të bëra në kontratë, të kërkojnë shpërblim dëmi, duke ju drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, (në mungesë të Gjykatës së Arbitrazhit), me padi me objekt shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror.

Instancat shtetërore dhe organizatat e konsumatorit duhet të jenë më kërkues, në mënyrë që konsumatorët shqiptarë të reflektojnë mbi të drejtat e tyre.

Konkludojmë se, një shqetësim i tregtisë elektronike është edhe ndërkombëtarizimi i kontratave të shitjes në formë elektronike. Fakti që, vende të ndryshme kanë ligje të ndryshme, është shumë e rëndësishme për të sqaruar dy momente kyçe: ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni përkatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Duke iu referuar Shqipërisë, në rast mosmarrëveshjeje në një situatë kur palët janë nga vende të ndryshme, zbatohet ligji nr. 10428 datë 02.06.2011 "*Për të drejtën ndërkombëtare private*". Ky ligj është miratuar në përputhje me Rregulloren (KE) nr.593 / 2008 të Evropës Parlamenti dhe Këshilli "*Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktuale*" dhe Rregullorja (KE) nr.864 / 2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "*Për ligjin të zbatueshme për detyrimet jashtë kontraktuale të zbatueshme*".

Vlen të komentohet fakti se, duke iu referuar, pikës b, te nenit 3, të ligjit për tregtinë elektronike, mund të ndodhë që marrëdhënia juridike civile që krijohet midis tregtarit dhe konsumatorit të jetë një marrëdhënie me një element ndërkombëtar. Për shembull, oferta të vijë nga një shtet tjetër dhe konsumatori të jetë në Shqipëri ose anasjelltas. Ndodhur në këto kushte, rekomadnohet, se ligjvënësi duhet të përcaktojë në mënyrë të saktë "*qendrën kryesore të veprimtarisë së tij*".

Referuar, të drejtës së konsumatorit për të hequr dorë nga kontrata, sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, i rekomandojmë ligjvënësit shqiptar, që të përcaktojë formën dhe mënyrën sesi konsumatori do të ushtrojë të drejtën e tij për të hequr dorë.

BIBLIOGRAFIA

BURIME PARËSORE

1. Direktiva 2000/31/EC “*Për Tregtinë Elektronike*”.
2. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 në përputhje me zhvillimet më të fundit të *acquis* të BE-së;
3. Vendimi Nr. 284, datë 1.04.2015 “*Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale*”, “Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015- 2020”.
4. Direktiva 2002/58/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 korrik 2002 Lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e Komunikimeve elektronike (Direktiva mbi Privatësinë dhe Komunikimet Elektronike).
5. Ligji për “*Për nënshkrimin elektronik*”, nr. 9880, datë 25.02.2008, i ndryshuar nga ligji nr. 10178, datë 29.10.2009 “*Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 21.09.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik*”.
6. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
7. Direktiva 95/ 46/ EC “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”
8. Direktiva 99/93/ EC “*Për nënshkrimin elektronik*”.
9. Direktiva Europiane 8 qershor 2000, “*Mbi Tregtinë Elektronike*”.
10. Direktiva Europiane, 20 Maj 1997 “*Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve*”.
11. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

12. Ligji “Për Nënshkrimin Elektronik”.
13. Ligji “Për Dokumentin Elektronik”.
14. Ligji “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale”.
15. Direktiva 97/7/CEE “Për kontratat në largësi”, datë 20/05/1997
16. Direktiva 2002/ 58- KE- për “e- Privatësinë
17. Direktiva 2006/ 24- KE- “Mbi Ruajtjen e të Dhënave”
18. Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese

19. Ligji Model UNCITRAL “Për tregtinë elektronike”, i vitit 1996

20. Ligji Model i UNCITRAL “Për nënshkrimin elektronik”, i vitit 2001
21. Konventa mbi përdorimin e komunikimeve elektronike në kontratat ndërkombëtare.³²⁶(KKEKN), UNCITRAL, 2006
22. Kushtet elektronike të ICC, 2004
23. Ligji “Për Tregtinë Elektronike”, i ndryshuar.
24. Udhëzimi i ICC për kontraktimin elektronik, 2004
25. Plan- veprimi global i ICC për biznesin elektronik, 2002
26. Directive 2000/31/EC on certain aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market, Arno R. Lodder.
27. Ligji “Për komunikimet elektronike“, nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar nga ligji 102/ 2012, datë 24.10.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike“.

³²⁶ UN Convntion on the Use of Electronic in International Contracts.

28. Ligji “*Për dokumentet elektronike*“, nr. 10 273, datë 29.04.2010.

29. Directive 97/7/EC of the European Parliament and of the Council of 20 May 1997 on the protection of consumers in respect of distance contracts, neni 2

30. Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*.”

31. Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008, “*Për mbrojtjen e konsumatorit*”

BURIME DYTËSORE

1. (The United Kingdom Journal) Information Communications Technology and E-Commerce: Challenges and Opportunities for the Nigerian Legal System and Judiciary, (*THE IMPACT OF ICT IN CONTRACT FORMATION AND E-COMMERCE DEVELOPMENT IN TANZANIA*).
2. Leiger G, (2009), *E drejta civile*, Detyrimet.
3. M. Ethan Katsh, Law in Digital World (Oxford Universitz Press: NewYork, 1995), fq
4. Malltezi A, Rystemaj j, Pelinku L. (2013), “Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri”.
5. Managing E-commerce, J. Botha, C.Geldenhuys, Juta &Co, 2007.
6. Moringiello M. J. @ Reynolds L. W, Electronic Contracting Cases 2005- 2006.
7. Murray J (2003). ‘Public Key Infrastructure, Digital Signatures and Systematic Risks’ (2003) *Journal of Information, Law& Technology* <<http://elj.warwick.ac.uk/jilt/03-1/murray.html>> at 22 January 2009;
8. Nikhilesh Dholakia; Wolfgang Fritz Ruby Roy Dholakia, and Norbert Mundorf, Global E-Commerce and Online Marketing: Watching the Evolution. (Quorum Books. Westport, United States of America ,2002)
9. Nuth S. Silalahi, (2008), Electronic Contracting in Europe.
10. Peter Carey, The Internet and E-Commerce: A Hawksmere Report, (Haëksmere, London, 2001)

11. Peter Carey, *The Internet and E-Commerce: A Hawksmere Report*, (Hawksmere, London, 2001).
12. Philip M. Nichols, *Electronic Uncertainty Within the International Trade Regime*, 15 *AM.U.INT'L L.REV.*1379, 1405 (2000).N.Comm'on Int'I Trade Law, Working Group on Electronic Commerce, Note by the Secretariat, Proposal by the United States of America, U.N. Doc/A/CN.9/WG.IV.WP.77 (May 25, 1998)
13. Robert Guttmann, *Cybercash: The Coming Era of Electronic Money*. (Palgrave Macmillan, New York, 2002), page 58.
14. Robert Guttmann, *Cybercash: The Coming Era of Electronic Money*. (Palgrave Macmillan, New York, 2002), page 58.
15. Schmid, B. (1999): *Elektronische Märkte – Merkmale, Organisation und Potentiale*, In: A. Hermanns, M. Sauter (Eds.): *Management-Handbuch Electronic Commerce: Grundlagen, Strategien, Praxisbeispiele*, Munich: Vahlen, 1999, pp. 491.
16. Schneider, G. P. 2011 – *ELECTRONIC COMMERCE Ninth Edition*, page 8
44. Stewart Macaulay, "Elegant Models, Empirical Pictures, and the Complexities of Contract," *11 Law and Society Review* 507 (1977).
17. Sumner, H. (1986): *Ancient Law*. Dorset Press, 1986.
18. Tasneem F. *Legal Effect of Electronic Contracts: A Comparative Study*. 2014 *Global Advanced Research Journals*
19. *Translactive Digital Economy and Data Protection: State of Play and Future Implications for the EU's External Policies*, 2016.

20. Translatic Digital and Economy and Data Protection: State of Play and Future Implications for the EU-s External Policies
[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU\(2016\)535006_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU(2016)535006_EN.pdf) (2016).
21. United States Agency for International Development (USAID)(2013).
22. USAID, Drejt Tregtisë Elektronike, Zhvillimi i Tregtisë Elektronike si një mundësi inovative online për rritjen e biznesit tuaj.
23. Valenzuela E. G, (2013), Regulation of Electronic Contracts in the European Community: New Challenges.
24. Vermelle G, (2008), *E drejta civile*, Kontratat, Pjesa e Posacme.
25. Winn J. K, @ Haubold J, *Electronic Promises: Contract Law Reform and E-Commerce in a Comparative Perspective*.
26. Wright S. C, (2008), ELECTRONIC CONTRACTING IN AN INSECURE WORLD
27. G. Toraldo, (2002) C.T.L.R. 4, N 65 for a comment in English. Recent Italian legislation of February 2002.
28. Julia Hornle, Gavin Sutter, Ian Walden IT Law Unit, Centre for Commercial Law Studies
29. A paper accepted on 14th Jan 2008, from SANS Institute Reading Room site, SANS Legal Issues in Information Technology and Information Security, LEG-523.
30. Andre Bertrand, *Le droit d'auteur et les droits voisins*, Dalloz, 2eme edition, 1999.
31. Ardian Nuni, (2009), *E drejta civile*, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë.

32. Ardian Nuni, Ilir Mustafaj, Asim Vokshi, (2008) *E drejta e detyrimeve I*, Tiranë.
33. Boss AH (1998). 'Searching for Security in the Law of Electronic Commerce' (1998) 23 *Nova Law Review* 585, 597-8.
34. CEPS Papers in Liberty and Security in Europe, Safe Harbour or into the storm? EU-US data transfers after the Schrems judgment Sergio Carrera and Elspeth Guild No. 85 / November 2015
35. Chicwindo J. N, (2013), The impact of ICT in Contract Formation and E-Commerce Development in Tanzania.
36. Christoph Glatt, '*Comparative Issues in the Formation of Electronic Contracts*', (United Kingdom) (Spring 1998) 6:1 *Int'l J.L. & Info. Tech.* 34, at 57.
37. Cooperative Research Centre for Construction Innovation, (2008) "e-Contracting Security and Legals Issues".
38. Curtis, G. dhe Cobham, D. (2005). Business information system: Analysis, design and practice, 5th edition, faqet 174-209
39. DM Consulting Sevrvices (2013), Drejt Tregtisë Elktronike, Zbatimi i tregtisë elektronike si një mundësi innovative online për rritjen e biznesit tuaj.
40. Dr. Alulwan Y. M. A, Problems of Signing Electronic Contract.
41. Dr. Fercala R. M, (2011), The Electronic Commerce, Doctoral Thesis.
42. Dr. Wang F. F, (2008), "Obstacles and Solution to Internet Jurisdiction. A Comparative Analysis of the EU and US laws". *Journal of International Commercial Law and Technology*
43. E- Commerce and e- Business, Zorayda Ruth Andam, May 2003, e- Asean Task Force, UNDP APDIP

44. E drejta e internetit @aspekte të shkëmbimeve elektronike. Oltion Spiro, faqe 17, Tiranë 2013.
45. E-commerce; a platform for integrated marketing case study on U.S retailing, Inga D.Schimtd, Thomas Dobler, Michael Schenk.
46. Francesco Galgano, (2006), E drejta Private (Botimi i tretë), Luarasi University Press.
47. Friedman S E, 'Protecting Consumers From Arbitration Provisions, The Federal Arbitrations Act and E-SIGNS Notwithstanding' (2007-2008)
48. Harrington J (2002) 'UK and European Legislative Initiatives Regulating Electronic Commerce' in M Chissick and A Kelman (eds), *Electronic Commerce: Law and Practice* (3rded, 2002) 307-309.
49. Hill. E. J, (2003) The Future of Electronic Contracts in International Sales: Gaps and Natural Remedies under the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods.
<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?docid=169195&doclang=EN> ,
50. [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU\(2016\)535006_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU(2016)535006_EN.pdf) ,
51. Instituti Shqiptar i Medias, Zhvillimi i Internetit dhe i Mediave Sociale në Shqipëri, Is worth reading in its entirety.
52. Jane K. Winn and Brian H. Bix, (2006), *Diverging Perspectives on Electronic Contracting in the U.S. and EU*, 54 Clev. St. L. Rev.

53. Joelle Farchy, "Internet et le Droit d'auteur", CNRS Communications. Translating Digital and Economy and Data Protection: State of Play and Future Implications for the EU's External Policies
54. Kania ED (1997). 'The ABA's Digital Signature Guidelines: An Imperfect Solution to Digital Signatures on the Internet' (1999) 7 *CommLaw Conspectus*, 298-9.
55. Kierkegaard M. S, (2007), E-Contract Formation: U.S. and EU
56. Kosick, R. The Internet in Latin America: New Opportunities, Developments, & Challenges, *American University International Law Review* 16, no. 5 (2001).
57. Law of Electronic Commercial Transaction; Contemporary issues in EU, US and China, Faye Fangfei Wang, Routledge 2010, page 4.
58. Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf)
59. Philip M. Nichols, Electronic Uncertainty Within the International Trade Regime, 15 *AM.U.INT'L L.REV.*1379, 1405 (2000)

Vendime Gjyqësore

1. A.V. kundër Iparadigms, LLC, 544 F. Supp. 2d 473, 480 (E.D. Va. 2008)
2. Bluebird, LLC., kundër Nolan, No. 302920-V., 2009 WL 1498703 (Md. Cir. Ct. April 28, 2009).
3. Brantley kundër Wilson US Dist LEXIS 17722, 6 (2006).
4. Case C-362/14, Schrems kundër. Data Protection Commissioner, 6 October 2015
5. Costar Realty Info., Inc kundër. Field, 612 F. Supp. 2d 660 (D.MD 2009)
6. Cvent, Inc. kundër Eventbrite, Inc. 739 F. Supp. 2d 927 (E.D. Va. 2010)
7. Edmond kundër Gateway 2000, Inc. 29 Conn. L. Rptr. 456 (Conn. Supr. 2001).
8. Feldmankundër Google, Inc., 513 F. Supp. 2d 229, 236 (E.D. Pa. 2007).
9. InfoCuria, 'Judgement of the Court (Grand Chamber), Case C-362/14, in re Maximillian Schrems kundër Data Protection Commissioner,' 6 October, 2015. The judgement.
10. Mehta kundër Fernandes SA (2006) EWHC 813 (Ch), para 30-31.
11. Mortenson Company, Inc. kundër Timberline Software Corporation 140 Wash.2d 568; 998 P.2d 305; 2000 Wash. LEXIS 287 (Wash. 2000).
12. Pollstar kundër Gigmania Ltd., 170 F. Supp. 2d 974, 981-82 (2000) (browse-wrap)
13. ProCD, Inc. kundër Zeidenberg ProCD, Inc. v. Zeidenberg 86 F.3d 1447 (7th Cir. 1996)
14. Register.com, Inc. kundër Verio Inc., 11 B.U. J. Sci. & Tech. L. 164, 170 (2005)
15. Segal kundër Amazon.com, Inc 763 F. Supp. 2d 1367 (S.D. Fla. 2011)

16. Southwest Airlines kundër Boardfirst, LLC., 2007 U.S. Dist. LEXIS 96230 (N.D. Tex. 2007)
17. Specht kundër Netscape Commc'ns Corp, 306 F.3d 17 (2d Cir. 2002)
18. Treiber & Straub, Inc. kundër UPS, Inc., 474 F.3d 379 (7 Cir. 2007)
19. Westendorf kundër Gateway 2000, Inc., 41 Ucc Rep

Burime Interneti

1. <http://smallbusiness.chron.com/description-amazon-uses-ebusiness-ecommerce-b2b-b2c-36453.html>
2. <http://trove.nla.gov.au/work/31602118?selectedversion=NBD42545880>
3. <http://trove.nla.gov.au/work/31602118?selectedversion=NBD42545880> Turban, E.King D., McKay., J. Marshall. Lee. J., @ Viehland, D. Electronic Commerce: A Managerial Perspective. Upper Saddle River, NJ. Pearson Prentice Hall.
5. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/12/Doktoratura-Zhaneta-Ndregjoni-Fakulteti-Ekonomise-Departamenti-i-Marketingut.pdf> Dr. Zhaneta Ndregjoni, Aplikimi i tregtisë elektronike tek bizneset e vogla dhe të mesme. Rast studimor: Rasti i Tiranës. Tiranë, Nëntor 2014
6. <http://www.enkivillage.com/e-commerce-advantages-and-disadvantages.html>
[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU\(2016\)535006_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/535006/EXPO_STU(2016)535006_EN.pdf)
7. http://www.ibls.com/internet_law_news_portal_view.aspx?s=latestnews&id=1913
<http://www.journaldunet.com/ebusiness/commerce/resultats-e-comerce-2010/chifre-d-affaires-e-commerce-2010.shtml>
8. <https://www.questia.com/library/journal/1G1-114168879/comparative-study-of-the-formation-of-electronic-contracts>
9. <https://www.uncitral.org/pdf/english/texts/electcom/ml-elecsig-e.pdf>

10. Luca Castelli, UNCITRAL legislative standards on electronic communications and electronic signatures: an introduction (https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/oth/15/08/T15080000020001PDFE.pdf)

SHTOJCA

Intervistë me **Z. Dritan Monka**, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Postare në Shqipëri

1. Siguria, si një ndër elementët kryesor që ndikon në blerjen online! Sa të sigurtë janë konsumatorët gjatë kryerjes së një blerje online në nivel ndërkombëtar?

Së pari: Në sigurimin e transaksionit financiar nuk ndikon Posta Shqiptare. Pra nuk është se ka një ndërhyrje sepse është raporti shitës-blerës dhe platforma ku kryhen keto transaksione që mund të jetë “Amazon”, mund të jetë “Alibaba”. Kështu që Posta Shqiptare merret vetëm me pjesën e transaksionit që do të thotë vetëm me dërgimin e objektit në adresë, në momentin që ajo vjen nga një postë homologe në territorin shqiptarë në Aeroport, kryesisht.

Së dyti: Siguria e objektit është e garantuar nga ana Postës Shqiptare. Objekti (nënkuptohet produkti), produkti është objekt postar kryesisht mbërrin në aeroport por kemi edhe disa pika doganore që janë Kukësi, apo Kakavija apo Pogradeci ku ne bëjme transaksione, shkëmbejmë dërgesa postare me operatorët përkatësisht Grek në Kakavijë, në Pogradec Maqedonasit dhe në Kosovë në Kukës. Volumin më të madhe e kemi me aeroportin e Rinasit. Me mbërritjen e objektit në Aeroportin e Rinasit, ato janë nën vëzhgimin e kamerave, dmth siguria e objektit është shumë e madhe, nga ana tjetër makina e postës janë të pajisura me kamera shpesh që kanë edhe shoqërues. Me mbërritjen në filialin nëqendrën tranzite që është një filial që bën sortimin apo diferencimin e objekteve sipas destinaciveve edhe aty është e gjithçka e momintoruar me kamera, edhe makinat janë të pajisura me

xhipi-es (Gipi-es). Kjo domethënë që egziston siguria maksimale, që objektet postare që hyjnë në territorin shqiptar administrohen nga forcat shqiptare qetë kenësiguri maksimale.

2. Cilat janë mundësitë dhe pengesat me të cilat vendet në zhvillim si Shqipëria, përballen me tregëtinë elektronike?

Mundësitë janë të mëdha sepse tregtia elektronike në shqipëri nuk është zhvilluar akoma, nuk ka arritur as në normalitetin e saj, domethënë është në fazat fillestare të saj. Janë ngritur shumë pak kompani të vogla të cilat operojnë me shitje online dhe më shumë në Shqipëri bëjnë blerjen online. Ka një grup kompanish të vogla të cilat kanë lidhur kontrakte me postën shqiptare në menyrë që kur bëjnë transaksione brenda vëndit me klientët e tyre apo jashtë vëndit, ti kryejnë këto transaksione nëpërmjet postës shqiptare. Në këto raste posta shqiptare për pjesën e shitjeve brenda vëndit ofron edhe shërbimin financiar të marrjes së pagesës KESH në momentin e dorëzimit të mallit. Ndërkohë që për dërgesat kur klienti ndodhet jashtë posta shqiptare funksionon me partneritet, me postat homologe, vetëm për shërbimin postar dhe jo për shërbimin financiar.

Tek pengesat mund të theksojmë, këtë pjesën e shërbimit financiare i cili, nuk mund të ofrohet për dërgesat ndërkombëtare, flas për objektet e dala nga Shqipëria domethënë kur një tregëtuës online dërgon një objekt postar për një blerës jashtë Shqipërisë duke qenë që kompanitë janë kompani homologe nuk jemi e njëjta kompani sic mund të jenë operatorët private ne nuk mund të ofrojmë shërbimin e marrjes së pagesës në momentin e dorëzimit të objektit në vëndin e destinacionit. Ndërkohë pengesë tjetër për tregëtinë elektronike është legjislacioni, ndryshimi i legjislacionit tatimor për pjesën e blerjeve

online, i dha një stepie shërbimit dhe reagimi i njerëzve është duke e kufizuar blerjen e mallit të cilit ata blejnë duke tentuar që ato të mbeten brenda limiteve të cilat ato janë të paketueshëm.

3. Cilet elementë kontribuojnë në rritjen e blerjeve online?

Elementi kryesorë që ne vumë re ishte ndryshimi i legjislacionit që iu bë rritja, me saktë ulja e detyrës së tatueshme nga 20 mijë Lekë të reja, në 22 Euro. Kjo bëri që njerëzit të stepen dhe pati një reagim edhe në media, c'ka do të thotë që është një nga elementët thelbësorë të blerjeve online. Në lidhje me sigurinë ne nuk kemi konstatuar asnjë problematikë që mund të ndikojë në blerjet online. Cilësia e produkteve ndikon, cilësia e produkteve që tregtojnë në vend, në të dy rastet edhe për rastin e shitjeve online dhe për blerjet online. Në rastin e shitjeve online bëhet fjalë që cilësia e produkteve të caktuara duhet të jetë e lartë dhe nga ajo që kemi vënë re një pjesë e mirë e shitjeve online, janë me produkte të artizanantit ose me produkte autoktone shqiptare, dhe blihen kryesisht të huaj të apasionuar që mund të jenë turistë në Shqipëri ose nga emigrantë shqiptarë që ndodhen jashtë. Në rastin e blerjeve online duke qenë që njerëzit kanë humbur besimin në cilësinë e produkteve që tregëtohen në dyqanet shqiptare, dhe sidomos cmimit të tyre, abuzimin me cmimet i drejtohen blerjeve online, për të ulur kostot e tyre, pavarësisht se koha e lëvrimin të mallrave mund të jetë relativisht e gjatë. Përfitimi të cmimet e blerjeve i shtyjnë njerëzit që ti përdorin. **(cilësinë e thamë).**

Aspekti tjetër që mund të ndikojë në rritjen e blerjeve online është cilësia e shërbimit postar. Sa më cilësor të jetë shërbimi postar aq më shumë njerëzit do të drejtohen blerjes

online. Është një faktor që mendoj, se nëse cilësia do të ishte e dobët do të ishte frenuese për blerjet online, njerëzit do të tentonin mos ta përdornin si shërbim do të gjenin një rrugë alternative. Dhe kur themi cilësi nuk ka të bëjë thjeshtë që një objekt duhet të vijë e të mos humbasë, apo të mos jetë i dëmtuar apo edhe të vijë në destinacion brenda një kohë të caktuar nga vendi i origjinës.

4. Cili është perceptimi në qëndrimin e konsumatorëve në blerjet online?

Përgjithësisht perceptimi konsumatorëve që ne kemi konstatuar në Postën Shqiptare është shumë i mirë, krahasuar gjithmonë me volumet që trajtohen. Posta shqiptare ka volumë shumë të mëdha bazuar në kapacitetin e saj që është operatori më i madh, në treg që mbulon rreth 95% të volumit postar në të gjithë Shqipërinë, dhe operatorët e tjerë janë rreth 5%. Porë në këtë këndvështrimin, kemi patur raste të konsumatorëve të pa kënaqur, sic ishte rasti i disa Website-ve pirate të cilat mashtronin konsumatorët shqiptarë, në shitjen e telefonave celulare dhe në këtë rast Posta Shqiptare ka kosto shtesë pasi duhet të sqarojë qytetarët e irrituar, që nuk është Posta ndërmjetës në blerjet online, por posta bën vetëm transportin e një objekti dërgese nga aeroporti nga momenti që ai hyn në territorin shqiptarë në destinacion. Që do të thotë, në rast se objekti nuk është i futur në kuti në ambalazhin e dërgur, posta shqiptare nuk mban përgjegjësi për mbajtjen e një objekti postar, dhe kjo vlen edhe për blerjet online. Kjo është domethënë një nga pikat që ne kemi patur një lloj përballje me një pjesë të konsumatorëve pasi të mashtruarit nga një faqe pirate. Ato i drejtoheshin Postës Shqiptare me dyshimin se mund të ishte Posta ajo që mund ta kishte bërë vjedhjen, por duke ditur sigurinë që ofron Posta Shqiptare, që nuk lejon që të bëhet asnjë lloj cënimi i përmbajtjes të një objekti postar. Përveç këtyre ka patur raste që

në Postën Shqiptare në aeroportin e Rinasit kanë mbërritur objekte postare të dëmtuara. Objekte postare të demtuara ndodhin kryesisht për shkak tëtransportit lokal i vendit të origjinës, i postës të origjinës, supozojmë se posta Franceze nga transporti local nga kamionat që ata bëjnë lëvizjet e objekteve postare sepse ato i beëjnë në mënyrë tokësore, kur i dërgojnë supozojmë në Zvicër, këto nga kamionat shkarkohen dhe ngarkohen në aeroport në avion, dhe nga ngarkim dhe shkarkime të ndryshme ato dëmtohen pasi ndoshta nuk mund të jenë amablazhuar në mënyrën e përshtatshme për përmbajtjen e objektit postar pasi, cdo object postar duhet të jetë i ambalazhuar në një mënyrë të tillë që të ruhet përmbajtja e objektit. Kjo është një këshillë që jepet në cdo zyrë postare në të gjithë botën, që klienti i cili mban përgjegjësi për ambalazhimin klienti duhet të sigurohet që amablazhi ruan cilësinë e objektit postar duke marrë parasysh transportin, ngarkim - shkarkimet e ndryshme, vendosjen e peshave mbi objektet postare sepse ato mund të mbivendosen mbi njëra tjetrën sepse ka pasur raste që mund të jenë dëmtuar. Në raste kur kanë ardhur të dëmtura në kemi procedurat e tona që bëjmë procesverbale përkatëse, bëjmë riambalazhim edhe ja dorëzojmë klientit. Klienti ka të dretjtë që ta tërheqë ose ta refuzojë marjen e objektit postar, gjithcka ndodh në sportelin e postës në vëzhgimin e kamerave klienti duhet të hapë objektin dhe ne raste se konstaton që objekti ështëi dëmtuar mundet ta riktheje në vendin e orgjinës,pa pranuar tërheqjen e tij. Posta në këtë rast është dëshmitare qëklienti nuk e ka dëmtuar objektin vetë dhe e rikthen në vendin e orgjinës, ku tarifa e kthimin i meret dreguesit në këtërast. Përvec këtyre rasteve që kanë qenë sporadike dhe që të pakonsiderushme nga ana statistikore, duke bazuar dhe karahasuar mbi volumin e objekteve që ne trajtojmë cdo ditë, nuk kemi pasur ankesa të tilla dhe vete volumet e mëdha

që ne trajtojmë, tregojnë besim te konsumatori, tregojnë perceptim pozitiv në cilësinë e shërbimit që ne ofrojmë.

5. A perben siguri, kuadri ligjor aktual Shqiptar, si garanci për mbrojtjen e konsumatorit?

Nuk di të them, nuk jam kompetent për pjesën e kuadrit ligjor për shit-blejtet online. Nuk besoj se ka ndonjë klauzolë të vecantë që mbron konsumatorin shqiptar nga mashtrimet online. Është dicka që ndoshta Ministria e Inovacionit mund të japi informacin shumë më të zgjeruar në këtë pjesë ose Ministria e Ekonomisë mund të ketë dicka, por mendoj që Ministria e Inovacionit që ka pjesën e risive elektronike, ku mund të trajtojë vlerat.

6. Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet aplikimit të blerjeve online?

Avantazhet e aplikimit të blerjeve online është cilësia e produktit. Përgjithësisht blerjet online kryhen për dy arsye ose cilësinë e produktit ose për koston e tij. Për cilësinë e produktit blerjet online janë adresuar kryesisht në: Angli, Gjermani dhe SHBA në shtete e tjera ka dicka më pak edhe në Itali. Ndërkohe që për kliente të cilët janë të orientuar në ciminin e produktit kryesisht ë kanë blerjet në Kinë, Singapor, Hon-Kong. Në të dy rastet kjo përbën avantazh për klientin, komoditeti i dytështë që klienti bën një blerje pa qenë nevoja që të konsumojë orë ose ditë të tëra duke kontrolluar dyqane, duke shpenzur karburant ndoshta për të shkuar ose me transport është më e sakta në këtë këndvështrim blerja online finalizohet për disa minuta nga momenti që klienti bindet që produkti që i kërkon. Produkti i përmbush të gjitha kriteret që ai kërkon, ai kryen blerjen online dhe

proceson pa qenë nevoja të shkojë në distancë të largëta ku mund të jenë qendrat tregtare apo të vizitojë rrugë të tëra për dyqane për të gjetur një produkt që ai kerkon.

Te disavantazhet është pjesa e vonesës së mbërritjes së objektit duke qenë së objekti që blen konsumatori mund të ndodhet në një shtet të largët si: Kina dhe Singapori. Kërkoet kohë e nevojshme si për nga ana e shitësit për marrjen e objektit që shitet apo mallit të tij që shitet nga magazinat e veta ambalazhimin e tij procesimin edhe bindjen me koston e vendit peërkates të orgjinës edhe pas është vonesa për shkak të largësisë e kalimit nga kostaja e orgjinës në linja ajërore apo në transport detare apo nëtransport tokësor në varësi të koston së shërbimit që i është ofruar atij klienti në vendin e orgjinës.

Në këtë këndvështrim disavantazhi mëe madh është efekti kohë. Disavantazhi i dytë që ka të bëjë prapë efektin kohëështë mosperputhje e cilësive të mallit qeë mbilhet nga ato të kërkua nga ana e konsumatorit, blerësit. Në raste të tilla kërkohet kthimi e përgjithësi i objektit në orgjinë dhe në rastin e kthimit ky klient është I pakënaqur sepse nuk ka arritur të marrë shërbimin që kërkuar edhe mbas një afati kohore për shkak të rrugës për shkak tëdistancës. Në këtë këndvështrim ose është I detyruar edhe të bëjë edhe njëherë blerjen online, pra duhet të vonohet edhe për një periudhë kohe tjetër ose refuzon përfundimisht terhiqet nga kjo blerje. Mendoj qe keto jane dy me kryesoret..

7. Posta? Cili është roli I Postës Shqiptare në ndërverprimin e shitjeve online/kontratave elektronike?

Posta i ka qëndruar aktualisht profilit të saj që bën vetëm vijimin e objekteve postare, në rastin e një blerje online kur blerësi ndodhet në Shqipëri nga aeroporti ose nja hyrja e një

prike doganore, deri në dërgimin në dëstination. Në rastin e dytë kemi të bëjmë me shitësin shqiptare që merë në dorëzim dhe vijon atënjepërmjet partereve të saj për ta çuar në dëstination. Në të dy rastet posta qëndron në profilin e saj njëlloj si për çdo dërgesë tjetër postare. Kjo do të thotë që posta nuk ka një rol të rëndësishëm në transaksionin dhe blerjen online. Shumë posta homologe kanë ndërmarë hapa për tu futur fuqimisht në tregtim online, duke kryer transaksione deri në financiare, pasi një pjesë e postave në botë, postave shtetërore kanë gjithashtu licencën për shërbimet bankare, por posta shqiptare akoma nuk e ka akoma si licencë dhe ka ngelur ka ngelur vetëm në pjesën e ushtrimit të aktivitetin të saj si postë.

Posta Shqiptare po shikon mundësitë për të zgjeruar, për tu futur në tregtinë elektronike, nëpërmjet e-commerce është një iniciativë nëpërmjet UPU-s, (Shërbimi Postar Universal) është një organizatë në blerjet online të ketë është një iniciativë që po nxit të gjithë operatorët shqiptarë të cilët po bëhen pjesë të një rrjetorë të e-commerce ku çdo blerje online të ketë një etiketë që e diferencon nga dërgesat e zakonshme postare dhe duke patur këtë etiketë çdo objekt postar do të mënjë shpejtesi. Në këtë këndvështrim roli i postës mund të jetë më aktiv dhe ne po shikojmë që tregtia elektronike të jetë më e madhe ndoshta duke hapur edhe një faqe tregtare ku ne mund të ofrojmë një gamë shumë të gjërë objektiv të cilat shiten online, klientët mund ta gjejnë në postën shqiptare pa qenë nevoja për tu futur në faqe të caktuara dhe në këtë rast posta mund të marrë rolin e një garantori të objektiv për mallin që ajo tregton, nëpërmjet kësaj faqeje. Në të gjithë këto kërkesa të kohës, investim, investime në mjete, në flotën që përdorë posta shqiptare, në burime njerzore dhe duhet pak kohë që të realizohet.

9. Dhe sa peshe ka Posta Shqiptare si pale e trete për të zgjidhur këto problem?

Posta Shqiptare luan rolin si posted he trajton cdo object tjetër postar që do të thotë në cdo rast, që është tepër i rrallë i humbjeve apo i dëmtimeve post shqiptare dëmshpërblehet në bazë të që ajo ka të përcaktuara të miratuara edhe nga uku-ja që është Organizata Boterore e Postave. Në këtë këndvështrim Posta Shqiptare për objektet që janë të pasiguruara ka disa dëmshpërblime standarte të cilat varet nga përmbajtja e objektit postar apo mallit që është blerë online, që do të thotë pavarësisht brenda një objektyti postar apo pakoja që ë ka blerë dikush online mund të këtë tapa shishesh ai do të dëmshpërblehet njëloj sikur të kishte një ore Roleks, pra dëmshpërblimi është i njëjtë është fiks I përcaktur nuk është I konsiderueshëm dhe në cdo rast I mbulon shpenzimet e shërbimit postar, bëhet fjalë për shpërblimet e objekteve ku posta shqiptare është në orgjinë.

10. Dogana? Cili është roli i Autoritetit doganor shqiptar dhe si funksionon ai në lidhje me shit-blerjet elektronike?

Raporti i doganës me Posten Shqiptare është i tillë që në ambjentet e filialit qendres tranzite, ku ne bejmë të gjithë krehjen apo përpunimin e objekteve postare autoriteti doganor ka një përfaqësues të vetin, i cili është i pajisur edhe me një skaner për objekte postare. Përfaqësuesi i doganës është plotësisht i pavarur nga posta Shqiptare dhe ka autoritet të plote duke zbatuar ligjin e doganave të Shqipërisë. Një dërgesë postare e cila ka shumë objekte postare brenda fillimisht mbërrin në aeroportin e rinasit, kalon nëpërmjet doganës për kryerjen e procedurave paraprake doganore . Në momentin që mbërrin në filifalin e qendres tranzite dërgesat postare meren në dorzim ku bëhet skanimin, dogana mund të ndalojë objektet postare të cdo kategorije që bleje online ose dërgesë postare e zakonshme. Në disa raste:

1) Vlera e objektit postare e deklaruar si blerje online kalon shifren 22 euro, dhe ne kete rast një kopje e faturës doganor nga ana e klientit. Posta shqiptare ka lehtësuar këtë proces duke mundësuar tashme që prej një viti pagesën e detyrimit doganor në çdo qytet pranë zyrave postare dhe në kete rast psh dërgon një njoftim me shkrim tek klienti duke e njoftuar që detyrimi doganor është në vlerën x dhe ju mund ta paguani pranë postës shqiptare ose në banke. Kjo lehtëson klientin, pasi me marrjen e njoftimit klienti mund të drejtohet zyrës postare që ka më afër dhe mund të kryejë pagesën në çdo qytet .

2) Mundësia e dytë që dogana të ndërhyjë është për arsye verifikimi, kur konstatohet që nëpërmjet skanerit që ka material të cilat transportohet për tregëti, në këtë rast ajo kërkon praninë e marësit në mënyrë që të hapë objektin postar dhe të kryejë vëzhgimin e tij, nëse konstatohet që mallërat janë të tregtueshme atëherë ai do të nënshtrohet detyrimit doganor, nëse konstatohet që mallërat nuk janë të tregtueshme janë për përdorim personal .

11. TVSH-ne? A ka ndryshim në blerjet online përse i përket TVSH-se dhe cilat janë ato?

Ka një stepje të klienteve që në rastin kur u ndyshua 5 gusht 2017 dhe kaloi sic thame kaloi në 20 milionë kaloi në 22 euro dmth ndyshimi të dyshemesë së tatueshme, me uljen e kësaj njerziti, blersit u stepën pasi tashmë çdo mall që ata blinin mbi vlerën 22 euro do të nënshtrohej doganës, kjo rrit koston me 22% për blerjet online kjo u bë nga qeveria për arsye të caktuara, për të nxitur tregëtinë e brendshme edhe për të rritur të ardhurat në buxhet. Megjithatë niveli aktual i TVSH-së është i njëjtë me atë të shumë shteteve të botës si në Europë dhe Amerikë.

12. A ekziston nje autoritet nderkombetar mbikqyres-kontrollues mbi aktivitetin e kompanive qe jetesojne shitjet elektronike?

Nuk kemi informacion nëse ekziston, nuk mund të flasim me siguri në këtë pikë.

13. Posta shqiptare, a ka qenë ndonjëherë palë ndërgjyqëse e një procesi gjyqësor në lidhje me cënimin e sigurisë së konsumatorit?

Në dijeninë time jo. Deri në gjykatë jo. Kemi pas ankimime të ndryshme, kemi pasur raste shumë të rralla të humbjeve të objekteve postare nga punonjës të postës, por që janë zgjidhur duke verifikuar nga kamerat e sigurisë dhe dokumentacionit që ne kemi. Nisur edhe nga dokumentacioni që ne kemi, ka qënë faji i punojstit të postës. Ka qënë faji i punojnesit të postës. Kemi pasur një rast në vitin 2015 ku një korrier në Devoll, e hapi kutinë mori aparatën celular dhe e mbushi me gurë kutinë dmth. Në ishim shumë të sigurt që pesoni që e kishtë kryer këtë ishtë punojsi dhe ai pranoi pergjegjesi e veta, u demshperblye klienti dhe kjo nuk shkoi në një fazë të dytë. Ky ka qën një rat unik për 2015.

Në 2016 kemi pasur një rast tjetër një object shumë i vogël i cili nuk arrihej të gjendej, për shak se zyrat e përpunimit të objekteve postare janë shumë të medha, gjithashtu abjekti nuk arrihet të shihej as nga kamerat. U bë dëmshperblimi i klient me parashikim që bën ligji. Në vitin 2017 nuk ka raste të tilla.

Njerëzit i drejtohen postës, sepse posta është terminali i fundit që ato kanë kontakt dhe në momentin që ai kontaktin e ka me postën aty e gjen më të lehtë për të shprehur ankesën e vetë dhe për të ngritur çështjen e re.

Një rast tjetër është kur një objekt postar është nisur për në Angli ka pranuar humbjen e objektit postar dhe klienti është i detyruar të ridërgojë sërish të njëtin objekt postar. Ne do marim dëmshpërblimin nga Anglia, dërgesa do kryhet pa kosto këtë herë dhe dëmshpërblimin do t'ja japim klientit.

